





Titulli: Kombformimi dhe shtetformimi  
Botues: Fondacioni-Konrad-Adenauer në Republikën e Kosovës  
Autor: Bekim Baliqi  
Kordinimi: Fondacioni Konrad Adenauer  
Dizajni: Milky Way Creative  
Tirazhi: 300 ekzemplarë  
Publikimi mund të shkarkohet falas në: <http://www.kas.de/>  
Kosovo

**Vërejtje:**

Qëndrimet e prezantuara në këtë libër janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk i paraqesin patjetër qëndrimet e Fondacionit Konrad-Adenauer.

Ky botim nga Fondacioni Konrad Adenauer është vetëm për informacion.

I njëjti nuk mund të përdoret për qëllime fushate gjatë një fushate zgjedhore.

**Katalogimi në botim – (CIP)**  
**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”**

32:342.1(496.51)

Baliqi, Bekim

Kombformimi dhe shtetformimi / Bekim Baliqi. - Prishtinë :  
Fondacioni Konrad Adenauer, 2021. - 154 f. ; 25 cm.

Shkenca politike  
Kosova -- E drejta kushtetuese

**ISBN 978-9951-8664-3-9**

Aleph [000098887]



# Përmbajtja

Parathënia	7
Recension	9
<b>1. Hyrje</b>	<b>12</b>
<b>PJESA E PARË</b>	
<b>2. Kombformimi</b>	<b>20</b>
2.1 Përkufizimet dhe konceptet	20
2.2 Kujtesa kolektive	28
2.3 Mitet kombëtare	33
2.4 Gjuha kombëtare	37
<b>3. Qasjet teorike</b>	<b>39</b>
3.1 Primordializmi	39
3.2 Modernizmi	42
3.3 Etnosimbolizmi	46
<b>4. Kombësia dhe shtetësia</b>	<b>49</b>
4.1 Identiteti kombëtar	52
4.2 Identiteti shtetëror	57
4.3 Kombi, shteti dhe përkatësia	62
<b>PJESA E DYTË</b>	
<b>5. Shtetformimi</b>	<b>66</b>
5.1 Përkufizimet dhe konceptet	66
5.2 Procesi shtetformues në studimet shkencore	68
<b>6. Qasjet teorike</b>	<b>72</b>
6.1 Shteti dhe autoriteti	72
6.2 Shteti dhe institucionet	77
6.3 Shteti dhe shoqëria	80
<b>7. Shtetndërtimi bashkëkohor</b>	<b>85</b>
7.1 Shtetndërtimi përballë shtetdështimit	87
7.2 Shtetndërtimi përballë kolonializmit	89
7.3 Shtetndërtimi përballë demokratizimit	91

## PJESA E TRETË

8.	Shtetformimi i Kosovës	94
8.1	Konteksti historik	95
8.2	“Republika” e Kosovës	98
8.3	Nga administrimi deri te pavarësimi	100
8.4	Tranzicioni politik dhe demokratik	106
9.	Formimi i identitetit kosovar	112
9.1	Procesi i formimit të identitetit	116
9.2	Dimensionet e formimit të identitetit	117
9.3	Simbolet e Kosovës	121
9.4	Shtetësia në Kosovë	125

## PJESA E KATËRT

10.	E ardhmja e kombit dhe e shtetit	130
10.1	Populizmi dhe nacionalizmi bashkëkohor	131
10.2	Shteti në shekullin XXI	134
11.	Përfundim	138
12.	Literatura	140

## Parathënia

Ky libër lindi si ide shumë vjet më parë, duke u zhvilluar në formë shënimesh, ligjëratash, kumtesash dhe artikujsh të ndryshëm shkencorë, mirëpo realizimi i tij u zvarrit për mjaft kohë. Kjo ndodhi për shkak të hezitimit tim për t'iu përveshur një pune mjaft sfiduese, me shumë çështje e koncepte komplekse. Gjithashtu, nuk gjeja as mbështetje për botimin e librit, derisa Fondacioni Konrad Adenauer më doli përsëri në ndihmë. Meqenëse ligjëroj lëndën me po të njëjtin emërtim, tashmë mbi dhjetë vjet, edhe titulli i librit dukej që do të ishte më i përshtatshëm dhe më i arsyeshëm të mbetej thjesht i tillë. Në gjuhën shqipe ka një numër përkthimesh të veprave botërore që trajtojnë si çështjen e kombit, ashtu edhe të shtetit. Ajo çka u mungonte studiuesve ishin shtjellimi dhe zbërthimi i tyre si procese formuese, të ndërlydhura e të ndikuara nga faktorë e aktorë të shumtë, si çështje që trajtohen në këtë libër. Shpresoj shumë që ky boshllëk është plotësuar sadopak nga këndvështrimi holistik dhe kritik i ofruar në këtë libër, dhe se libri do të nxisë diskutime, reflektime dhe hulumtime shkencore mbi këto çështje përherë relevante dhe interesante.

Tani kur po jetojmë në një epokë të internetit, telefonave të mençur, mësimëve online, qeverisjes elektronike dhe një bote përherë e më digjitale, duket se libri, leximi dhe studimi janë lënë paksa anash. Mirëpo, nuk duhet harruar që burimi i tërë zhvillimeve teknologjike, zbulimeve shkencore e arritjeve të shumta të njerëzimit qëndron pikërisht te libri dhe leximi i tij. Prandaj, sado që mund të mahnitemi me përparimin njerëzor dhe me mrekullitë e teknologjisë, ato do të mbesin të vjetërsuara e të kota nëse nuk shkojnë paralel me pasurimin dhe me shpërndarjen e njohurive të reja që vijnë nga libri, si burim i pashtershëm i diturisë. Libri në formë fizike ndoshta dikur edhe do të rrallohet, eventualisht edhe të zhduket, sikur gazetat tani, por në trajta të tjera do të vazhdojë të ekzistojë përherë, si frymëzues e udhëzues i njerëzimit. Pa shënimet e grumbulluara, të shpërndara dhe të përvetësuara përmes librave, nuk do të ishte i mundur as vetë formimi i kombeve dhe i shteteve. Kështu që, ky libër, dedikuar në rend të parë studentëve, shpresoj të jetë një kontribut edhe për studiues të tjerë, në rrugën e tyre për njohuri të reja dhe për përsiatje.

Gjithashtu, shpresoj se libri do t'i shërbejë edhe audiencës së gjerë lexuesish, në të kuptuarit e këtyre nocioneve themelore dhe tejet të rëndësishme.

Shfrytëzoj rastin t'i falënderohem recensentit Gëzim Selaci, i cili me vërejtje dhe sugjerime e begatoi tutje librin. Përzemërsisht u falënderohem edhe Daniel Braun, Granit Tërnavës dhe Premtina Rakovicës nga Fondacioni Konrad Adenauer, të cilët edhe kësaj radhe pa ngurrim e përkrahën botimin e librit. Falënderoj edhe familjen, e miqtë që më frymëzuan dhe më mbështetën për të punuar në libër.

Ndoshta vlen për fund edhe të sqarohet që emrat e personave, toponimet dhe emërtimet e huaja janë lënë qëllimisht në trajtën e tyre origjinale, në mënyrë që të shmangen keqkuptimet eventuale.

Lexim të këndshëm e studime të mbara!



## Recension

Në një kohë kur në shoqërinë tonë libri nuk i drejton bisedat publike rreth punëve të politikës, ky libër vjen si një përpjekje intelektuale për t'i interpretuar temat e debatit publik në dritë të diturisë politike. Libri është një përmbledhje reflektimesh të zgjuara mbi tema që kanë ngjallur jo vetëm interesimin akademik, por edhe atë të publikut në kohët e fundit, dhe është shkruar si një pasqyrë e disa prej temave teorike të shkencës politike dhe, përtej kësaj, si përpjekje që në dritë të tyre të kuptohen dinamikat e praktikës politike në Kosovë. Në të do të gjeni një parashtrim të lexueshëm, që vjen si rrjedhojë e natyrshme e leksioneve, shkrimeve dhe studimeve të profesorit Baliqi në temat dhe nocionet e kombit, kombformimit, shtetit dhe shtetndërtimit, tema këto aq relevante dhe aktuale për mendimin politik të kombit, si dhe për praktikën politike të shtetit.

Lënda zhvillohet në katër pjesë. Pjesa I e librit i diskuton në abstrakt nocionet e kombit dhe të nacionalizmit, si dhe të identitetit kombëtar e shtetëror. Rëndësia e kësaj për literaturën në gjuhën shqipe qëndron në faktin se, ndonëse ka disa libra të autorëve dhe të teoricienëve eminentë të fushës, deri më tani ka munguar një qasje krahasuese e teorive dhe ballafaqim i baraspeshuar i tyre. Veç kësaj, në këtë pjesë diskutohen edhe autorë dhe pikëpamje teorike të panjohura për fondin e literaturës politike të shkencave shoqërore në gjuhën shqipe.

Në pjesën II sqarohen kuptimet e shtetformimit dhe të shtetndërtimit, ofrohet një pasqyrë teorike rreth çështjeve që kanë të bëjnë me autoritetin dhe me institucionet e shtetit, me raportin e shtetit me shoqërinë, si dhe me procesin e shtetndërtimit bashkëkohor dhe të demokratizimit. Sqarimet e ofruara në këtë pjesë formohen nga dituritë e zhvilluara në traditat filozofike, sociologjike dhe të shkencës politike.

Pas kapitujve teorikë, pjesa III rreket t'i analizojë temat kryesore të librit në rastin e veçantë të Kosovës. Aty ofrohet një pasqyrë kronologjike e formimit të shtetit të Kosovës nga periudha "embrionale" e shtetit, duke kaluar në periudhën e ndërtimit të institucioneve shtetërore gjatë administrimit ndërkombëtar, e deri te shpallja e pavarësisë së shtetit.

Këtë pasqyrë e përshkon jo vetëm analiza institucionale, por edhe një analizë e aspekteve kulturore të tranzicionit, siç është edhe tema gati e tabuizuar e “identitetit kosovar”, të cilën autori e merr në shqyrtim me guxim. Pjesa IV u kushtohet përsiatjeve mbi të ardhmen e kombeve, nacionalizmave të rinj, sikurse edhe të dilemave mbi shtetin.

Ndërhyrja e profesorit Baliqi me anë të këtij libri në këto tema është e mirëseardhur, jo vetëm për faktin se i kontribuon dhe e pasuron diskursin akademik, por edhe sepse synon t’i drejtojë bisedat rreth çështjeve politike në shoqërinë tonë. Si i tillë, ky është një lexim i detyrueshëm për studentët e shkencave shoqërore dhe për praktikantët e politikës, si dhe është i këshillueshëm për të gjithë lexuesit që kërkojnë një përmbledhje të temave tashmë të paanashkaluara në debatin tonë publik rreth politikës dhe shoqërisë.

Gëzim Selaci

Departamenti i Sociologjisë

Universiteti i Prishtinës



# 1. Hyrje

Ekzistenca e kombeve dhe e shteteve janë aq të përbrendësuar në botëkuptimin dhe përditshmërinë tonë, saqë ne këto zakonisht i marrim si të vetëkuptueshme e të përhershme. Mirëpo, nëse reflektojmë pak më thellë rreth prejardhjes dhe përbërjes së tyre, do të kuptojmë që sikurse hartat politike të shteteve që kanë pësuar konfigurime të vazhdueshme, ashtu edhe trajektorja historike e formimit të kombeve ishte përherë e ndryshueshme. Kështu, vetëm në dy shekujt e kaluar kishte ngritje e rënie të panumërta të perandorive, bashkime principatash dhe shpërbërje të qytet-shteteve, aq sa edhe kombe që “rilindën” nga hiçi dhe aso që u zhduken nga faqja e dheut. Përmbledhtazi mund të thuhet se procesi i kombformimit dhe i shtetformimit është i pandarë nga vetë historia njerëzore. Prandaj, duhet studim i gjithmbarshëm për ta kuptuar zanafillën, si dhe për ta njohur rëndësinë dhe funksionimin e tyre.

Mund të thuhet lirisht se kombi dhe shteti, si dukuri apo si koncepte, janë alfa dhe omega në studimin e shkencave politike, qoftë në aspektin teorik dhe trajtimin e tyre normativ, ashtu edhe në hulumtime empirike e krahasuese mbi rëndësinë dhe ndikimin e tyre në çështje të ndryshme. Mirëpo, a do të mund të studiohen këto nocione themelore politike pa i trajtuar dhe pa i zbërthyer edhe zanafillën, përmbajtjen dhe arsyet e ekzistencës së tyre? Sigurisht që përgjigjja është mohuese, sepse do të ishte e pamundur një gjë e tillë, pasi që të dyja konceptet janë komplementare dhe të pandara nga faktorët dhe rrethanat e shumta që çuan në formimin dhe në formësimin e tyre. Me fjalë të tjera, nuk ka ndonjë formulë e asnjë model përcaktues e të vetëm se kur dhe si u formuan kombet dhe shtetet, sepse këto janë të ndërvarura, të kontekstualizuara e të ndikuara, në kohë dhe në hapësirë, nga shkaqe e rrethana të ndryshme.

Fillimisht duhet shtruar pyetjet: Pse të studiohen dhe të hulumtohen çështjet e formimit të kombeve e shteteve? Çfarë rëndësie mund të kenë këto për shkencat shoqërore në përgjithësi dhe për shkencat politike në veçanti?

Përgjigjet në këto pyetje thelbësore do të na qartësojnë mbi ndikimin dhe implikimin e tyre të shumanshëm, sepse këto janë tejet relevante si për shkenca shoqërore, ashtu edhe të një rëndësie të pamohueshme në jetët tona të përditshme. Madje, keqkuptimi apo edhe keqinterpretimi i koncepteve të tilla mund të ketë pasoja si në shoqëritë e ndryshme, ashtu edhe në jetën e secilit individ.

Thënë ndryshe, konceptet mbi kombin, shtetin e identitetin të ideologjizuara verbërisht apo të instrumentalizuara skajshmërisht për çfarëdo qëllimesh janë ose mund të jenë burim përplasjesh apo edhe konfliktesh ndërmjet “identiteteve” e shteteve të ndryshme. Në këtë kuptim, shkenca e ka për detyrë të bëjë hulumtime objektive dhe të nxisë reflektime kritike, si dhe të ofrojë sqarime sa më të arsyeshme e të faktuara për të na mundësuar kuptimin e mirëfilltë të këtyre dukurive e proceseve shoqërore, në mënyrë që të shmangen sadopak keqkuptimet dhe keqpërdorimet eventuale. Me fjalë të tjera, tema aq komplekse dhe njëkohësisht të ndjeshme për masa të gjëra e bartin përherë rrezikun që të bëhen shkaktare të mospajtimeve e keqkuptimeve. Për ndonjë nationalist të verbuar, vënia në pyetje e lashtësisë së kombit ose e kontestimit të narracioneve e figurave kombëtare mund të merret edhe si blasfemi.

Rënia e regjimeve komuniste në fillim të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar solli fundin edhe të përplasjeve ndërmjet dy superfuqive botërore, e njohur ndryshe edhe si Lufta e Ftohtë. Gjithashtu, fundi i kësaj epoke pas vetes la jo vetëm zbrazëtirë në rendin botëror, por çoi përfundimisht edhe te shpërbërja e shteteve shumëkombëshe, siç ishin Bashkimi Sovjetik (BRSS), Çekosllovakia dhe Jugosllavia (RSFJ). Në këtë konstelacion të ri politik dhe në vazhden e këtyre proceseve shpërbërjesh ndodhën edhe luftëra për pavarësi dhe vetëvendosje. Pas dëmeve të mëdha materiale dhe në njerëz, këto luftëra përfunduan me krijimin e shteteve të reja. Që nga ajo periudhë, nga ky proces shtetformues botës iu shtuan edhe tridhjetë e katër shtete të reja. Kështu, vetëm nga ish-BRSS u formuan pesëmbëdhjetë shtete dhe nga ish-RSFJ shtatë shtete të reja, përfshirë këtu edhe pavarësimin e Kosovës.

Formimi i shteteve të reja gjatë kësaj kohe u bë edhe si rrjedhojë e shkolonizimit të vonuar, si dhe përgjatë vijave etnike e fetare, siç ishte rasti i Namibisë, i Eritresë apo i Timorit Lindor, duke e kthyer vëmendjen e opinionit të gjerë rreth procesit bashkëkohor të shtetformimit ashtu edhe të kombformimit. Për këtë shkak, edhe interesimi, punimet kërkimore dhe konferencat shkencore mbi kombin, nacionalizmin dhe shtetin u bënë përsëri atraktive për botën akademike dhe objekt i shumanshëm hulumtimesh. Kjo ndodhi së paku për dy arsye: së pari, për shkak të paradigmës së re shkencore, pra akumulimit e zhvillimit të teorive, të dhënave, koncepteve dhe njohurive të reja; së dyti, për arsye të rëndësishme, ndikimit dhe lidhshmërisë së tyre me sigurinë e gjithmbarshme në botë.

Edhe pse procesi i shtetformimit në disa raste të caktuara ishte më i hershëm, vala më e madhe ndodhi në fillim të shekullit XX, ndërsa interesimi akademik e shkencor për këto procese ishte edhe më i vonshëm. Çështjet që vazhdojnë të shtrohen e të diskutohen gjerësisht kanë të bëjnë me konsolidimin, kapacitetet dhe zhvillimin e shteteve si garantuese kryesore për sigurinë, arsimimin, shëndetësinë dhe për mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve. Ndërkaq, çështja kombëtare mbetet ende njëra ndër preokupimet qenësore në politikën dhe jetën e përditshme të shumë shoqërive, gjë që dëshmon se proceset kombformuese e shtetformuese nuk janë vetëm zhvillime historike dhe se i takojnë të së kaluarës, por ato vazhdojnë të mbesin akoma ndër çështjet më thelbësore të organizimit tonë shoqëror, kulturor, ekonomik, diplomatik dhe politik. Së këndejmi, ato paraqesin fusha studimi të shumanshme, pa të cilat nuk mund të kuptohen dhe të sqarohen edhe shumë dukuri, procese e çështje të tjera të sotme.

I habitshëm mbetet fakti se për çfarë arsye konceptet mbi shtetin dhe mbi kombin ishin anashkaluar dhe mospërfillur për një kohë aq të gjatë. Me gjithë rëndësinë dhe ndikimet që kanë këto çështje, trajtimi i tyre sistematik dhe shkencor filloi vetëm nga gjysma e dytë e shekullit të njëzetë, pavarësisht se kishte studiues e mendimtarë mjaft të zellshëm që i kishin shtjelluar edhe më herët temat në fjalë.

Nocionet si shteti, kombi, identiteti, kujtesa historike, simbolet kolektive, ndjenja e atdhedashurisë, gjuha e urrejtjes, luftërat ndërkombëtare, patosi ideologjik, kodi etik e normat sociale, si dhe shumëçka tjetër rreth tyre kishin një kuptim krejt tjetër vetëm pas dy luftërave botërore, atëherë kur bota u përball me aftësitë e njeriut për vetëshkatërrim, të ardhura si rrjedhojë e marrëzive në emër të kombit e shtetit. Në këtë periudhë edhe zhvillimi i shkencave shoqërore, sidomos i shkencës politike, ndikoi që studimi i tyre të ishte më sistematik, më argumentues dhe i bazuar në të dhëna, duke hapur kështu horizonte të reja kërkimore e debate të larmishme akademike. Sidoqoftë, këto koncepte me të drejtë mund të konsiderohen si nocione vazhdimisht të kontestuara, njëjtë sikurse edhe shumë nocione të tjera në shkencë shoqërore, pasi që kuptimi e përdorimi i tyre është përherë i ndryshueshëm.

Kombformimi dhe shtetformimi, me gjithë faktin se shpesh përdoren ose thënë më saktë ngatërrohen për të përkufizuar të njëjtën gjë, ato në esencë janë të ndryshme si nocione ashtu edhe si procese. E para përfshin një proces dhe koncept shumë më të gjerë dhe më shumëdimensional, që nënkupton përveç tjerash edhe përkatësinë, besnikërinë dhe identifikimin e popullit si bashkësi politike ose edhe kulturore me shtetin ku jeton. Kështu, për shembull, në gjuhën angleze termi “nation-building” merret si proces i formimit të kombit dhe njëkohësisht të shtetit, që për bazë marrin modelin përfundimor të krijimit të komb-shtetit (nation-state). Ishin pikërisht përfaqësuesit amerikanë të qasjes së modernizmit ata që viteve '60 e sajuan konceptin e “nation-building”, me të cilën gjë nënkuptonin domosdoshmërinë e transformimit të shoqërisë prej asaj tradicionale në atë moderne përmes formësimit institucional, legal e social. Gjithashtu, ata e përdornin këtë nocion kryesisht që të përshkruanin nevojën e shteteve të sapo pavarësuar dhe të çliruara nga kolonizimi, me ndihmën e të cilit koncept këto shoqëri do të duhej t'i konstituonin institucionet shtetërore dhe të krijonin kombin e tyre. Prandaj, në këtë kuptim, “komb-formimi” ishte sinonim i shtetformimit dhe kuptohej si një lloj mekanizmi dhe mënyre që mundëson dhe konsolidon shtetformimin.

Gjithashtu, duhet thënë se me konceptin e shtetformimit zakonisht përkufizohen aspektet institucionale, legislative, si dhe organizimi politik, megjithëse shtetformimi mund të merret si synim parësor i secilit komb, pra të krijimit të shtetit të vet kombëtar. Në shumë raste, nëse jo edhe në shumicën e tyre, shtetformimi i parapriu kombformimit, edhe pse ka mjaft raste historike që e dëshmojnë edhe të kundërtën. Këto dy fenomene ishin rezultat i veprimeve dhe i vendimeve (jo rrallë arbitrare) politike dhe ushtarake, që ishin dhe mbesin shkaqe të luftërave të përgjakshme dhe konflikteve të panumërta. Në shkencat politike ekzistojnë një mori tezash dhe konceptesh mbi këto dy çështje. Në një njërën anë mbi kombformimin janë të njohura teoritë moderniste, primordialiste dhe etnosimboliste dhe në anën tjetër mbi shtetformimin pikëpamje teorike të ndryshme të studiuesve të shumtë, të cilat do të trajtohen më thellësisht në libër.

Libri ndahet në katër pjesë me gjithsej 12 kapituj, ku përfshihen çështjet kryesore që ndërlidhen me dukuritë dhe proceset e studimit tonë. Fillimisht, në kreun e parë do të thellohem tek kombi duke nisur me përkufizimet e shumta të saj, me historikun dhe kontekstin e zhvillimit të ideve, nocionit dhe shkollave të ndryshme të mendimit mbi të, për të vazhduar në kapitullin vijues, me qasjet kryesore teorike, shtruar nga përfaqësuesit më të spikatur të tyre. Më pas do të shtjellohet çështja e identitetit, si atij kombëtar ashtu edhe shtetësisë, parë nga prizmi i ndërveprimit dhe marrëdhënieve të tyre. Në pjesën e dytë do të shtjellohet nocioni i shtetit, duke e trajtuar atë nga këndvështrimi ideor e historik dhe duke u zgjeruar më tutje rreth dimensioneve kyç të saj, si ai institucional, ekonomik, kulturor e deri te çështjet e legjitimitetit dhe raportit me shoqërinë. Kapitulli pasues trajton shtetndërtimin si parim themelor në rendin aktual botëror, me sfidat dhe zhvillimet e shumta që ndodhin në këtë aspekt. Duke i pasqyruar e sqaruar këto me raste të shumta studimore, rrethana historike e zhvillime bashkëkohore dhe duke i krahasuar këto në aspekte të ndryshme të analizës.



Në pjesën e tretë të librit rëndësi e veçantë do t'i kushtohet Kosovës, si për nga procesi i saj shtetformues, ashtu edhe për nga çështja e hapur dhe mjaft shpesh e kontestuar e identitetit të saj. Në kreun e fundit të librit do të flitet rreth dinamikave aktuale e dimensioneve thelbësore si në rrafshin global, ashtu edhe evropian, lidhur me temat tona boshte, të cilat mund të ndikojnë në të ardhmen si të shteteve, ashtu edhe të kombeve, ose edhe të dyjave njëkohësisht. Me një përmbledhje reflektuese dhe kritike, kapitulli i fundit shërben si ftesë për diskutim të hapur, lexim e studime të mëtejshme për temat e shtjelluara në libër, si dhe të shumë çështjeve të papërfshira me këtë kontribut modest në këtë fushë studimi tejet pak të hulumtuar.



Pjesa

1

## 2. Kombformimi

### 2.1. Përkufizimet dhe konceptet

Që t'u qasemi sa më mirë temave boshte të librit, janë të nevojshëm fillimisht përkufizimi dhe shpjegimi i nocioneve, në këtë rast i nocionit themelor atij mbi kombin dhe më pas edhe mbi shtetin. Në këtë kapitull do të paraqesim shkurtimisht zhvillimin e ideve dhe përkufizimet thelbësore të këtij nocioni. Pasi që më tutje do t'i shqyrtojmë më gjerësisht teoritë dhe qasjet e shumta të një fenomeni kaq kompleks e dinamik, siç është kombi.

Fjala shqip për komb, sipas të gjitha gjasave, është huazuar nga arabishtja dhe është vënë në përdorim nga rilindësit e hershëm kombëtarë, si sinonim i fjalës “nacion”, e cila si e tillë përdoret në trajta të ndryshme në shumicën e gjuhëve europereëndimore. Ndërkaq, termi “nacion” e ka prejardhjen nga fjala latine natio (që rrjedh nga fjalët “nasci” dhe “natalis”), që fillimisht mund të përkthehej lindje, por së shpejti nënkuptonte fisin dhe lidhjen farefisnore, duke shërbyer edhe si sinonim i fjalëve populi dhe gentes, që përdorehin për përshkrim të grupeve të caktuara njerëzore. Ndërsa gjatë epokës së mesjetës kjo fjalë përdorej edhe si përkufizim për “prejardhje” (Bruckmüller, 1994: 24-32), si dhe përdorej në vend të “certifikatës së lindjes dhe të prejardhjes” (Hobsbawm, 1992: 27). Natio ishte pra term i shumëkuptimshëm, kështu thekson politologu Herfried Münkler, se me Natio mund t'i referohej një qyteti apo rrethinës së saj, në raste të tjera edhe rajoneve dhe trevave më të gjëra që përfshinin shumë banorë. Së këndejmi ky term ishte i shumëkuptimshëm, sepse nënkuptonte dhe përshkruante shumëçka njëkohësisht (Münkler, 1999: 290). Edhe kolegu i tij Kenneth Minogue vë në pah faktin se me “nation/komb” nënkuptohej përveç fisit, racës dhe popullatës edhe nënndarja e studentëve në universitetet evropiane të mesjetës. Kjo nënndarje rezultonte në bazë të vendlindjes, respektivisht regjionit të prejardhjes. Kështu p.sh. Universiteti i Aberdeenit përbëhej prej këtyre “kombeve”: Mar, Buchan, Murray dhe Angus, ndërsa Universiteti i Parisit kishte: Franca, Picardia, Normandia dhe Germania (Minogue, 1970:11).

Në këtë kontekst dhe në kuptim metaforik, Universiteti i Prishtinës do të mund të përbehej nga “kombe” të ndryshme, siç bie fjala nga ai tetovar, gjakovar, ulqinak, llapjan apo preshevar. Diçka që në shikim të parë mund të tingëllojë si banale, rrethanat historike e zhvillimet e caktuara politike me kalimin e kohës mund t’i bëjnë këto të vetëkuptueshme. Së këndejmi, nocioni komb mund të kuptohet vetëm në kontekst të caktuar kohor dhe hapësinor. Prandaj, kombet zhvillohen me dinamizëm, si në kontekstin e caktuar hapësinor (ose gjeografik), ashtu edhe në atë kohor (apo historik). Kështu, kuptimi i tij është i varur prej faktorëve ndikues në formim të tij dhe varet prej këndvështrimit teorik nga e cila shqyrtojmë këtë nocion dhe këtë dukuri, sepse trajektorja e formimit të kombeve dhe elementet përbërëse të saj dallojnë prej rastit në rast, epokave dhe vendeve. Kombet mund të nënkuptojnë gjëra të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Prandaj, më shumë sesa një përkufizim të përpiktë, studiuesit ofrojnë më shumë përshkrime të elementeve përbërëse të tij.

Në kuptimin e gjerë të fjalës, koncepti komb përfshin disa segmente të perceptimit dhe përgjithësisht mund t’i nënkuptojë këto kategori:

- ▶ bashkësi me (ose besim në) prejardhje të përbashkët,
- ▶ bashkësi gjuhësore dhe e një kulture të përbashkët,
- ▶ bashkësi politike dhe shtetërore,
- ▶ bashkësi e vullnetit të përbashkët,
- ▶ bashkësi me prejardhje të përbashkët (veçanërisht për botën mesjetare).

Mirëpo, kombi është edhe një kategori morale e etike, sepse nxit ndjenjat për bashkëkombësit si një lloj obligimi veprues apo edhe solidariteti të veçantë. Identiteti kombëtar na sugjeron që për të qenë pjesëtarë të këtij identiteti kjo ngërthen më vete marrëdhënie më të ngushta e solidare me pjesëtarët e tjerë brendapërbrenda asaj bashkësie.

Për shembull, lidhjet shoqërore ose martesore nxiten e preferohen kryesisht ndërmjet personave të të njëjtit komunitet. Emrat e mbiemrat personalë, të vendbanimeve dhe shumëçka tjetër “kombëtarizohen”. Edhe atëherë kur këta emra mund të burojnë nga kuptimi fetar, ata përkthehen ose përshtaten në variantin kombëtar. Kombi shërben edhe si normë sociale dhe busull morale. Prandaj, krenaria kombëtare në sport, shkencë, art e në shumëçka tjetër përjetohet emocionalisht, si p.sh. gjatë lojërave olimpike, për laureatët e çmimit “Nobel”, për gara prestigjioze ndërkombëtare ose tragjedi të ndryshme, p.sh. fatkeqësitë natyrore, sulmet terroriste etj. ndihen me dhimbje, pikëllim apo edhe si diçka personale.

Duke qenë se gjatë historisë nocioni komb pësoi konvertime në kuptim dhe përdorim, sikurse edhe për shkak se është mjaft kompleks, shumë studiues të nacionalizmit i shmangen qëllimisht një definicioni të prerë të kombit. Historiani britanik Eric Hobsbawm, autor i një mori veprash për kombin dhe për nacionalizmin, në hyrjen e librit “Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780” shkruan kështu: „(...) libri nuk merr asnjë përcaktim apriori të asaj që përbën një komb. Si supozim fillestar studiues, çdo grup mjaftueshëm i madh njerëzish, anëtarët e të cilit e konsiderojnë veten si anëtarë të atij “kombi”, do të trajtohet si i tillë.” (Hobsbawm, 1992: 6). Në mënyrë të ngjashme edhe disa autorë të tjerë, si p.sh. Kenneth R. Minogue, Hugh Seton-Watson etj., e trajtojnë problematikën e përkufizimit të kombit duke e futur këtë nocion në një kategori të përbashkët me nacionalizmin. Mirëpo, në parim ekzistojnë dy modele të shpjegimit të asaj se çka është kombi. Sipas këtij klasifikimi, dikotomia përkufizuese mbi konceptin e kombit ndahet përgjithësisht në bazë të kriterëve kulturore – objektive, dhe në ato politike përkatësisht subjektive.

Pjesa më e madhe e librave, punimeve shkencore apo artikujve seriozë për kombin dhe komponentët e tjerë të saj (si: nacionalizmi, identiteti kombëtar, mitet nacionale etj.) fillojnë me pyetjen: Çka është kombi? Kësaj pyetjeje parimore është munduar mendimtari francez Ernest Renan (2018) ndër të parët t’iu përgjigjet.

Në ligjëratën e tij të njohur po me titullin “Çka është kombi?”, nga viti 1882, të mbajtur në Universitetin e Sorbonës, ai u përgjigj thjesht, por mjaft kuptueshëm se kombi është vullnet, vetëdije dhe “plebishit i përditshëm” (plebiscite de tous le jours). Ai po aty e shpjegoi se ne për çdo ditë e pranojmë dhe e rikonfirmojmë në një mënyrë apo tjetër përkatësinë tonë kombëtare, respektivisht ne këtë e manifestojmë në mënyra dhe me veprime të ndryshme. Renani po ashtu pohonte se vetëdija kolektive pason nga kujtesa kolektive e një të kaluarë të përbashkët, e cila është e ndërlidhur me harresën kolektive. Ai këtë e argumentonte me atë se shumë francezë duhej të harronin fillimisht se ishin Alzaz apo Breton, në mënyrë që të vendosnin për të qenë francezë të rinj. Është një konfirmim i vazhdueshëm kolektiv i vullnetit ajo që e formon dhe e mban gjallë kombin, sipas formulimit subjektivist nga Renani.

Sidoqoftë, një përkufizim i tillë ishte deri diku edhe idealist, meqenëse historikisht dihet se kombet nuk ishin formuar mbi baza vullnetare dhe jo çdoherë vlenin si bashkësi gjithëpërfshirëse. Kështu, sa për ilustrim, gjatë Revolucionit Francez (1789) vetëm shtesa e ulët, ose siç njihej ndryshe rendi i tretë (le tiers état sipas formulimit të Abbé Sieyès) e shihte veten dhe konsiderohej gjerësisht si komb në dallim prej klerikëve dhe aristokracisë. Studiuesi Eugen Weber, mbështetur në të dhëna historike dhe kërkimet e tij shkencore për Francën e pasrevolucionit, pohon se vetëm një e treta e popullsisë në atë kohë mund të flisnin gjuhën frënge. Ngjashëm, duke u mbështetur në studiuesin e mirënjohur të nacionalizmit Eric Hobsbawm, te italianët deri në fund të shekullit XIX edhe më pak se një e treta e popullsisë e flisnin italishten zyrtare. Nga ky argumentim del se hipoteza e Renanit mund të merret edhe si pararendëse e qasjes moderniste, që do të shtjellohet më pas.

Karakteristikë për çdo komb, sidomos në fazën e themelimit, është organizimi politik e institucional që vjen si rrjedhojë e një bashkësie kulturore, si dhe dëshira ose qëllimi për të pasur një shtet të vet. Kështu, Ernest Gellner thekson se nacionalizmi është një formë e mendimit politik që bazohet në faktin, se bashkësia politike duhet të jetë e përputhshme me njësinë kombëtare (Gellner, 1995: 17).

Sipas këtij përkufizimi del se kombi formohet nga nacionalizmi e jo anasjelltas, ashtu siç mendohet gjerësisht. Mirëpo, disa studiues të tjerë nuk kënaqen me kaq thjeshtësim. Kështu, për shembull, Wallker Connor mendon se nuk mjafton vetëm të pyesësh “çka është kombi?” pa pyetur edhe “kur mund të flitet për një komb?”. Është shkolla e njohur si primordialiste ajo e cila thekson se kombi nuk është thjesht prodhim i modernitetit dhe rezultat i industrializimit, porse rrënjët e saja janë më të hershme dhe se në forma të tjera ekziston kaherë - p.sh. etnia merret si paraprijës i saj dhe se qysh në shoqëritë e para arkaike kishte një lloj kombi. Këtu duhet nënvizuar se gjithashtu koncepti i kombi ngatërrohet ose njëjtësohet jo rrallëherë me atë të etnisë. Por, dallimi kyç është se grupet etnike, për Weberin, kanë (ose besojnë) në “të përbashkëtën” (Gemeinsamkeit), por s’janë “bashkësi”. Për të pohuar më tej, “është kryesisht komuniteti politik, pavarësisht sesa artificialisht mund të jetë ndërtuar, që ushqen besimin në bashkësinë etnike.” (Weber, 2004: 129).

Në këtë kontekst, më 1994 u mbajt në Universitetin Warwick një polemikë (e njohur si Debati i Warwick-ut) ndërmjet Ernest Gellnerit si përfaqësues i shkollës moderniste dhe ish-studentit të tij Anthony Smith- që përfaqëson rrymën etnosimboliste, me temën: “Kur kanë lindur kombi dhe nacionalizmi?”. Smithi argumentonte se ndoshta kombet nuk janë krijuar në tërësi nga lidhjet etnike të mëparshme, por këto lidhje ndikuan në natyrën e vetë kombeve po aq sa edhe kushtet e modernitetit si shkrim-leximi apo industrializimi. Ai nuk e hodhi poshtë tezën moderniste, por mendonte se i mungonte sqarimi i pjesës së paramodernes. Ndërsa Ernest Gellneri e sjell në një analogji me debatin e evolucionit të Charles Darwinit mbi prejardhjen e njeriut çështjen e krijimit të kombit. Ai e mbrojt qëndrimin e tij me pyetjen: A ka kombi kërthizë? Sepse, sikur dilema se a kishte Adami/Ademi kërthizë apo jo, që do të mund të zgjidhte çështjen e krijimit apo të evoluimit të njeriut, ashtu edhe çështja me kombet ngjashëm qëndron. Por, Gellner pohon se për të jetuar nuk na duhet kërthiza por sistemi tretës, frymëmarrës etj., prandaj ekzistenca e kombeve nuk varet patjetër nga ajo se a e kanë kërthizën apo jo.



Megjithëse Gellneri nuk e përjashtonte mundësinë se disa kombe edhe mund të jenë mjaft të hershme (pra me “kërthizë”), mirëpo shumica e sajojnë apo e lartësojnë lashtësinë (“kërthizën”) e tyre në mënyra të ndryshme. Ky diskutim i shtyri shumë studiues që ta tejkalojnë këtë dilemë dhe enigmë e të përqendrohen më shumë në potencialin dhe pasojat e nacionalizmit, sidomos atij të ri, paskomunist. Ndër këta studiues ishte edhe Rogers Brubaker, që bëri studime të thukëta në nacionalizmit e ri të lindjes, respektivisht të vendeve postkomuniste.

Në studimin e nacionalizmit një kohë të gjatë ekzistonin dy modele diferencuese në konceptimin e kombit dhe të nacionalizmit. Ndër studiuesit e parë që bëri këtë dallim ishte historiani gjerman Friedrich Meinecke, i cili qysh në vitin 1907 këto dy modele ose forma të kombit i ndau në “komb shtetëror” (Staatsnation) dhe në “komb kulturor” (Kulturnation). Duke filluar që nga shkencëtari amerikan Hans Kohn, që më 1944 këtë diferencim e shqyrtoi më gjerësisht, duke pohuar se ky model përkon me dallimet ndërmjet formimit të kombit në Perëndim dhe në Lindje e deri tek autori i njohur kanadez Michael Ignatieff, në librin “Gjaku dhe përkatësia: Udhëtime në nacionalizmin e ri” (2000), që këtë dallim e karakterizon në modele etnike dhe qytetare të kombformimit, dualizmi dhe dikotomia për kombin mbizotërojnë thuaja në të gjitha qasjet teorike, analizat dhe veprat që objekt studimi kanë kombin dhe nacionalizmin. Gjithsesi as kritikën mbi këtë kategorizim nuk mungojnë aspak. Kombi në parim karakterizohet me një dualizëm të vazhdueshëm për nga fakti objektiv dhe nga kuptimi i dhënë subjektiv.

Në anën tjetër, për Anthony Smithin, çështja më thelbësore sesa kjo nënndarje duhet të jetë pyetja se “çka e përbën identitetin kombëtar?”. Duke pohuar se kjo paraqet një fenomen shoqëror shumëdimensional, ai numëron disa tipare të cilat një komb duhet t’i posedojë për të ekzistuar si i tillë:

1. Një territor historik, ose atdheun,
2. Mite të përbashkëta dhe kujtesën historike,

3. Kulturë të përbashkët të masës së gjerë të popullatës,
4. Të drejta dhe obligime të përbashkëta ligjore për të gjithë anëtarët e vet,
5. Një ekonomi të përbashkët me mundësi të lëvizjes së lirë të anëtareve të vet brenda territorit (Smith, 1991 : 14).

Në bazë të këtyre kritereve Smithi edhe kombin e përkufizon në këtë mënyrë: "(...) një popullsi njerëzore me emërtim që ndan një territor historik, mite të përbashkëta dhe kujtime historike, kulturë publike, ekonomi të përbashkët dhe të drejta e detyrime të përbashkëta ligjore për të gjithë anëtarët e vet." (Smith, 1991: 14). Ai mendon se identiteti në thelb është mjaft i ndërlikuar, shumëdimensional dhe se nuk mundet asnjëherë të reduktohet vetëm në një element, dhe as nuk mund të ekzistojë pa ndonjë komponent të mësipërm. Përveç dallimeve me grupet e jashtme, që janë shtytëse të krijimit të ndjenjës së përbashkësisë dhe të identitetit kolektiv, në një masë të konsiderueshme janë edhe ngjashmëritë e brendshme faktorë, të cilët e plotësojnë këtë dyanshmëri. Kombet ekzistojnë për shkak të elementeve të përbashkëta që anëtarët e një grupi shoqëror i kanë ndërmjet vete, sepse pa veti e tipare të përbashkëta nuk mund të formohet asnjë bashkësi shoqërore. Vlerësuar historikisht, për disa kombe pikë referuese apo më mirë të themi afruese ka qenë feja e përbashkët, për disa të tjera ishte gjuha, për disa territori, derisa për disa të tjera mund të ishte kurora mbretërore, dhe për këto arsye disa grupe të caktuara ishin të përjashtuara apo vështirë të integruara në këto bashkësi shoqërore e politike.

Gjithsesi, është vështirë në mënyrë të përgjithësuar të thuhet se cilat elemente të përbashkësisë janë konstituive në formimin e identiteti kombëtar. Sepse, varësisht prej epokave historike, rrethanave dhe rasteve të ndryshme, edhe këto elemente përbërëse ndryshojnë në vazhdimësi. Për Ballkanin, sipas etnologut austriak Karl Kaser, këto elemente konstituive janë dominuese: gjuha, religjioni, shkrimi dhe historia.

Përgjithësisht këto kriteret themeluese kanë një rëndësi të veçantë në formimin e vetëdijes kombëtare (Kaser, 2001: 233). Edhe pse mund të pajtohemi parimisht, këta komponentë kurrsesi nuk janë të vetmit për identitetin kombëtar. Përveç tjerash, edhe për shkak se këto kategori vështirë që mund të jenë të ndara ndërmjet vete, dhe, në anën tjetër, duhet pasur parasysh strukturat politike, kushtet ekonomike, sistemin arsimor, mediet, si dhe institucionet shtetërore, që në botën bashkëkohore janë esenciale në formimin dhe konsolidimin e kombeve. Ngjashëm edhe për sajimin e nacionalizmit janë një varg faktorësh të rëndësishëm. Për Benedict Andersonin (1991), ishte margjinalizimi i gjuhës latine dhe forcimi e përdorimi gjithnjë më i gjerë i gjuhës popullore, sidomos në formën e teksteve të shkruara, dukuri që ai e përshkruan me nocionin “kapitalizëm i shtypit”. Për Gellnerin, nacionalizmi përbëhet nga dy dimensione themelore: nga ndjenjat (sentimentet) e përbashkëta dhe nga lëvizja politike. Kjo nënkupton që nacionalizmi në njërin anë synim qenësor e ka krijimin e shtetit kombëtar, e në anën tjetër përfshin edhe shpërfaqjen e gjerë dhe të tejtheksuar të ndjenjave kombëtare, shpeshherë karshi kombeve të tjera, bile edhe në formë agresiviteti e shovinizmi. Këto dy pole ekstreme të saj bëjnë që nacionalizmi të keqkuptohet dhe të keqinterpretohet sipas skemës bardhë e zi, ku nacionalizmi i tjetrit paraqitet fajtor dhe i dëmshëm e ai vetjak emancipues. Pa dyshim që studimi i nacionalizmit, sikurse edhe i kombformimit, kërkon të merren parasysh rrethanat, proceset dhe faktorë të tjerë të shumtë.

Në vazhdim do të shtjellojmë disa prej elementeve thelbësore, siç janë kujtesa kolektive dhe manifestimi i saj, në mënyra e aspektet e ndryshme, pastaj mitet kombëtare, të cilat janë pjesë përbërëse të narracionit dhe perceptimit për veten, si dhe gjuha e cila shërben jo vetëm si mjet komunikimi, por edhe identifikimi. Këto dimensione sigurisht që nuk janë elemente të vetme në ngjizjen e ndjenjës, solidaritetit dhe krenarisë kolektive si premisa të kombformimit, por mund të konsiderohen si parakushte pa të cilat shpërfaqja e nacionalizmit dhe konstituimi i kombeve do të kishin qenë të pamundura.

## 2.2. Kujtesa kolektive

Në shumicën e gjuhëve indoevropiane ekzistojnë më shumë se një term a shprehje për të emëruar të kaluarën dhe për të shprehur kujtimet e së kaluarës. Zakonisht për të përcaktuar atë çka ne, qoftë si individ apo kolektiv, e mbajmë mend njihet me nocionin kujtesa (memory, remembrance), kurse nëse përmban dimension publik dhe performativ e shquajmë si përkujtim (commemoration). Në gjuhën gjermane bëhet dallimi më i qartë ndërmjet fjalës Erinnerung, e që ka të bëjë me një lloj “përbrendësimi” (Innerlichkeit) të kujtimit, i cili për nga natyra e përmbajtja është më shumë kufizues e personal, dhe të nocionit Gedächtnis apo edhe Andenken, e që në rend të parë shpërfaq “mendimin” (Denken) mbi ngjarjet, personat apo ndaj monumentit apo memories kolektive. Një shumësi e tillë semantike e gjuhësore rreth termeve e nocioneve dëshmon se tek popujt e ndryshëm ballafaqimi me të kaluarën dhe mënyra se si ajo riartikullohet e shpërfaqet është e ndryshme dhe e larmishme.

Ajo çka kujtojmë nga e kaluara na bën ata që jemi, qoftë si individë apo edhe si pjesëtarë të grupit, kombit apo shoqërisë së caktuar. Prandaj përvojat e së kaluarës, rrëfimi dhe transmetimi mbi të kaluarën janë tejet të rëndësishme dhe vendimtare në formësimin e kujtesës kolektive. Rrjedhimisht edhe ndikojnë dukshëm në formimin e identitetit dhe të bindjeve politike. Kujtesa kolektive krijon dhe rikrijon të kaluarën duke u bazuar në burimet aktuale në dispozicion, si dhe interesat e forcave politike dominuese dhe me më ndikim në shoqëri. Mënyra se si njerëzit kujtojnë të kaluarën gjithashtu pasqyron se si ata e kuptojnë të tashmen, por gjithashtu ndikon në mënyrën se si e ndërtojnë të ardhmen e tyre (Olick, Vinitzky-Seroussi dhe Levy 2011, 3-62). Sikurse kujtesa që ndihmon në formimin e qëndrimeve dhe të përkatësisë së individit, ashtu edhe kujtesa kolektive shërben për të ndërtuar dhe ruajtur identitetin e përbashkët të një bashkësie dhe shoqërie. Kujtesa kolektive kështu u atribuohet në rend të parë entiteteve më të gjera, si kombet, grupet etnike, fetare, shoqërore apo edhe profesionale. Prandaj, të dyja llojet e kujtesës janë të ndërlidhura, në fakt kujtesa individuale është e mundur dhe kuptimplote vetëm brenda një konteksti të gjerë shoqëror.

Dijetari i njohur edhe si themelues i studimit mbi kujtesën kolektive, sociologu francez Maurice Halbwachs (1925), e bën dallimin mes “kujtesës autobiografike” dhe “kujtesës historike”. Sipas tij, lloji i parë i kujtesës ka të bëjë me ngjarjet e jetës së vetë personit që i kujton ato, për shkak se janë përjetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo se ishte dëshmitar i ngjarjeve. Dhe lloji i dytë i kujtesës, pra asaj historike, i referohet “mbamendjes” së evidentuar në çfarëdo forme (të shkruar, gojore, simbolike, materiale etj.) të ngjarjeve nëpërmjet të cilave grupet shoqërore ndërtojnë identitetin e tyre të vazhdueshëm.

Historiani i shquar gjerman Reinhart Koselleck (1988) në veprën e tij shembullore “E ardhmja e kaluar” (Vergangene Zukunft) zhvillon dy koncepte e kategori themelore në trajtimin historik të së kaluarës: shpresën dhe kujtesën. Derisa e para ka të bëjë me pritshmërinë, kategoria e dytë ndërlidhet me përvojën, qoftë të fituar drejtpërdrejt nga përjetimet, apo të formuar nga semantika dhe ndikimet e jashtme me kalimin e kohës. Studiuesja Aledia Assmann (2006) shkon edhe më tej në dallimin e katër niveleve të kujtesës: individuale, sociale, politike dhe kulturore. Ndërsa kujtimet individuale dhe ato shoqërore janë të bazuara në eksperiencën jetësore, kujtimet politike dhe kulturore, nga ana tjetër, janë të bazuara në simbolikë dhe përfaqësimet materiale, si në sistemin arsimor ashtu edhe në pjesëmarrjen kolektive në ceremonitë dhe ngjarjet publike (Assmann, 2006: 215).

Studiues të tjerë theksojnë rëndësinë e “kujtesës së dorës së dytë” ose atë çfarë Marianne Hirsch e quan “paskujtesa” (postmemory), e cila u referohet atyre kujtimeve që barten nga ata që përjetuan ngjarjet, në breza të rinj që nuk i kanë përjetuar personalisht vetë ato. Kjo mënyrë e trashëgimisë së kujtesës së luftës ndikon veçanërisht te gjeneratat që janë lindur gjatë luftës ose menjëherë pas saj dhe kanë ndikim të madh në identitetin e tyre shoqëror, politik dhe kombëtar. Në diskursin politik ashtu edhe në jetën e përditshme kujtimet traumatike dhe përvojat nga lufta vazhdojnë të luajnë një rol të madh dhe rrjedhimisht ndikojnë thellësisht në identitetin e brezave të rinj, që kanë pak ose aspak përvojë nga ajo periudhë kohore. Sidoqoftë, në rastin e kujtimit të luftës format e kujtesës mund të jenë të shumëfishta dhe të ndërthurura.

Gara për pushtet dhe legjitimitet politik ndodh edhe përmes sajimit dhe interpretimit të rrëfimeve, kujtimeve dhe ceremonive e mënyrave të përkujtimit. Tendenca e grupeve etnike në shoqëritë e pasluftës për të imponuar bindjet politike, si dhe kujtimet dhe narracionin e tyre për të kaluarën, do të thotë se nevojiten përpjekje të mëdha për të rindërtuar besimin e ndërsjellë dhe paqen midis bashkësive etnike (Devine-Wright, 2003: 9-33). Kjo gjë është e mundur vetëm nëse e kaluara trajtohet në mënyrë të paanshme, objektive, e siç duhet, dhe nëse arrihet një proces i gjithëmbarshtëm pajtimi mes grupeve dikur të armiqësuar.

Siç e sqarojnë edhe studiuesit Ashplant, Dawon dhe Roper, redaktorë të librit përmbledhës mbi politikën e kujtimit të luftës 'The Politics of War- Memory and Commemoration', studimi i kujtesës së luftës ka të bëjë me orkestrimin zyrtar dhe përcaktimin në përkujtues fizikë dhe ceremonialë, si dhe me modelet e përfshirjes dhe përjashtimit që caktojnë se cilat aspekte të përvojave individuale dhe kolektive duhet kujtuar e përkujtuar. Studimi i kujtesës kolektive, me theks të veçantë të kujtesës së luftës, ka të bëjë me politikën zyrtare rreth paraqitjes së tij përmes manifestimeve dhe përmendoreve fizike dhe me modelet e përfshirjes dhe të përjashtimit që përcaktojnë se cilat aspekte të përvojës kolektive dhe individuale janë të pranueshme të përkujtohen (Ashplant, Dawson, dhe Roper 2000, 10). Sidomos në procesin e ndërtimit të shtetit përfshihen aktorët kryesorë politikë dhe shoqërorë në rindërtimin e së kaluarës. Të gjithë këta aktorë përpiqen të artikulojnë kujtesën kolektive në një mënyrë të tillë që krijon përparësi për këta dhe që nxit formimin e identitetit. Në këtë proces politik Ashplant, Dawson dhe Roper (2000: 16-32) dallojnë tri aspekte kryesore të përpjekjes për të artikuluar kujtimet e luftës: rrëfimet (narracionet), fushëveprimin (arena) dhe aktorët (agjencitë).

Ndërsa rrëfimet e artikulimit u referohen formulimeve të zakonshme dhe diskurseve, arenat paraqesin hapësirat social-politike ku grupet dhe aktorët e caktuar pretendojnë mirënjohjen dhe pranimin për kujtimet e tyre të luftës.

Si një dimension i fundit, agjencitë e artikulimit u referohen institucioneve, organizatave ose lëvizjeve përmes të cilave aktorët socialë kërkojnë dhe ruajnë njohjen e legjitimitetit për kujtimet e tyre të luftës. Sigurisht këto aspekte nuk janë as të ndara rreptësisht e as nuk janë statike në qenien e tyre. Përkundrazi, siç mund ta shohim në Kosovë, ato janë komplementare dhe të ndryshueshme si në përmbajtje ashtu edhe në strukturë. Marrëdhënia midis kujtesës kolektive dhe pushtetit politik zakonisht përshkohet përmes legjitimitetit, e cila mund të arrihet duke evokuar të kaluarën dhe duke promovuar vlera dhe manifestime ideologjike të caktuara për qëllime politike (Müller, 2004: 26-29).

Kujtesa kolektive, ndër të tjera, ka edhe funksionin e përkujtimit të viktimave, por edhe për të mësuar brezat e sotëm dhe të ardhshëm për të kaluarën. Kështu që, kujtimi për ngjarjet dhe përvojat e luftës nuk është vetëm përkujtues i së kaluarës, por bëhet edhe mjet kyç i formimit të identitetit kombëtar. Kujtimi i luftës është interpretuar dhe transmetuar nga rrëfimet zyrtare dhe gjysmëzyrtare mbi këtë të kaluar, mbi monumentet e ndryshme, ceremonitë dhe takimet përkujtimore, si dhe gjerësisht nga historiografia. Të gjitha këto me qëllim të krijimit të legjitimitetit dhe konsolidimit të pushtetit politik, të nxitura e të përvetësuara nga grupet e caktuara shoqërore. Me fjalë të tjera, kush dhe pse vendos se çka dhe si duhet të kujtohet në një shoqëri përcaktohet për nga raporti i forcave dhe pushtetit në atë vend. Sipas historianit gjerman Wolfgang Höpken, në procesin e formimit të shteteve kujtimi i luftës bëhet “gramatika e nacionalizmit” në diskutimet politike dhe rrëfimet publike.

Rrëfimi publik dhe përkujtimi i së kaluarës transmetohet në mënyra të ndryshme nga aktorë të ndryshëm socialë, nga partitë politike dhe grupet e tjera me ndikim (siç janë organizatat e veteranëve të luftës, të familjarëve të viktimave ose shoqata të ngjashme). Të gjithë këta aktorë përpiqen të pranohen si thelbësorë në përcaktimin e kujtesës, të forcojnë legjitimitetin, si dhe të fitojnë pushtet përmes përfaqësimit të ngjarjeve të kohës së luftës, qofshin ato të sakrificave ose të heroizmit të njëmendtë ose të vetëproklamuar (Assmann dhe Shortt, 2012: 1-12).

Përmes artikulimit të kujtimit për luftën elitat politike mund të ndikojnë ndjeshëm në identitete dhe në kujtesa si personale ashtu edhe të shoqërive të tyre. Kujtesa personale, e kuptuar më shumë si “memorie e grumbulluar” në frazën e Olick (1999) dhe ajo kolektive, si “korniza” e kujtesës kombëtare, janë plotësuese. Kështu, kujtesa për çdo grup etnik, religjioz, kombëtar etj., ka ose mund të ketë konotacione, interpretime dhe kuptime të ndryshme. Kështu, pikëpamjet kundërthënëse mbi të kaluarën ndikojnë në qëndrimet dhe perceptimet më të gjera të një grupi, ku grupet konkurrojnë për statusin e viktimës “së vërtetë” dhe të vetme. Qasjet e tilla gjithashtu thellojnë mosbesimin dhe përjashtimin, duke penguar drejtësinë, bashkëpunimin dhe pajtimin mes grupeve e bashkësive të ndryshme. Studiues të shumtë konsiderojnë se ka mjaft rëndësi kalimi nga përvoja personale në kujtesën kolektive të luftës, të dyja të formuara nga kujtimet dhe narracionet e mëparshme e ato ekzistuese.

Kujtimet e luftërave të mëparshme ose ngjarjeve të rëndësishme historike mund të shërbejnë si një kuadër apo model për t'i dhënë kuptim dhe për të interpretuar përvojat e mëvonshme të luftës dhe përkujtimin mbi këtë (Ashplant, Dawson, and Roper, 2000: 34; Müller 2004). Paralele të tilla mund të tërhiqen edhe me ngjarje që janë shumë dekada apo shekuj më herët, siç është rasti më ilustrues te përkujtimi dhe rrëfimi për betejën e Kosovës, e zhvilluar qysh më 1389 (Di Lellio, 2009; Zirojević, 2000: 189–212). Distanca hapësinore dhe kohore, si dhe përvoja e ngjarja e luftës me ngjarjet historike bëhen të parëndësishme në mitizimin e tyre për qëllimin e përkujtimit të luftës.

Duke iu referuar betejës së Kosovës si një “traumë e zgjedhur” serbe, shkencëtari i studimeve të paqes dhe konflikteve, Vamik D. Volkan, shpjegon: “Grupet e mëdha nuk kanë synim të viktimizohen, por ato ‘zgjedhin’ të mitologjizojnë dhe psikologjizojnë përfaqësimin mendor të ngjarjes. Kur kjo ndodh, realiteti i ngjarjes nuk ka më rëndësi për lëvizjet shoqërore.” (Volkan, 2004).



Prandaj janë të rëndësishme jo vetëm kujtimi, por edhe çfarë lloj kujtimi, simboli përkujtimor, apo narrativ historik janë transmetuar. Ajo që mbahet mend në lidhje me të kaluarën e dhunshme në nivel kolektiv varet nga kuptimi që merr për një identitet të përbashkët (Müller, 2004: 1-35). Përkujtimi i luftës është një “luftë” e vazhdueshme e grupeve kundërshtarë që konkurrojnë për njohjen e gjerë të versionit të tyre të së kaluarës, me synimin e arritjes së legjitimitetit dhe pushtetit politik, duke kundërshtuar dhe duke mos përfillur rrëfimet dhe përjetimet e kundërta mbi të kaluarën. Lufta shfaqet si dukuri e paharruar dhe traumatike, e cila i lë mbijetuesit të angazhohen në trajta dhe me intensitet të ndryshëm në përkujtimin e saj. Siç edhe ka vënë në pah Sabrina Ramet (2013: 871-881), duke trajtuar rolin e kujtimeve kolektive dhe të traumave në hapësirat e ish-Jugosllavisë, këto ngjarje vazhdimisht janë duke u përdorur dhe keqpërdorur për qëllime aktuale politike. Kujtime të tilla ndikojnë dukshëm në përcaktimin e kufijve mes grupeve dhe formojnë një ndjenjë të shtuar të “ne” kundrejt “atyre”, duke ndikuar gjithashtu në krijimin dhe legjitimimin e një rendi të caktuar politik.

### 2.3. Mitet kombëtare

Pa rolin e miteve, legjendave, simboleve, por edhe të gjuhës kombëtare vështirë se mund të flitet për formimin e identitetit kombëtar. Këto mundësojnë dhe forcojnë identitetin në atë masë sa që ia japin elementin e nevojshëm të lashtësisë, si dhe hapin shtigjet e vazhdimësisë. Por, çka janë mitet në të vërtetë? A na duhen ato dhe pse na duhen? Këto janë disa nga pyetjet që zakonisht nuk shtrohen, por që duket se janë parësore për të diskutuar dhe për të kuptuar rolin e miteve. Zakonisht mitet perceptohen si legjenda, histori dhe tregime të kaluara për të cilat nuk nevojiten edhe aq shumë prova e fakte shkencore. Miti ka autoritetin e tij jo duke provuar, por duke u shfaqur, sepse zakonisht ka përpjekje për të justifikuar rrëfimet mitike apo edhe për t’i bërë ato të besueshme. Sipas Anthony D. Smith, miti kombëtar është një trajtim specifik i historisë, përzgjedhjes, rizbulimit dhe ricaktimit të një të kaluarë të largët por specifike të tanishmes. Ai e shpreh në këtë mënyrë:

“[Një] mit merr vetëkonfirmim të duhur historik mbi periudhë të gjatë [longue durée], dhe një e kaluar e rizbuluar dhe e vërtetuar përvetësohet ‘shkencërisht’ për qëllimet e tanishme kombëtare” (Smith, 2000: 64).

Në përgjithësi mitet mund të përkufizohen edhe si tërësi idesh, tregimesh e narracionesh me përmbajtje shpesh morale të rrëfyera nga bashkësitë e shoqëritë për vetveten. Mirëpo, ekzistojnë edhe lloje të miteve me të cilat njerëzit janë ngushtë të lidhur, por që në asnjë rrethanë nuk i përshkruajnë e as nuk i konsiderojnë si të tilla. Përkundrazi, ato janë më shumë se rrëfime e përshkrime, këto mite shenjtërohen e bëhen përtej çdo parimi të arsyes ato kuptohen e përjetohen si mision e amanet i stërlashtë. Një lloj i këtillë i miteve, që kanë ndikim të jashtëzakonshëm në historiografinë dhe në vetëdijen kombëtare, dhe të cilat mund të bëhen frymëzim i një kombi janë mitet nacionale. Kështu, vetëpërshkrimi heroik e legjendar i një kombi ndodh jo rrallëherë përmes legjendave, alegorive apo edhe miteve, gjë që, siç na e ilustron mjaft mirë edhe studiuesja Ana-Marie Thiese (2004), është faza e parë dhe më e rëndësishmja në formimin e identitetit kombëtar. Gjithashtu duhet theksuar se miti nuk do të thotë patjetër se është krejtësisht i trilluar, fiktiv apo i pavërtetë, por miti ka atë fuqi që ngjarjet historike t’i shfrytëzojë dhe ritet t’i instrumentalizojë për qëllime politike apo shoqërore. Prandaj mitet mund të përdoren si mjet mjaft efikas, si kundërveprim ose revoltë ndaj një realiteti të hidhur e të padëshiruar social e politik. Miti kombëtar në këtë mënyrë është në thelb i natyrës imagjinare, përfytyruese, por e formëson dhe ndryshon thellësisht realitetin politik duke u shndërruar në pjesë përbërëse të realitetit.

Mirëpo çka ndodh kur mitet, krejtësisht të manipuluar e të pavërteta, vihen në shërbim të pushteteve politike për të anatemuar popuj, si dhe në raste të skajshme edhe për të kryer masakra e dëbime ndaj tyre? Këtë problem tragjik e të kahershëm mundohet ta trajtojë dhe në rastin mjaft domethënës, siç është ai i Serbisë, studiuesi Branimir Anzuloviç (2017).

Si një historian kroat i emigruar kaheerë në ShBA, ai mjeshtërisht shpërfaq burimet mitike e historike të një ideologjie politike, e cila për dekada kultivoi një kulture të përhapur mitesh e të pavërtetash rreth vetes dhe popujve të tjerë, e në rend të parë ndaj shqiptarëve. Kështu që, edhe rrënjët e miteve të tilla mund të gjenden në mitin e famshëm të Betejës së Kosovës, e zhvilluar më 1389, që shërbeu në ngritjen e Miloševićit dhe të një fushate pasuese shoviniste e kriminale. Edhe pse me fakte historike, siç e vë në pah edhe autori, betejat e tjera si ajo e Maricës më 1371 ishin më dramatike dhe më vendimtare për fitoren e turqve në Ballkan.

Krijimi dhe shpërndarja e miteve të rrejshme dhe ideologjive të tilla që çojnë në gjenocid, e filluar nga Kisha Ortodokse Serbe, nga shkrimtarë e intelektualë të njohur si Petar Njegoshi, Dobrica Qosiqi e pasuar nga Akademia e Shkencës dhe e Arteve e Serbisë, dëshmon se sa patologjike mund të jete një mendësi e tillë, e cila shenjtëron veten dhe djallëzon të tjerët. Prandaj, nuk duhet të na çudisë fakti që Kisha serbe i ka pesëdhjetë e nëntë shenjtorë kombëtarë, njëzet e gjashtë prej të cilëve kanë qenë sundimtarë apo pjesëtarë të familjeve sunduese (Anzulović, 2017:40). Krijimi i iluzionit prej popullit hyjnor, me kaq shumë shenjtorë e legjenda për të kaluarën, nuk ka se si të shpjegohet ndryshe vetëm si një tentim për shërimin e traumave nga disfatat e betejave dhe shndrimi i humbjeve në sakrifikim religjioz e triumf transcendent. Kësisoj, Shënsavizmi (Svetosavlje) si një shkrirje e kishës, shtetit dhe nacionalizmit serb, ishte tërësisht në funksion të krijimit dhe propagandimit të ideve pansllaviste. Pas shtjellimit historik të periudhës së mesjetës, ku trajtohen marrëdhëniet e vasalëve serbë me Perandorinë Osmane, ai analizon poemën e famshme “Kurora e maleve” (Gorski vijenac), e publikuar në vitin 1847 nga Petar Petrovič-Njegoš, ku shpërfaqen dhuna dhe gjenocidi ndaj myslimanëve, si frymëzim për ideologët e mëvonshëm të luftërave në Ballkan, sikurse që zbërthehen edhe programet kombëtare serbe si “Načertanije” e deri te Memorandumi i Akademisë, të cilat shërbejnë akoma si platforma ideologjike e manifeste nacionaliste panserbe. Sidomos tani, kur Akademia serbe ka vazhduar edhe më 2012 dhe 2017 me përpilimin e programeve të reja dhe të ngjashme me atë famëkeqen.

Sikurse shumë intelektualë, të cilët tërheqin vërejtjen se popujt që hyjnizohen vështirë se mund të përballen me realitetin tokësor dhe të marrin përgjegjësitë për krimet e së kaluarës, kështu edhe Anzuloviç vë në pah se “mitet dhe gënjeshttrat përdoren për të justifikuar politikat e painformuara dhe për të fshehur injorancën e imoralitetin e krijesve të tyre.” (Anzuloviç, 2017: 284).

Se mitet mund të ideologjizohen dhe të vihen në shërbim të politikave shtetërore e kanë vënë në pah edhe shumë studiues të tjerë si në rastet e Gjermanisë naziste, Italisë fashiste, Bashkimit Sovjetik komunist e deri te mitet moderne politike. Robert Segal (2017) bën një përmbledhje të shkëlqyeshme të studiuesve dhe qasjeve teorike të tyre mbi mitin dhe shpërfaqjen e tij në realitetin shoqëror. Për të përmbyllur shtjellimin mbi mitin do të shërbehemi me përkufizimin sipas së cilit: “[...]për t’u kualifikuar si mit një tregim, i cili mundet të shprehë një bindje, duhet të ketë një qëndresë të fuqishme tek përkrahësit e tij. Megjithatë, tregimi mund të jetë i vërtetë ose i rremë.” (Segal, 2017: 15).

Ashtu sikur krijimtaria popullore dhe rrëfimet e ndryshme gojore që janë përplot me legjenda për ngjarje, dukuri e personalitete të jashtëzakonshme, ngjashëm edhe historiografia dhe kujtesa kombëtare, e më këtë edhe identiteti i pjesëtarëve të saj, formësohen nga mitet sikurse edhe që bashkohen rreth simbolikës e “shenjtërisë” së tyre, pa i cilësuar e perceptuar ato si të tilla. Pavarësisht që pak është hedhur dritë mbi mitet dhe rolin e tyre, sepse trajtohen shpesh si “fakte”, ndikimi i tyre në kombformim vazhdon të mbetet ende i rëndësishëm. Kështu, jo rrallëherë, mitet mbi origjinën, vuajtjet dhe epërsitë hyjnore e historike bëhen ushqyese të doktrinave nacionaliste e nxitëse të urrejtjeve ndaj kombeve të tjera.

## 2.4. Gjuha kombëtare

Gjuha e përbashkët është një nga parakushtet më të rëndësishme për zhvillimin e ndjenjës së përkatësisë, si dhe një bazë për ndërtimin e bashkësisë. Sidoqoftë, Ernest Renan ishte i mendimit se megjithëse luan një rol të rëndësishëm, gjuha nuk është një faktor përcaktues në formimin e kombit. Apo, siç edhe e përshkruan ai thjesht: “Gjuha ju fton të bashkoheni, nuk ju detyron në këtë.” (Renan, 2018). Megjithatë, vështruar historikisht, gjuha ka shërbyer shpeshherë për të homogjenizuar popullatën dhe për të krijuar kulturën e njësuar kombëtare. Në raste të tjera gjuha dominuese ka qenë edhe mjet për diskriminim, përjashtimin dhe asimilimin e grupeve më të vogla gjuhësore. Gjithsesi krijimi i një gjuhe të njësuar dhe të përbashkët është një fenomen i kohëve të fundit. Siç edhe argumenton Ignatieff (1993: 151), kur shpjegon, se deri rreth Luftës së Parë Botërore shumica e fshatarëve evropianë kanë folur, kuptuar e komunikuar me dialekte rajonale. Gjuha letrare zyrtare ishte më shumë mjet komunikimi institucional dhe instrument shtetëror e qeverisës sesa gjuhë që përdorej e kuptohej nga masa e gjerë.

Ndërkaq tani, shumica e kombeve të sotme ose komunikojnë gjerësisht në një gjuhë të përbashkët dhe zyrtare, ose e kanë kombinuar këtë me kalimin e kohës nga gjuhë dhe dialekte të ndryshme për të krijuar një “gjuhë mbarëkombëtare”. Krijimi i një gjuhe kombëtare unifikuese u arrit kryesisht me ndihmën e botimeve të shkruara (libra fetarë, libra shkollorë, gazeta, revista, publikime letrare etj.) të sistemit administrativ, si dhe nga shkollat e sistemi arsimor në përgjithësi, siç edhe do ta shpjegonte Hobsbawm (1992: 67):

“Prandaj gjuhët kombëtare pothuajse gjithmonë kanë diçka të një artefakti dhe nganjëherë, si hebraishtja moderne, janë pothuajse edhe të shpikura. Ato janë e kundërta e asaj që mitologjia nacionaliste pretendon se janë, përkatësisht se janë bazament i lashtë i një kulture kombëtare dhe taban frymëzimi për mendim dhe ndjenja kombëtare.”

Sot, nuk mund të paramendohej ekzistenca e një shteti dhe kombi pa qenë i lidhur përmes gjuhës së përbashkët. Sepse, përmes gjuhës ne njohim, përjetojmë dhe e përshkruajmë botën dhe realitetin tonë, ndërsa përmes një gjuhe të përbashkët ne këto mund t'i komunikojmë e t'i ndajmë me të tjerët. Ashtu siç edhe Ross Poole (1999: 14) e shpjegon këtë supozim më së miri: „(...) ata që flasin të njëjtën gjuhë janë ata me të cilët ne mund të ndajmë përvojat, emocionet, mendimet dhe shakatë tona.”

Sigurisht që ka mjaft kombe ashtu siç ka edhe shumë shtete me më shumë se një gjuhë të vetëm zyrtare, duke filluar nga Zvicra, Kanadaja, India dhe shumë të tjera. Sikurse që ka edhe një gjuhë, e cila flitet në shumë se në një komb dhe shtet, siç është rasti me anglishten, frëngjishten, spanjishten etj., duke u bërë kështu shpeshherë edhe çështje kontestimi, diferencimi dhe dominimi mes bashkësive të ndryshme ose edhe kundrejt një grupi tjetër gjuhësor. Gjuha nuk e përkufizon kombin, por ka ndikim qendror në formimin dhe përcaktimin e tij, sepse gjuha kishte përherë dhe vazhdon të ketë jo vetëm funksionin e komunikimit, por gjithashtu shërben edhe si mjet integrimi përmes së cilës secili njeriu krijon një lidhje emocionale, simbolike dhe ideologjike me kombin. Sidomos alfabetizimi i popullatës në shkrim-lexim në një gjuhë të caktuar kombëtare ishte përcaktuese për vetëdijesim e forcim të identitetit kolektiv.

Kjo mënyrë e krijimit të identitetit dhe vetëdijes kombëtare, si dhe manifestimit e formësimit kombëtar njihet edhe si nacionalizëm gjuhësor. Ky fenomen veçanërisht i theksuar në Ballkan kishte dhe vazhdon të ketë ndikim përcaktues në vetëdijesimin kombëtar. Në këtë kontekst kombi është edhe krijesë kulturore, e ngjizur me gjuhën që pjesëtarët e saj e flasin, simbolet që ata njohin dhe kujtesën kolektive që ata perceptojnë, si tipare përcaktuese të ndjenjës dhe përkatësisë ndaj një kombi. Përveç kësaj, këto ndikojnë në përzierjen e elementeve kulturore me qëllimet politike duke krijuar parakushtet e favorshme dhe të nevojshme për kombformim.

## 3. Qasjet teorike

Në debatin shkencor mbi prejardhjen e kombeve, si dhe mbi faktorët e formimit të tyre janë shfaqur pikëpamje të shumta e të ndryshme. Sikurse edhe më lart tek përkufizimi, që patëm rastin të vërenim se nuk ka ndonjë pajtim të plotë mbi konceptin, edhe në sqarimin teorik mbi kombin e nacionalizmin hasim në laramani qasjesh e kritikash. Për të mos u zhytur më shumë në kokëçarjen përkufizuese e shpesh polemizuese, do të ndalemi tek autorët dhe qasjet kryesore. Këto do të përmbliidhen në tri shkolla të mendimit apo pikëpamje teorike kryesore brenda së cilave ka rryma të ndryshme pastaj. Do të fillojmë me primordializmin, jo për shkak të rëndësisë apo argumentimeve të bazuara shkencore, por si një ndër qasjet më të hershme dhe mjaft të përhapura. Për të shtjelluar më pas qasjen më të pranuar në qarqet akademike, atë të modernizmit, dhe së fundi, por jo për nga rëndësia, do të përshkruajmë atë të etnosimbolizmit.

### 3.1. Primordializmi

Në traditën e romantizmit gjerman, të promovuar sidomos nga dijetarët e poetët si Fichte dhe Herderi, kombi u konceptua si një “bashkësi me prejardhje të përbashkët” dhe si “komunitet i gjuhës” me një histori, kulturë, gjuhë dhe frymë popullore (Volksgeist) të përbashkët. Faktori vendimtar nuk ishte vullneti politik ndaj një kombi, si në rastin e të ashtuquajturit model “francez”, por përkatësia kulturore, historike, gjuhësore dhe morale, elemente që përcaktuan natyrën e kombit. Ky konceptim i kombit u përhap në pjesë të tjera të Evropës dhe përfundimisht në të gjithë botën, me kombet e “rilindura” në këtë kuptim. Në fillim të shekullit XIX, në Evropë, parakusht për kombin, përveç kriterëve të mësipërme, për disa pushtetarë ishte edhe që të posedojë territor dhe madhësi të caktuar të popullsisë, forcë ushtarake dhe kishë kombëtare.

Kjo pikëpamje buronte edhe nga qasja primordialiste, e njohur nganjëherë edhe si esencialiste, e cila e shpjegon kombin si shumë të lashtë, të natyrshëm dhe rrjedhimisht edhe të përhershëm.

Ndonëse në studimet mbi origjinën e kombit dhe të nacionalizmit kjo qasje është e tejkualuar dhe mjaft shumë e diskredituar, tezat primordialiste ende gjejnë përdorim të gjerë si në diskursin nationalist ashtu edhe në debatet akademike mbi këto çështje. Ashtu siç edhe sugjeron emërtimi nga fjala angleze primordial e që ka kuptimin e kahershëm fillestar dhe i lashtë, kjo qasje përkon me besimin e ideologjive nacionaliste se kombet kanë zanafillë shumë të hershme, veçse ato duhet “rizbuluar” për të mbledhur e lidhur hallkat e humbura të lashtësisë së tyre. Ishte Anthony Smith ai i cili e futi i pari në përdorim nocionin primordializëm për të përshkruar këtë qasje mbi nacionalizmin.

Në librin mbi teoritë e nacionalizmit të studiuesit Umut Özkirimli, ai e përshkruan primordializmin si „term ombrellë që përdoret për të përshkruar besimin se kombësia është pjesë ‘natyrore’ e qenieve njerëzore, po aq e natyrshme sa e folura, shikimi apo nuhatja dhe se kombet kanë ekzistuar që nga kohërat më të lashta. Kjo është pikëpamja e vetë nationalistëve dhe ishte për disa kohë paradigma mbizotëruese midis shkencëtarëve, veçanërisht historianëve. Primordializmi përbën gjithashtu pikëpamjen e laikëve për kombet dhe nacionalizmin.” (Özkirimli, 2010: 49). Duke u bazuar në këtë sqarim, një shkollë e mendimit e përhapur sidomos tek historianët dhe deri diku tek antropologët, e njohur si perennialiste (e përhershme), e percepton kombin si shprehje moderne të identitetit etnik paramodern, e rrënjësuar në të kaluarën e largët, si dhe një formë farefisnie e zgjeruar për një periudhë të gjatë kohore. Këtu vlen të përmenden studiues të spikatur siç janë: Adrian Hastings, John Armstrong, Walker Connor dhe Donald Horowitz, të cilët i bashkon pikëpamja mbi lashtësinë dhe ekzistencën e hershme të kombeve, me dallime në nuanca rreth elementeve kyç të saj.

Një qasje më kulturaliste në këtë teori e përfaqësojnë Edward Shills dhe Clifford Geertz, të cilët ofrojnë shpjegimin e solidaritetit grupor si rrjedhojë e lidhjeve “të lashta” që i bashkon njerëzit përmes ngjashmërive kulturore të bazuara në tipare si gjuha, feja, territori dhe farefisi.



Ajo çka e dallon këtë pikëpamje prej primordialistëve të tjerë është se këta studiues pohojnë se kjo afërsi kulturore dhe kjo lidhje e “lashtë” ka të bëjë më shumë me perceptimin e vetë anëtarëve të kombit për këto lidhje, sesa që këto janë të dhëna e faktike. Me fjalë të tjera, primordializmi është në thelb një çështje emocionesh, ndjenjash dhe afiniteti grupor për të krijuar norma, solidaritetet dhe lidhje detyrimi sesa rezultat i thjeshtë i ndërveprimeve sociale.

Ndërsa rryma tjetër e mendimit brenda primordializmit, e njohur si qasja sociobiologjike, pohon se kombet burojnë nga etnitë e të cilat në parim janë farefisni të zgjeruara me prejardhje të përbashkët biologjike. Në këtë qasje hyjnë edhe sqarimi gjenetik dhe evolutiv i përzgjedhjes fisnore, por edhe elementet sociale të lidhjeve, të shkëmbimeve dhe të detyrimeve. Një ndër përfaqësuesit kryesorë të saj, Pierre Van der Berghe, pohon se etnitë janë grupe nga familje e farefise të përhapura si produkt i mekanizmit gjenetik nga martesat të përfaqësuara që i bashkon, si lidhja biologjike ashtu edhe interesi dhe kërkesat e përbashkëta. Sipas tyre, nga grupet etnike krijohen premiset që rezultojnë edhe në formim të kombeve, si vetëdijesim politik i etnive (Özirimli, 2010: 55). Sidoqoftë, kritika më e shpeshtë ndaj primordializmit në përgjithësi, dhe e pikëpamjes sociobiologjike në veçanti, nuk është se e përshkruajnë dhe e trajtojnë kombin si vazhdimësi e formave të kahershme të organizimit shoqëror. Mirëpo, për shkak të faktit se komponentët “objektivë”, siç janë farefisnia, lidhjet gjenetike dhe kulturore, nuk ofrojnë bazë të besueshme shkencore dhe kornizë të vlefshme analitike në shpjegimin e kombformimit dhe të nacionalizmit bashkëkohor. Në botën bashkëkohore, ku jeta e shoqërisë njerëzore është e determinuar sipas normave të caktuara ligjore e në suaza institucionale, atributet e “trashëguara”, sipas primordialistëve, vështirë se të vetme mund ta ngjizin kombin.

## 3.2. Modernizmi

Pa dyshim njëra prej qasjeve teorike më të përhapura dhe më të përfaqësuara nga studiuesit më eminentë të kombformimit dhe të nacionalizmit është e njohur më gjerësisht si moderniste. Në vija të trasha, kjo teori pohon se nacionalizmi u parapriu kombeve dhe se nacionalizmi shfaqet si rezultat i procesit dhe kalimit nga shoqëria tradicionale në atë moderne. Ndërkaq epoka moderne lind me përhapjen e industrializimit dhe tranzicionit socio-ekonomik, politik dhe kulturor, si disa ndër shkaqet kryesore për zhvillimin e vetëdijes dhe premisave për konsolidimin e kombeve. Procesi i modernizimit gjithsesi që fillon më herët, me kalimin e formave agrare e feudale të prodhimit në ato më industriale. Sikurse edhe me renesancën, iluminizmin e revolucionin shkencor, duke kulmuar në Revolucionin Francez, që i dobësoi strukturat religjioze dhe autoritetet monarkiste. Në mënyrë të ngjashme sikur te primordializmi, ku u veçuan tipologji rrymash të ndryshme, ashtu edhe te modernistët hasen së paku tri shkolla kryesore mendimi mbi kombformimin, si: qasja social-komunikative, ekonomike-funksionaliste dhe politiko-ideologjike (Llobera, 1999). Një kategorizim të ngjashëm e hasim edhe te Özkirimli (2009), i cili i ndan teoricienët modernistë në: ekonomikë, politikë dhe socio-kulturorë. Mirëpo, një klasifikim i tillë më shumë i përshtatet studimit të nacionalizmit sesa shpjegimit të shfaqjes së kombeve. Prandaj, do të shërbehemi me tipologjinë e mësipërme për të shtjelluar këto aspekte më gjerësisht.

Në studimin e hershëm mbi nacionalizmin të vitit 1953, Karl Deutsch nënvizon aspektin e komunikimit si një aspekt qendror në formimin e kombeve. Sipas tij, kjo erdhi në konsideratë me procesin e industrializimit, urbanizimit dhe mobilizimit më masiv, të cilat mundësuan komunikim më efektiv dhe më të përhapur mes pjesëtarëve të të njëjtit komb që ndanin gjuhën e njëjtë. Autor tjetër i spikatur i kësaj qasjeje mund të cilësohet edhe Benedict Anderson, i cili në veprën “Bashkësitë e përfytyruara”, e përkthyer në shqip më 2013 si “komunitete imagjinare”, pohon se kapitalizmi i shtypit kishte ndikim qenësor në formimin e kombit, sepse shtypi ndikoi në vetëdijen kombëtare me anë të krijimit të një gjuhe të unifikuar, e cila mundësoi një pjesë të konsiderueshme të popullsisë të lexonte të njëjtat tekste,

të shpërndante ide dhe ndjenja, si dhe të identifikohesh me njëri-tjetrin. Megjithatë, kombi mbetet imagjinar sepse anëtarët e kombit edhe më të vogël nuk do ta njohin asnjëherë shumicën e pjesëtarëve tjerë të kombit, nuk do të takohen me ta ose do të dëgjojnë edhe për ta, ndërsa në mendjen e secilit prej tyre krijohet perceptimi i bashkësisë së tyre. Vlen të theksohet se me imagjinar apo përfytyrues Andersoni nuk e mendon kombin si të pavërtetë, fiktiv apo fals. Përkundrazi, ai e sheh kombin më shumë si njëllëj zëvendësimi të sistemeve të mëparshme kulturore, si dikur bashkësitë imagjinare të dinastive dhe bashkësitë imagjinare fetare, të cilat u dobësuan gradualisht prej shekullit XVII e tutje për t'i hapur rrugë më pas bashkësisë politike të kombeve.

Në anën tjetër, një nga përfaqësuesit më të njohur të teorisë moderniste është Ernest Gellner i cili thekson një varg faktorësh që çuan në formimin e kombeve gjatë modernizimit. Për të në aspektin ekonomik kalimi nga një shoqëri agrare në atë industriale krijoi shtresa sociale, treg më të gjerë dhe dyndje masive të popullatës nga zonat rurale në ato urbane. Këto rrjedhimisht ndikuan në krijimin e konditave për një kulturë të njësuar përmes gjuhës dhe sistemit arsimor. Këto të fundit sajuan një shtresë intelektuale e shkrimtarësh që me nacionalizëm ndikoi përfundimisht në formësimin e kombeve. Ndërsa Gellneri në librin e tij të fundit, botuar pas vdekjes, "Nacionalizmi. Kultura dhe Pushteti" thekson se nacionalizmi është një formë e mendimit, një ide që i paraprin një lëvizje e cila më pas arrin që bashkësinë kulturore ta integrojë në atë politike, përkatësisht në njësinë kombëtare (Gellner, 1995:17). Kjo, ndër të tjera, do të thotë se përkatësitë kulturore duhet të shkrihen me ato shtetërore. Identiteti kombëtar është rezultat i një procesi të gjatë që u sajuar prej standardizimit gjuhësor dhe homogjenitetit kulturor në shtetet e sapoformuara (Gellner, 1983: 45-50). Kështu, nacionalizmi u parapriu kombeve dhe se faktorët strukturorë e ekonomikë në kombinim me ata socialë dhe kulturorë çuan në formimin e tyre. Ndërkaq ajo çka e veçon Gellnerin nga modernistë të tjerë është më shumë qasja e tij funksionale për dallim nga ato marksiste që u japin ngjyrimë ideologjike transformimeve që çuan në epokën e modernes, si dhe sqarimit të faktorëve në formimin e kombeve, siç mund ta vërejmë tek Eric Hobsbawm, Tom Nairn, Miroslav Hroch, Benedict Anderson etj.

Gellneri cilësohet funksionalist, sepse konsideron se nacionalizmi ishte në funksion të zhvillimit ekonomik dhe njëkohësisht derivat i nevojës objektive për homogjenizim. Kjo, sepse “shteti bashkëkohor industrial mund të funksionojë vetëm me një popullatë të lëvizshme, të leximshkrueshme, kulturalisht të standardizuar, të ndërkëmbyeshme.” (Gellner, 2009: 93). Vlen të thuhet se pikëpamjet e Gellnerit mbi kombin dhe nacionalizmin, si brenda qasjes moderniste ashtu edhe përtej saj, mbeten akoma ndër më të rëndësishmet dhe më me ndikim në studimin e kombit. si dhe dukurive e proceseve që e përcjellin atë.

Vështruar në rrafshin politik dhe ideologjik, është studiuesi i mirënjohur John Breuilly (1993) ai i cili mendon se një lloj vetëdijeje dhe ndjenje kombëtare në raste të caktuara ka ekzistuar edhe në Evropën mesjetare. Por, nënvizon se nacionalizmi është tërësisht produkt i epokës moderne dhe se kombet janë të lidhura ngushtë me krijimin e shteteve moderne dhe të sistemit ndërkombëtar. Teza e tij kryesore është se kombet e para lindën në vetë zanafillën e modernizmit, prej shekullit XVI e tutje në Evropën Perëndimore. Këto ndodhën si rezultat i përplasjeve për dominim ndërmjet autoriteteve politike dhe fetare, gjegjësisht ndërmjet pushtetit profan dhe atij kishtar. Krijimi i shtetit modern fillimisht dhe me kalimin e kohës konsolidimi i strukturave shtetërore rezultuan në nxitjen e nacionalizmit dhe kështu hapen rrugën e unifikimit dhe trajtësimit të kombit. Në trajtimin historik të kombformimit, Breuilly përqendrohet tek ndikimi dhe interesat e elitës sunduese më shumë sesa tek shkaqet ekonomike apo ndarjet klasore. Se kombet janë produkt i ndryshimeve politike që kristalizohen në epokën e modernes, është linja e argumentimit edhe të politologut amerikan Paul Brass (1991), i cili e vë theksin tek roli i elitave politike e intelektuale në sajimin e kulturës së përbashkët kombëtare. Kjo kulturë buron nga përzjerja dhe shkrirja e saj prej grupeve të ndryshme etnike në atë më të pushtetshme. Bashkëpunimi i elitave shtetërore me ato të bashkësive të ndryshme etnike në fusha e aspekte të shumta (si ushtarake, politike, tregtare) vendosën bazamentin për zhvillimin e nacionalizmit. Sikurse edhe shumë modernistë të tjerë, edhe Brass nuk harron t’i shtjellojë edhe rrethanat specifike dhe historike të kombeve të ndryshme evropiane gjatë këtij procesi politik e ideologjik.

Vështruar në rrafshin politik dhe ideologjik, është studiuesi i mirënjohur John Breuilly (1993) ai i cili mendon se një lloj vetëdijeje dhe ndjenje kombëtare në raste të caktuara ka ekzistuar edhe në Evropën mesjetare. Por, nënvizon se nacionalizmi është tërësisht produkt i epokës moderne dhe se kombet janë të lidhura ngushtë me krijimin e shteteve moderne dhe të sistemit ndërkombëtar. Teza e tij kryesore është se kombet e para lindën në vetë zanafillën e modernizmit, prej shekullit XVI e tutje në Evropën Perëndimore. Këto ndodhën si rezultat i përplasjeve për dominim ndërmjet autoriteteve politike dhe fetare, gjegjësisht ndërmjet pushtetit profan dhe atij kishtar. Krijimi i shtetit modern fillimisht dhe me kalimin e kohës konsolidimi i strukturave shtetërore rezultuan në nxitjen e nacionalizmit dhe kështu hapen rrugën e unifikimit dhe trajtësimit të kombit. Në trajtimin historik të kombformimit, Breuilly përqendrohet tek ndikimi dhe interesat e elitës sunduese më shumë sesa tek shkaqet ekonomike apo ndarjet klasore. Se kombet janë produkt i ndryshimeve politike që kristalizohen në epokën e modernes, është linja e argumentimit edhe të politologut amerikan Paul Brass (1991), i cili e vë theksin tek roli i elitave politike e intelektuale në sajimin e kulturës së përbashkët kombëtare. Kjo kulturë buron nga përzierja dhe shkrirja e saj prej grupeve të ndryshme etnike në atë më të pushtetshme. Bashkëpunimi i elitave shtetërore me ato të bashkësive të ndryshme etnike në fusha e aspekte të shumta (si ushtarake, politike, tregtare) vendosën bazamentin për zhvillimin e nacionalizmit. Sikurse edhe shumë modernistë të tjerë, edhe Brass nuk harron t'i shtjellojë edhe rrethanat specifike dhe historike të kombeve të ndryshme evropiane gjatë këtij procesi politik e ideologjik.

Emëruesi i përbashkët i të gjithë studiuesve modernistë, pavarësisht përqendrimit të tyre në faktorë të ndryshëm që çuan në shfaqjen e kombit, është pikënisja se kombet janë krijesa të modernizmit dhe se nacionalizmi u parapriu atyre e jo anasjelltas. Mirëpo, kritika ndaj modernizmit lidhet me paqëndrueshmërinë rreth sqarimit të shfaqjes së nacionalizmit dhe të kombeve edhe në treva e raste ku mungonte modernizmi i apostrofuar.

### 3.3. Etnosimbolizmi

Qasja e cila kundërshton shpjegimin primordialist mbi lashtësinë dhe natyrshmërinë e kombeve, por që nuk pajtohet as me sqarimin modernist mbi formimin e tyre, njihet si etnosimboliste. Sipas Anthony Smith, njërit nga eksponentët kryesorë të kësaj teorie, etnosimbolizmi thekson rëndësinë e bashkësive etnike në formimin e kombeve moderne, rolin e kujtesës historike, të mitit mbi origjinën, të heronjve dhe paraardhësve, si dhe lidhjen me një territor, pra atdheun (Smith, 1986). Etnosimbolistët pretendojnë se kombet i paraprijnë nacionalizmit dhe se ekziston një vazhdimësi midis etnive të vjetra, zakonisht në trajtën e etnive më të mëdha e më të pushtetshme, dhe të kombeve moderne. Kështu Anthony Smith e sqaron këtë pohim me përshkrimin: “Nëse kombet janë moderne, të paktën si dukuri të masave të legjitimuara nga ideologjia nacionaliste, ato ua detyrojnë formën dhe karakterin e tyre të tanishëm lidhjeve paraprake etnike, që buronin prej etnive më të hershme në zonat përkatëse.” (Smith, 2008: 69).

Pra, duke mos e hedhur poshtë krejtësisht karakterin modern të kombeve dhe të nacionalizmit, etnosimbolizmi këmbëngul se ide dhe elemente të ngjashme me kombet moderne mund të gjenden edhe në epoka paramoderne, madje edhe në antikitet. Ndërsa epoka moderne nuk ishte tabula rasa, por ishte përplot me formacione shoqërore dhe etnike të periudhave të mëparshme. Prandaj, sipas tyre, kombet nuk u formuan nga hiçi apo vetëm me shfaqjen e industrializimit e modernizimit, por që kanë një trashëgimi kulturore dhe etnike të mëhershme. Këto grupe etnike paramoderne, sipas Smith (2008:71), ishin dy llojesh: etnitë “laterale”, ndryshe fisnike, dhe ato “vertikale”, ndryshe popullore. Ato, secila në mënyrën e vet, ndikojnë në ruajtjen e bashkësisë kulturore historike, që dallon prej grupeve të tjera si për nga stili i jetesës dhe organizimi i tyre social. Anthony Smith konsideron se etnitë janë pjesë përbërëse të kombit dhe se që të dyja janë në një ndërvarësi. Tiparet dalluese të kombit prej etnisë, sipas tij, janë: kultura publike e masës, ekonomia e përbashkët dhe sidomos të drejtat e obligimet ligjore për të gjithë pjesëtarët.

Kjo qasje është shpërfaqur në rend të parë si kritikë e teorisë moderniste dhe primordialiste duke i analizuar elementet kombformuese, të cilat nga qasjet e mësipërme kanë qenë kryesisht të anashkaluara. Etnosimbolizmi, ashtu siç e paraqesin Smith, John Armstrong, John Hutchinson dhe përfaqësues të tjerë, përqendrohet në elementet simbolike të bashkësive etnike, duke pohuar se më shumë sesa tek roli dhe ndikimi i elitave, zanafilla e kombeve duhet të kërkohet te ndërthurja e etnive me kombet dhe të elementeve kulturore të këtyre marrëdhënieve si: mitet, kujtesa, vlera, tradita dhe simbolet. Disa nga pretendimet e tyre kryesore rreth kombit përmbledhtazi janë: se kombet u formuan për periudha të gjata kohore (la longue duree) në proces evolutiv, duke mos u kufizuar në epoka apo ngjarje të caktuara historike, siç mund të jetë, bie fjala, Revolucioni Francez. Kjo u mundësua nga vazhdimësia dhe ripërvetësimi i së kaluarës për të ndihmuar të tashmen dhe të ardhmen e kombeve, e cila burimin e vet e gjen tek grupet etnike, me të gjithë komponentët e tyre kulturorë, simbolet, ritualet, mitet dhe historinë, për të fuqizuar më tej nacionalizmin dhe për të konsoliduar përfundimisht kombin (Smith, 1999: 9-19).

Me gjithë faktin se shfaqet si qasje alternative duke kritikuar të metat e modernizmit dhe pamjaftueshmërinë argumentuese të primordializmit, kritika më qenësore që i bëhet etnosimbolizmit, është se nuk arrin saktësisht të sqarojë dallimin ndërmjet etnive dhe kombeve, duke shkaktuar si pështjellime përkufizuese ashtu edhe paqartësi kuptimore rreth kombit dhe formimit të tij. Gjithashtu, etnosimbolizmi kritikohet se përqendrohet së tepërmi tek elementet kulturore e simbolike duke anashkaluar dhe neglizhuar aspektet socio-ekonomike dhe politike të kombformimit. Kritika shkon edhe për mungesë të një kornize analitike e metodologjike që do të mundësonte hulumtimet mbi ndikimet apo manifestimet bashkëkohore të kombit, si dhe kombëtarizimit në përgjithësi.

Përtej qasjeve të mësipërme, kombi dhe nacionalizmi shqyrtohen si ideologji dhe si lëvizje politike edhe nga pikëpamje të tjera teorike. Varësisht prej pikëpamjes, si gjinore, kulturore, institucionale apo edhe simbolike, ajo vihet në konotacion me qasjet analitike në kuadër të feminizmit, institucionalizmit, analizës së diskurseve, kërkimeve antropologjike etj. Viteve të fundit ka studime të shumta që i qasen kombit “nga poshtë”, përkatësisht mënyrës se si njerëzit e rëndomtë përjetojnë dhe shfaqin kombësinë në përditshmërinë e tyre (Fox dhe Miller-Idriss, 2008). Studime janë shtuar edhe mbi atë se si kombi nëpërmjet trajtave simbolike, ceremonive dhe praktikave të përditshme manifestohet nga ana e shtetit dhe institucioneve, në atë që emërtohet nga disa edhe si “nacionalizëm banal” (Billig, 1995).



## 4. Kombësia dhe Shtetësia

Edhe pse në praktikë këto dy nocione shpeshherë ngatërrohen ose përdoren si të njëjta, konceptualisht ka dallime evidente mes tyre. Sociologët britanikë David McCrone dhe Richard Kiely theksojnë se kombësia dhe shtetësia u përkasin dy niveleve të ndryshme të kuptimit dhe i dallojnë këto si më poshtë: “E para është në thelb një koncept kulturor që lidh njerëzit në bazë të identitetit të përbashkët - në frazën e përshtatshme të Benedict Anderson si një “komunitet i imagjinuar” - ndërsa shtetësia është një koncept politik që rrjedh nga marrëdhënia e njerëzve me shtetin.” (McCrone dhe Kiely, 2000: 25).

Mirëpo, para se të merremi me identitetin kombëtar dhe atë shtetëror, do të ishte e udhës që të shqyrtojmë konceptin e identitetit, përkufizimet dhe format e paraqitjes së tij. Në kuptimin etimologjik fjala identitet e ka prejardhjen nga termi latin “Idem” që do të thotë “i njëjtë” ose “identik” me diçka ose dikë, dhe në këtë formë shfaqet në shumicën e gjuhëve indoevropiane. Nocioni i identitetit është huazuar nga psikologjia sociale, gjë që çoi te një ndryshim semantik dhe transformim në konceptim. Kështu që, nga përkrahimi i thjeshtë i raportit me objekte - “identik” u kalua në raportin me subjekte - “identifikim”, dhe ky konceptim është përfshirë në shkencat shoqërore (Walkenhorts, 1999:19).

Edhe politologu amerikan James D. Fearon bëri një hulumtim mjaft interesant mbi domethënien dhe kuptimin e nocionit të identitetit. Duke bërë një analizë të qasjeve dhe autorëve të ndryshëm, Fearon konstaton se identiteti në përgjithësi ka domethënie të dyanshme, në një rëndësi do të thotë kategori sociale dhe në anën tjetër identiteti behet burim i “vetëpërkrahimit” dhe “vetërespektimit” individual (Fearon, 1999: 2). Ndërsa studiuesit Rogers Brubaker dhe Frederick Cooper shtjellojnë çështjen e identitetit në diskursin e gjerë shkencor. Sipas tyre, për shpjegimin e identitetit përdoren kryesisht dy qasje teorike: teoria esencialiste dhe ajo konstruktiviste. Derisa e para thekson se identiteti ose identitetet janë të dhëna, qasja e dytë argumenton se identitetet janë të sajura, pra, thënë ndryshe, të shpikura.

Në shumicën e diskutimeve akademike kritikohet qasja esencialiste dhe mbizotëron këndvështrimi konstruktivist mbi identitetin (Braubaker/Cooper, 2000:1-6). Përdorimi i nocionit identitet bëhet sipas tyre në disa forma që japin edhe kuptime dhe koncepte të ndryshme:

- ▶ Identiteti nënkupton bazën dhe themelin e veprimeve shoqërore dhe politike, ku theks i veçantë i vihet diferencimit ndërmjet partikularizmit (të përbashkët) dhe universalizmit (të gjithëmbarshtëm).
- ▶ Identiteti nënkupton një fenomen specifik shoqëror, që shënon bazamentin e përbashkësisë-unitetit (sameness) ndërmjet anëtarëve të një grupi ose kategorie shoqërore të caktuar. Ky lloj identiteti përdoret zakonisht në letërsi, pastaj për studime gjinore, rasore, etnike apo nacionale.
- ▶ Identiteti nënkupton bërthamën (individuale ose kolektive) të “mëvetësisë” (selfhood) ose bëhet kusht fundamental i qenieve shoqërore, që zgjon tek pjesëtarët e tij edhe diçka të thellë, bazike dhe themeluese. Kjo formë përdoret zakonisht në literaturën psikologjike.
- ▶ Identiteti si prodhim i veprimeve shoqërore dhe politike përmban dhe shquan zhvillimet, proceset dhe ndërveprimet të një lloj vetëperceptimi kolektiv, solidariteti grupor, që bëjnë të mundshëm veprimet kolektive. Aplikimi i këtij lloj konceptimi vlen zakonisht në hulumtimin e “lëvizjeve të reja sociale”.
- ▶ Identiteti nënkuptohet si rezultat i diskurseve të shumëfishta dhe konkurruese. Sidomos tek poststrukturalizmi i Michel Foucault dhe tek postmodernizmi kjo formë gjen një përdorim të gjerë. (Braubaker/Cooper, 2000: 6-8).

Sikurse edhe shumë studiues të tjerë, edhe këta autorë konstatojnë se identiteti ka një karakter të dyanshëm. Kështu, ata pohojnë se ndarja kryesore qëndron midis modelit relacional dhe atij kategorial. Derisa në disa raste identiteti shquhet prej raportit të personit apo grupit njerëzor me të tjerët dhe varet nga marrëdhëniet ndërmjet tyre (p.sh: lidhjet farefisnore, martesore, shoqërore, etj.), në anën tjetër dikush mund të identifikojë veten (ose edhe dikë tjetër) përmes pjesëmarrjes në një grup të caktuar me të cilin ndan disa attribute kategoriale të përbashkëta, si p.sh: gjinia, gjuha, rasa, shtetësia, etniteti, kombësia etj.

Por, identiteti nuk përmban kurrë vetëm një atribut, përkundrazi identiteti është gërshetim i një mori komponentësh dhe nuk është diçka rigide, por një fenomen permanent dinamik me karakter ndryshues. Kjo dukuri në shkencat shoqërore njihet edhe si “identitetet e zhvendosura” (shifting identities). Identitetet në këtë kuptim nuk janë të paracaktuara, të dhëna e as të natyrshme, por të ndryshueshme, të lëvizshme dhe fluide. Me fjalë të tjera, identiteti nuk është esencial, i përcaktuar qysh në lindje, por konstruktiv, që do të thotë se krijohet, plotësohet apo ndryshohet në vazhdimësi. Nga të dhënat historike nxjerrim dëshmi se shoqëritë njerëzore kishin përkatësi të ndryshme identitare, në disa raste të bazuar mbi afërsinë fisnore e territoriale, në disa raste mbi besimin e përbashkët dhe religjionin, në raste të tjera për shkak të përkushtimit e besnikërisë ndaj sundimtarit (qoftë ai sulltan, mbret, car, kaiser, perandor apo princ) apo kurorës mbretërore.

Siç u cek edhe më herët, në kohën e sotme kur flitet për identitetin zakonisht mendohet në atë kombëtar, si një ndër format më të dalluara dhe më të rëndësishme të identiteteve kolektive bashkëkohore, gjë që edhe këtu në libër do t’i kushtohet hapësirë dhe vëmendje e veçantë.

## 4.1. Identiteti kombëtar

Identiteti është rrjedhojë i faktorëve të shumtë, të lidhur dhe komplementarë ndërmjet vete, si kushtet ekonomike, rrethanat socio-politike, kulturore, historike etj. Në të njëjtën kohë, edhe pasqyrim i të gjithë këtyre faktorëve. Dikush mund t'i japë njërit element prioritet më të madh sesa tjetrit, për dikë përnjëmend ndonjëri prej tyre mund të jetë i një rëndësie jetike. Por, në të vërtetë ato vetëm si tërësi dhe të ndërlidhura ia japin një kuptim identitetit, qoftë ai kombëtar, shtetëror apo çfarëdo qoftë.

Aspekti ekonomik, bie fjala, bëhet përcaktues pasi çdo shoqëri përmban disa shtresa shoqërore dhe përkatësia në një status të caktuar shoqëror bëhet e mundshme dhe e zbatueshme vetëm në bazë të kushteve materiale. Në anën tjetër, kultura si një simbiozë e të mirave shpirtërore e artistike me ato materiale, i trason marrëdhëniet ndërmjet individëve dhe shoqërisë, kështu që në këtë kontekst mund të supozohet se identiteti është shprehje kulturore. Mirëpo, identiteti kulturor s' do të thotë se është domosdo i njëjtë me atë kombëtar. Me gjithë ndikimin e tyre në identitetin kombëtar, aspektet kulturore dhe gjuhësore mund të jenë nganjëherë të kufizuara brenda suazave lokale ose regjionale dhe me këtë përbejnë vetëm një pjesë të identitetit të tërësishëm kombëtar.

Prandaj, me të drejtë Ernest Gellner përdor nocionin "kultura e lart-njësuar" (high culture) për të definuar sintetizimin e kulturave në një kulturë më të lartë dhe homogjene në atë kombëtare. Përkatësia kombëtare bëhet e mundur, sipas tij, bazuar në atributet e përbashkëta kulturore, "ku kultura, më tutje, ka domethënien e një sistemi të ideve, të simboleve, të asocimeve dhe të mënyrave të sjelljes, si dhe të komunikimit." (Gellner, 2009: 35) Kultura e përbashkët mundëson përafrim edhe voluntarist, pra njohja e njëri-tjetrit si bashkëkombës me të drejta e detyrime të ndërsjella dhe besnikëri, vlera e solidaritetit mes tyre.

Sidoqoftë, kombësia gjegjësisht identiteti kombëtar është trajta më e shprehur dhe mbizotëruese e identitetit kolektiv në shoqëritë bashkëkohore.

Ato formohen paralelisht me krijimin e shteteve, si agjentë të fuqishëm të krijimit të identitetit. Shtetet kanë në dispozicion të gjitha mjetet, autoritetin, institucionet e nevojshme, si sistemin arsimor, mediat masive, historiografinë dhe forma tjera ndikimi e detyrimi, për të ngjizur dhe përforcuar identitetin kolektiv. Karakteri dialektik i identitetit qëndron në faktin se një grup i caktuar shoqëror formohet vetëm atëherë kur përballet dhe është i dalluar nga kolektivi tjetër. Apo me fjalët e Richard Jenkinsit (1996 :4) identiteti i referohet mënyrës në të cilën individët sikurse edhe grupet janë të diferencuara në marrëdhëniet shoqërore me individët apo grupet e tjera.

Anthony D. Smith, studiues tjetër eminent i nacionalizmit dhe autor i librit "Identiteti kombëtar", shqyrton çështjen e identitetit në një rrafsh më të gjerë dhe na ofron një kategorizim mjaft ndihmues të tij. Ai po ashtu thekson se identitetet, qoftë individuale ose kolektive, janë gjithmonë rezultate të ndryshueshmërisë dhe dallueshmërisë karshi tjerëve. Sipas Smithit, në thelb janë tri kategori që identitetin e një personi apo grupi e formojnë apo atë edhe e determinojnë.

- ▶ Së pari e veçon kategorinë gjinore - kriteri biologjik.
- ▶ Pastaj, sipas tij, vjen kategoria territoriale, respektivisht hapësinore, si p.sh. identiteti regjional, lokal etj.- kriteri gjeografik.
- ▶ Kategoria klasore, përkatësisht e shtresës shoqërore - kriteri social ( Smith, 1991: 4).

Për kategorinë e parë mund të thuhet se identifikimi apo edhe diferencimi janë në shumicën e rasteve, me përjashtime të rralla të ndërhyrjeve kirurgjike, të dhëna, si për nga natyra biologjike ashtu edhe për nga rrethanat e përcaktimet shoqërore.

Në rastin e dytë, konstaton Smithi, identiteti lokal, krahinor ose në përgjithësi ai territorial është mjaft i përhapur, kufijtë e të cilave identitete nuk janë qartë të përcaktuar, porse janë fluidë dhe me kalimin e kohës të ndryshueshëm.

Këto gjera ndikojnë dukshëm edhe në karakterin e identitetit, në kuptimin e përfaqimit kulturor, ndikimit të vlerave, afërsisë sociale apo edhe atij sentimental.

Së treti, Smithi e klasifikon identitetin në shtresa shoqërore dhe sqaron se me këtë ai nuk nënkupton “klasën” në konceptimin klasik të Marxit apo të Weberit. Ai thekson se përveç aspektit ekonomik, që në fakt është mjaft i rëndësishëm, në këtë kategori hyjnë edhe elementet e tjera, si p.sh. vendi, zakoni, tradita etj. Për të klasa apo shtresa shoqërore shënon marrëdhëniet brendashoqërore, andaj brenda një shoqërie mund të ekzistojnë disa shtresa, që zakonisht janë në konkurrencë ndërmjet vete. Ai nuk harron të sqarojë edhe faktin se në të kaluarën edhe identiteti religjioz, edhe ai etnik ishin të përfshira në identitete të ndryshme klasore. Për ilustrim Smith shtjellon rastin e kishës mesjetare në Evropë, pjesëtarët e së cilës i përkisnin një shtrese të caktuar dhe predikonin për një klasë të veçantë (në gjuhën latine, si gjuhë zyrtare e kishës), do të thotë për klasën e lartë apo atë të mesme. Deri në kohën e lindjes së nacionalizmit (shek. XVIII dhe XIX) identiteti religjioz dhe ai etnik (shpesh edhe në lidhje të ndërsjella reciproke) patën një rëndësi të veçantë dhe ishin faktorë kryesorë në përcaktimin dhe formimin e identitetit kolektiv (Smith, 1991: 5-8). Mirëpo, identiteti më i përhapur dhe në kohën moderne më i rëndësishmi pa dyshim është identiteti kombëtar. Krijimi i identitetit kombëtar është qëllimi kryesor i çdo projekti kombformues. Prandaj homogjenizimi dhe përforcimi i këtij identiteti bëhen forcë shtytëse prapa çdo ideologjie dhe lëvizjeje nacionaliste.

Monserrat Guibernau, një studiuese tjetër e shquar e nacionalizmit dhe e identitetit, e përkufizon kombësinë në këtë mënyrë: “si një ndjenjë kolektive e bazuar mbi besimin e përkatësisë në të njëjtin komb dhe të ndarjes së shumicës së attributeve që e bëjnë atë të dallueshëm nga kombet e tjera” (Guibernau, 2007: 11).

Më tutje Guibernau (2007: 125-141) identitetin kombëtar nuk e klasifikon në bazë të kriterëve apo attributeve themelore, por duke u bazuar në pesë dimensione të ndryshme kryesore:

1. Në dimensionin psikologjik, identiteti është produkt i vetëdijes së një grupi të formuar që bazohet në rrafshin emocional e njohës (kognitiv).
2. Procesi i identifikimit me një kulturë të caktuar nënkupton edhe një lidhje emocionale ndërmjet pjesëtareve të grupit dhe rezulton me një ndjenjë solidariteti mes tyre.
3. Identiteti i një individi përcaktohet edhe në bazë të rolit që ka ai/ ajo në një territor të caktuar respektivisht të kufizuar.
4. Historia është faktor që ndikon jashtëzakonisht në ndërtimin e një botëkuptimi për kombin dhe njëkohësisht instrument me të cilën vetëdija kombëtare formohet e forcohet dukshëm.
5. Dhe së fundi, dimensionin politik i kombit është i lidhur ngushtë me shtetin modern, ose, siç e formulon ajo: “Kjo nënkupton që shteti përzgjedhi dhe imponoi kulturën dhe gjuhën e grupit dominues brenda territorit të tij dhe synoi të krijonte një komb të vetëm nga kombet e ndryshme ose pjesëve të kombeve që e formonin atë.” (Guibernau, 2007: 139).

Në shoqëritë moderne identiteti kombëtar përbën identitetin themelor, duke bashkeqzistuar dhe duke u ndërthurur me trajta të tjera të identitetit, si; fetare, lokale, gjuhësore, të profesionit etj. Në rrafshin individual nacionalizmi manifestohet në dhe përmes identitetit kombëtar, duke shfaqur botëkuptimin nationalist mbi realitetin, si nëpërmjet veprimeve (diskursit e simbolikës) ashtu edhe qëndrimeve (bindjeve e sjelljeve). Ky “botëkuptim” karakterizohet me proceset historike dhe parimet themelore që e përbëjnë këtë vizion dhe me këtë edhe vetë identitetin kombëtar. Së pari me atë shekullar, pastaj me perceptimin egalitarist, si dhe me idenë mbi sovranitetin popullor.

Sipas tyre, identiteti kombëtar mund të ndahet në tri lloje të dallueshme: individualiste-qytetare, kolektiviste-qytetare dhe kolektiviste-etnike, të cilat kanë edhe implikime të ndryshme si për vetë kombet, sistemin e tyre qeverisës, ashtu dhe për sistemin ndërkombëtar (Greenfeld/ Eastwood, 2007: 271). Sipas studiueses amerikane Liah Greenfeld (1992), kombësia përbën trajtën unike të vetëdijes shoqërore e shtresëzuar historikisht, që konsiston në përkushtimin politik, moral dhe kulturor të anëtarëve të saj. Ndërsa Habermas (2001) është i mendimit se zhvillimi i vetëdijes kombëtare lidhet me solidaritetin qytetar si pikënisje dhe themel i kulturës së përbashkët, të cilat ishin parakushtet thelbësore për formimin e shtetit bashkëkohor.

Gjithsesi, identiteti kombëtar bëhet i realizueshëm dhe i përmbushur kur korrespondon me atë shtetëror apo së paku nuk bie ndesh ose pengohet nga ai shtetëror. Kjo është edhe arsyeja që shpeshherë këto dy emërtime përdoren dhe nënkuptohen sikur sinonime. Për ilustrim mund të marrim këtu dokumentet zyrtare identifikimi, udhëtimi, si dhe formularët e shumtë ndërkombëtarë, kur rubrika me “nationality” nuk përkon domosdo me kombësinë, por në fakt nënvizohet ose lypset “shtetësia”. Këtë shembull e ilustronjë më së miri edhe dokumentet në Kosovë. Sikurse edhe shembuj të tjerë të emërtimeve të institucioneve shtetërore me titujt kombëtarë (si teatro, biblioteka, institute etj.), edhe pse mund të jenë shtete shumëkombëshe dhe nuk dihet se cilit komb saktësisht iu referohen ato.

Këto dhe shumë raste të tjera e të ndryshme demonstrojnë që ka një ngatërrësë si konceptuale ndërmjet tyre ashtu edhe implikime praktike në përdorimin dhe jetësimin e tyre. Prandaj do të shtjellohet edhe identiteti shtetëror për të parë më mirë dallimet, përafrimet dhe ndërvarësinë mes kombësisë dhe shtetësisë.



## 4.2. Identiteti shtetëror

Kombësia dhe shtetësia (qytetaria) janë dy koncepte të ndryshme dhe dallohen prej njëra-tjetrës, por u përkasin sferave që janë të ndërlidhura ngushtë mes vete. Të dy konceptet, të cilat mund të kenë përkufizime të panumërta, janë kuptuar këtu në atë mënyrë ashtu siç edhe Isin dhe Wood i dallojnë: “Shtetësia shënjon/dallon anëtarët e një entiteti politik nga një tjetër, si dhe anëtarët nga joanëtarët. Identiteti shënjon grupet nga njëri-tjetri, si dhe mundëson krijimin e grupeve përmes ndihmesës, urrejtyes, armiqësisë, simpatisë ose besnikërisë së përbashkët.” (Isin/Wood, 1999: 20)

Të drejtat dhe detyrimet ligjore, tatimore dhe kushtetuese janë kritere që përcaktojnë anëtarët e një shteti pra, shtetasit. Në kuptimin e ngushtë, shtetësia i referohet statusit të barazisë dhe pjesëmarrjes politike, kurse në kuptimin e gjerë u referohet statusit dhe pjesëmarrjes në jetën shoqërore, kulturore e ekonomike. Pas Revolucionit Francez u shqua dallimi ndërmjet “citoyen”, që kuptohej si qytetar/shtetas, dhe “bourgeois” si shtresë qytetare, ku në të parën përfshiheshin të gjithë banorët brenda shtetit me të drejta dhe detyrime të barabarta, ndërkaq në kategorinë e dytë merrnin pjesë vetëm shtresa më e lartë dhe më e privilegjuar e shoqërisë e njohur gjerësisht si borgjezët.

Nëse e shtjellojmë historikisht, shtetësia apo e kuptuar shpeshherë edhe si qytetaria është e lidhur me formimin dhe fuqizimin e qyteteve mesjetare në Evropë. Sepse këto qytete si pararendëse të organizimit politik, ekonomik dhe kulturor ishin me një shoqëri paksa më autonome dhe të mëvetësishme sesa perandoritë e mëdha apo mbretëritë absolutiste. Krijimi i qytetarisë ka të bëjë edhe me lindjen e një shtrese shoqërore, e cila dallon nga bujqit, klerikët, ushtarakët apo nga fisnikëria mbretërore. Trajtat e hershme të qytetarisë i gjejmë edhe në Greqinë antike me “polites”, pra banorët e Polisit (qytet-shtetit) dhe idesë filozofike të stoicizmit për “kosmopolities”, qytetarinë mbarëbotërore. Ngjashëm mund të pohohet edhe për konceptin aristotelian që me Polis nuk nënkuptonte vetëm shtetin apo qytetin, por në të përfshinte edhe ato segmente që ne sot i konsiderojmë shoqëri apo qytetari.

Qytetaria në një formë të veçantë shfaqet gjatë Perandorisë Romake si “civis”, qytetar të Romës që formonin qytetarinë romake “civitas” e që merrte kuptimin e shoqërisë, bashkësisë së caktuar politike.

Më tej periudha gjatë mesjetës së vonshme në Evropë u ndikua në masë të konsiderueshme nga këto veçori: nga feudalizmi, si rend mbizotërues politik, ekonomik e shoqëror; luftërat e shpeshta e të përgjakshme; absolutizmi i pushtetit; shpërndarja e pabarabartë e të mirave; hierarkia e ngurtë brenda shoqërisë; ashpërsia e njësive politiko-ushtarake që shpërbeu qytetarinë edhe ashtu të brishtë e të paktë, si dhe përgjithësisht nga pushteti i kishës. Meqenëse qytetaria si forcë politike ishte e përqendruar kryesisht brenda kështjellave, shtrirja e tyre ishte tejet e kufizuar, gjë që pamundësoi zhvillimin ekonomik dhe fuqizimin politik të tyre. Rritja e dukshme e tregtisë dhe formave të reja të organizimit ekonomik (merkantilizmit) çuan edhe në rritjen e qyteteve si për nga madhësia ashtu edhe për nga rëndësia. Kjo përbën edhe lindjen e asaj që francezët e quajtën “la bourgeoisie” borgjezisë, e cila përbente “shtresën e tretë” përballë aristokracisë dhe fshatarësisë. Pikërisht kjo shtresë shoqërore ishte vendimtare për krijimin e premisave që çuan në Revolucionin Francez të vitit 1789 me thirrjen për liri, barazi e vëllazëri. Këto zhvillime më pas, krahas industrializimit dhe krijimit të shteteve moderne, çuan në formimin e “citoyen”, pra qytetarisë/shtetësisë.

Përtej vlerësimit normativ mbi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, çështja thelbësore se çka e përbën qytetarinë është objekt i debateve të shumta, konteksteve të ndryshme dhe rregullave të ndryshueshme me kalimin e kohës. Kështu, studiuesi T. H. Marshall në njërën nga studimet e para mbi shtetësinë, e titulluar ‘Citizenship and Social Class’ të fillimviteve 1950, ngriti debatin dhe interesimin akademik rreth kësaj çështjeje duke e përkufizuar shtetësinë si “anëtarësim i plotfuqishëm në komunitet”. Me këtë nënkupton, sikurse edhe e paraqet atë, si barazi në të drejtat dhe detyrat për të gjithë pjesëtarët e komunitetit. Marshall tutje dallon shtetësinë në të drejta qytetare (civile), politike dhe në ato sociale, të cilat u zhvilluan si të tilla në një lidhje zinxhiri.

Shtetësia civile u zhvillua gjatë shekullit XVIII dhe konsistonte në të drejtat dhe liritë themelore si për shprehje, besim, mendim ashtu edhe për gjykim të drejtë dhe për të drejta pronësore. Shtetësia politike e krijuar gjatë shekullit XIX përfshinte të drejtën e votimit dhe të pjesëmarrjes në institucionet politike. Shtetësia sociale u formua në shekullin XX, kur u themeluan të drejtat sociale, si ato që përfshijnë asistencat e ndryshme shtetërore për të papunët, invalidët dhe kategoritë e tjera sociale, sigurimet shëndetësore dhe të drejtat për pushim mjekësor, pushim të lehonisë etj. Secila nga këto etapa korrespondon edhe me sistem e institucione thelbësore të shtetit, siç janë: sistemi gjyqësor, parlamenti dhe sistemi i mirëqenies sociale.

Derisa disa shtete e kanë përcaktuar atë mbi bazën e lindjes ose të vendlindjes, disa shtete të tjera e rregullojnë mbi bazë të përkatësisë etnike, kulturore ose kombëtare. Në disa shtete lejohen dy ose më shumë shtetësi, disa të tjera ndërkaq e kanë kufizuar në vetëm një shtetësi. Pra, në aspektin formal e juridik çështja e shtetësisë/ qytetarisë rregullohet me legjislacionin e shteteve përkatëse. Gjithsesi, vlen të nënvizohet se qytetaria nuk përfundon vetëm me të qenit bartës i shtetësisë. Përkundrazi, është vetëm fillimi i të drejtave dhe detyrimeve të cilat përmbajnë angazhime, vlera dhe kuptime të caktuara. Bie fjala, shumë kohë para se të kishin të drejtën e votës, gratë në shumë vende ishin de jure shtetase. Në raste të tjera qytetaria formale nuk mund të përkthehet edhe në legjitimitet dhe lojalitet ndaj shtetit, sikurse që edhe statusi juridik i qytetarisë nuk do të thotë patjetër që të gjithë qytetarët gëzojnë barazi sociale, ekonomike apo liri politike të njëjtë. Kështu që, shtetësia në formën e një statusi trivial nuk është e barabartë me qytetarinë si subjekt politik e moral, me qytetarinë që synon kohezion social e kombëtar si dhe përligjen e shtetit.

Çështja e shtetësisë nuk është vetëm çështje e të drejtave dhe detyrimeve të individit, por gjithnjë e më shumë është temë e përplasjeve të ashpra politike, veçanërisht në një vend me përbërje të shumëllojshme etnike, fetare dhe me shkallë të lartë të emigrantëve. Së këndejmi qytetaria ndërlidhet me aspekte të shumta, siç janë: siguria, demokracia, toleranca e deri tek ajo esenciale, raporti me shtetin.

Stabiliteti politik, demokracia, qeverisja dhe vetë zhvillimi varen në masë të madhe nga raporti mes shtetit dhe shtetasve, respektivisht nga veprimet dhe sjelljet e qytetarisë. Por në shumicën e rasteve shtetësia, e cila bazohet në marrëdhëniet legale (obligimet ligjore, të drejtat kushtetuese etj.); politike e sociale (pjesëmarrja politike, shkollimi, shërbimi ushtarak, tatim-pagesat); si dhe simbolike (identifikimi me simbolet, figurat, të kaluarën) synon të jetë në përputhje me identitetin nacional. Kjo do të thotë që shtetësia rrjedh nga identiteti i përbashkët kolektiv, nga ndjenjat subjektive të përkatësisë, po aq sa edhe nga të drejtat formale të bazuara në kornizën ligjore (Van Gunsteren, 1998).

Sqarim për konceptin e shtetësisë jep edhe politologu dhe studiuesi i shquar i shtetësisë, polaku Ireneusz Pawel Karolewski, i cili e vë në pah aspektin relational të saj në kuadër të këtij trekëndëshi. Së pari, shtetësia përfshin marrëdhëniet e shtetasve me njëri-tjetrin, me të cilët formojnë një bashkësi politike dhe parimisht një identitet kolektiv. Pastaj, përfshin raportet e secilit shtetas me autoritetin politik, pra shtetin të cilit i përket. Dhe së fundi, marrëdhëniet ndërmjet elementeve përbërëse të shtetësisë, e këto janë; të drejtat, detyrimet dhe pajtueshmëria e shtetasve (Karolewski, 2010: 10-19). Kjo, përveç tjerash, nënkupton që edhe raportet shkëmbyese ndërmjet elitave shtetërore dhe masës së popullsisë duhet të institucionalizohen dhe të përmirësohen, në mënyrë që me kalimin e kohës të krijohen lojaliteti i ndërsjellë dhe ndjenja e identitetit të përbashkët.

Pikë referuese për qytetarinë është shteti, i cili është njëkohësisht premisë dhe garantues i lirisë dhe përfaqësimit politik. Bartës i identitetit shtetëror është pra shteti. Prandaj edhe komb-shteti ose shteti kombëtar nënkuptohet si përputhje e njësisë kombëtare dhe shtetësisë. Nëse për identitetin kombëtar frymëzues edhe ideologjia themelore del të jetë nacionalizmi, për qytetarinë këtë funksion e kryen patriotizmi, pra atdhedashuria. Mirëpo, çka nëse këto dy parime nuk përputhen me njëra-tjetrën ose bien në kundërshtim mes vete, si bie fjala, kur brenda një shteti jetojnë kombe të cilat pretendojnë që të dominojnë dhe të shkrijnë përkatësinë kombëtare me atë të përkatësisë së gjithë qytetarëve.

Kjo mund të ketë pasoja të shumëfishta dhe ndryshme, dhe varësisht prej situatës dhe vendit mund të shkaktojë diskriminim, asimilim ose dominim të një pale ndaj tjetrës. Apo, në disa raste, edhe pretendime politike për shkëputje territoriale, gjë që jo rrallëherë çon edhe në konflikte të përgjakshme, ashtu siç i njohim në shumë raste konflikte të ndryshme në botën bashkëkohore.

Shtetet shumëkombëshe ballafaqohen vazhdimisht me problemin e këtij dualizmi dhe mundohen që këtë ta rregullojnë në atë mënyrë që legjitimitetin dhe lojalitetin ndaj shtetit t'i favorizojnë duke e nxitur këtë me mekanizma ligjorë e institucionalë për mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe pakicave, ku të gjithë shtetasit kanë të drejta dhe liri të barabarta e të garantuara. Prandaj disa intelektualë, siç është Jürgen Habermas, me qëllim të tejkalimit të ndasive ndërmjet identiteteve të ndryshme kolektive dhe shtetësisë, propozon konceptin e “patriotizmit kushtetues” si pikënisje për një platformë qytetare të kombformimit dhe përkatësisë shtetërore, bazuar në vlera themelore demokratike, kushtetuese e të pluralizmit. Kultura politike e një vendi kristalizohet përmes kushtetutës së tij, ku parimet themelore, si sovraniteti popullor e të drejtat e njeriut, interpretohen dhe zbatohen në kontekstin e kulturës e të historisë kombëtare. Kjo do të mund të krijonte një bazë racionale të besnikërisë dhe afërsisë ndërmjet anëtarëve të një shoqërie që do të mund ta zëvendësonte edhe nacionalizmin (Habermas, 2001), koncept i cili deri më tani, siç duket, nuk po funksionon ose po jetësohet në masë të konsiderueshme.

Për vendet e Ballkanit kjo paraqet një problem tjetër, sepse rregullimi i marrëdhënieve shoqërore ose raporteve shtet-qytetar kurrë nuk arritën të institucionalizoheshin në atë masë sa është e domosdoshme për të funksionuar shteti siç duhet dhe për t'u pranuar sa duhet nga qytetarët autoriteti i tij. Kjo ndodh së paku për dy arsye: së pari, për shkak të rrethanave historike të sundimeve dhe diskriminim të vazhdueshëm, raporti i shëndoshë i qytetarëve me shtetin ishte thuajse i pamundur. Kështu, në gjuhën popullore nganjëherë emërtimi për shtetin cilësohej edhe si “hyqymeti” ose “drzhava”, pra përcaktime që shfaqin të huajën, të imponuarën, të papranuarën. Arsyja tjetër është edhe shkalla e ulët dhe tejte e vonshme e modernizimit, përkatësisht industrializimit,

urbanizimit, arsimimit, zhvillimit, gjë që çoi në mbylljen brenda mureve të shtëpisë dhe në krijimin e strukturave e normave tradicionale e paralele shoqërore që funksiononin karshi atyre shtetërore. Gjithashtu, edhe mungesa e një shoqërie civile dhe kulture demokratike në vend ishin shkaqet e një identiteti shtetëror-qytetar shumë pak të konsoliduar.

### 4.3. Kombi, shteti dhe përkatësia

Samuel Huntington, autori i librit mjaft kundërthënës “Përplasja e qytetërimeve” (1996) proklamonte se konfliktet fetare (si civilizime) në përmasa globale do të ndodhin pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Shumë vjet më vonë Huntington ka shkuar edhe më tej me pesimizmin e tij, duke shkruar një libër të ri me titullin domethënës “Kush jemi ne?” (2014), duke nxitur frikën se vlerat tradicionale dhe identiteti “i vërtetë” amerikan po kërcënohen nga trendët e rinj globalë dhe multikulturalizmi. Ndërsa autori i veprës tejet influencuese “Fundit i historisë” (1992), Francis Fukuyama, gjithashtu adresoi çështjen e identitetit me librin e ri të titulluar saktësisht “Identiteti: Kërkesa për dinjitet dhe politika e inateve” (2018). Në kundërshtim me tezen e Huntingtonit, Fukuyama nuk mendon se ato janë emigracioni ose globalizimi, por gara e grupeve të ndryshme për viktimizim dhe qasja e gabuar e partive politike (veçanërisht nga spektri i majtë) për të stimuluar pjesërisht politikën e identitetit të komuniteteve e nëngrupeve, të bazuara në gjini, rasë, përkatësi etnike, orientim seksual, etj. Si rezultat, kjo ka krijuar përkatësi identitare të bazuar në diferencim dhe konkurrencë për viktimizim midis komuniteteve të ndryshme të shoqërisë. Ai propozon që në vend të promovimit të identiteteve të pjesshme, duhet përkrahur dhe fuqizuar një Leitkultur të përbashkët të të gjithë shoqërisë dhe jo aso të bazuara në grupe të veçuara.

Studiuesja e njohur Monserrat Guibernau (2013) në librin me titull “Belonging: Solidarity and Division in Modern Societies” përpiqet të shtjellojë çështjen e përkatësisë së shoqërive moderne e bashkëkohore në kontekstin historik, kulturor dhe politik. Ajo eksploron bashkëveprimin midis kombit dhe shtetit në sigurimin e qytetarëve me një identitet të caktuar dhe nënvizon se dilema e lirisë

dhe e përkatësisë në shtetet demokratike liberale zgjidhen nga parimet e asaj që ajo e quan “përkatësi me zgjedhje”, e cila mundëson zhvillimin dhe konsolidimin e një komuniteti të përbashkët politik, madje edhe në shoqëri të shumëllojshme, të përziera dhe pluraliste.

Joel Migdal është një autor tjetër me ndikim dhe për temën tonë jashtëzakonisht i rëndësishëm. Me qasjen e tij “shtet në shoqëri” (state in society) kontribuon për të kuptuar plotësimin dhe ndërsjellshmërinë e tyre, si dhe se si këto dy institucione vazhdimisht ndikojnë dhe riformojnë njëra-tjetrën, kështu që identitetet janë rezultat i ndërvarësisë së tyre. Në këtë kuptim ai thekson: “Përkatësia pra ka një kuptim zyrtar, instrumental - domethënë përcakton statusin - dhe një komponent informal, afektiv - domethënë nxit ndjenjën e identitetit ” (Migdal, 2004: 15).

Ashtu siç arritëm ta shtjellojmë më parë, shtetësia ndërlidhet me statusin politik e juridik; me të drejtat dhe detyrimet të dhëna me këtë status; me dispozitat individuale dhe identitetet e caktuara në këtë status, ose që priten nga ky status (Bauböck, 2006: 15-16). Ndërkohë që shtetet përdorin modele dhe politika të ndryshme të shtetësisë për të nxitur ndjenja të përbashkëta të përkatësisë dhe për të formuar identitet kombëtar në mënyrë që të forcojnë dhe të konsolidojnë legjitimitetin dhe lojalitetin e qytetarëve ndaj shtetit. Shtetësia, ashtu sikurse edhe kombësia në të njëjtën kohë, është çështje e emancipimit politik, kohezionit shoqëror, integritit legal dhe mirëqenies ekonomike të qytetarëve që jetojnë në një shtet. Sa ka të bëjë me integrimin e qytetarëve dhe komuniteteve nga ana e shtetit, aq ka të bëjë edhe me pranimin e shtetit nga bashkësitë e ndryshme etnike, fetare e çfarëdo qoftë tjetër, si dhe me angazhimin e tyre në entitetin politik në fjalë. Gjithashtu, po aq sa i duhet identitetit kombëtar dhe atij shtetëror ekzistimi dhe pranimi nga ana e shtetit, po aq i duhen këto edhe shtetit për të ekzistuar dhe funksionuar si i tillë, sepse, përveç strukturave shtetërore, është i nevojshëm edhe identiteti i përbashkët në mënyrë që institucionet dhe vetë shteti të mund të funksionojnë.

Kështu, çështja e përkatësisë që buron nga ndjenja e përbashkësisë është zakonisht edhe pjesë përbërëse e identitetit shtetëror, e cila buron nga marrëdhënia me shtetin. Në botën e sotme duket se përkatësia kombëtare e secilit individ është pjesë përbërëse dhe e ndërvarur e identitetit shtetëror. Sigurisht kjo rregull ka edhe përjashtime, sidomos në rastet e komuniteteve joshumicë dhe në shtete shumëkombëshe. Po kështu përkatësia kombëtare në të kaluarën jo gjithmonë përputhej me ato shtetërore, gjë që varet thellësisht nga sukcesi ose mossukesi i projektit të “komb-ndërtimit” nga ana e shtetit. Studime të shumta empirike na dëshmojnë për këto dinamika ndryshimesh ndërmjet përkatësisë shtetërore dhe asaj kombëtare. Shtetet me kapacitete të larta institucionale dhe ekonomike, si dhe me shoqëri civile të zhvilluar kanë gjasa shumë më të mëdha që të forcojnë identitetin kombëtar karshi atyre etnike, që nuk ia dalin aq mirë që këtë përkatësi ta bëjnë të përputhshme me shtetësinë (Wimmer, 2013). Ndërsa duke u bazuar në hulumtimin empirik e krahasues të identitetit kombëtar skocez dhe atij anglez karshi përkatësisë shtetërore britanike, sociologët McCrone dhe Bechhofer (2015) arrijnë të dëshmojnë që këto janë të varura në masë të madhe nga marrëdhënia me “tjetrin” dhe të ndryshueshme varësisht nga rrethanat e kohës, sikurse edhe nga gjendja, përvoja e perspektiva e secilit individ.



PJESA

2

## 5. Shtetformimi

### 5.1. Përkufizimet dhe konceptet

Shkenca politike është e interesuar të diskutojë dhe të shpjegojë marrëdhëniet e pushtetit dhe të autoritetit politik me shoqërinë dhe anasjelltas. Zanafilla e kësaj disipline vjen me studimin sistematik të strukturës, organizimit dhe rëndësisë së shtetit. Politologët fillimisht kishin një interesim të madh që të analizonin funksionimin e shtetit, si një aparat pushteti e strukturë administruese, e veçanërisht në gjetjen e formës sa më të përshtatshme dhe të aplikueshme të një sistemi politik, të një rendi ekonomik e shoqëror që do t'u garantonte qytetarëve siguri, mirëqenie dhe zhvillim të gjithëmbarshtëm. Prandaj, në botën gjermanofolëse shkenca politike njihet edhe si 'Staatswissenschaften' (Shkencë mbi shtetin), dhe në shumë anë tjera të botës kjo disiplinë përqendrohet kryesisht në administratë publike, rendin kushtetues, politikat e institucioneve publike dhe fusha të ngjashme të interesit që ndërlidheshin me shtetin. Ndërkohë që fokusimi në procesin, faktorët dhe shkaqet e formimit të shtetit ishte i zbehtë dhe i anashkaluar mjaft shumë. Vetëm pas gjysmës së dytë të shekullit të kaluar duket se interesimi për këtë fushë studimi filloi të shtohet gjithnjë e më shumë, madje falë nxitjes së studiuesve nga disipinat e tjera shkencore si sociologjia, historia etj. Ngjashëm sikur edhe me shumë koncepte të tjera nga shkencat shoqërore, sfida fillestare që u paraqit kishte të bënte me përkufizimin e nocionit shtet. Se një përkufizim i vetëm dhe i përgjithshëm mbi shtetin nuk ekziston, flet edhe fakti se ka definicione të panumërta. Sipas politologut gjerman Arthur Benz e duke iu referuar David Eastonit, qysh viteve 1980 kishte mbi 140 definicione të vlefshme mbi shtetin (Benz, 2001:1).

Shteti është në përgjithësi një dukuri e epokës moderne dhe përbën institucionin qendror politik mbarëbotëror. Por, shteti përfshin më shumë sesa vetëm të qeverisurit e një vendi dhe të një populli. Gjithashtu, koncepti mbi shtetin merr kuptime të ndryshme varësisht prej këndvështrimeve e aspekteve që trajtohen dhe nocioni shtet përdoret në trajta të shumta. Siç bie fjala, ne mund të flasim për shtetin e së drejtës, shtetin e mirëqenies, shtetin demokratik apo për organet

shtetërore, kufijtë shtetërorë, terrorizmin shtetëror etj. Apo mund të përdorim atë për të emërtuar entitetet politike si p.sh. shteti i Islandës, shteti kanadez, Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj. Sidoqoftë, me shtet përshkruhet një njësi territoriale politike me identitet të konsoliduar kombëtar ose qytetar, me autoritet dhe pushtet të plotë e legjitim, e cila njihet ndryshe edhe si sovranitet. Hannah Arendt (1998) pohon se Makiaveli (shek. XVI) ishte ai që vuri në përdorim nocionin, deri atëherë thuajse të panjohur- lo stato, dhe kjo bëri që ai të identifikohet me të drejtë si avokat i shtetit modern dhe i nocionit të ekzistencës së “arsyes shtetërore” (raison d’etat), e cila në kohërat e sotme shprehet edhe në trajtën e “interesit nacional”.

Vlen të theksohet se përkufizimi i shtetit nuk është i varur nga lloji i sistemit politik ose natyra e regjimit qeverisës. Pavarësisht faktit se rregullimi shtetëror mund të jenë në formën e republikave, mbretërive, emirateve apo edhe federatave e konfederatave, të gjitha në esencë janë të njohura si shtete. Megjithëkëtë, shtetet në realitet dallojnë mes vete në masë, përbërje dhe në trajta të ndryshme. Shtetet veçohen si për nga sistemi i tyre qeverisës, niveli i sigurisë ashtu edhe për nga gjendja ekonomike dhe kushtet e mirëqenia sociale që ofrojnë për shtetasit e tyre. Sipas formës së rregullimit shtetëror e kushtetues, shtetet ndahen në federale dhe në unitare. Shteti federal përbëhet nga njësitë shtetërore (republika, provinca, shtete federative, lande, kantone etj.), të cilat kanë funksione të përcaktuara nga kushtetuta qofshin ato ekzekutive, legislative ashtu edhe gjyqësore. Në të shumtën e rasteve autoriteti i këtyre njësive kufizohet në fusha të sigurisë kombëtare, politika të jashtme, politika fiskale, politika monetare etj.

Një ndër konventat më të rëndësishme të ndërmarra në përkufizimin e vetive dhe kritereve të shtetit është pa dyshim “Konventa mbi të drejtat dhe detyrat e shteteve”, apo më mirë e njohur si “Konventa e Montevideos” e vitit 1933, e cila u mbajt në kryeqytetin e Uruguait. Nëse deri atëherë kushtet kryesore për formimin e shteti ishin territori i përcaktuar, një popullatë e përhershme dhe pushteti qendror, kjo konventë e shton kushtin që sugjerohej nga shumë shkollarë të së drejtës ndërkombëtare. Atribute të reja që njihen si kritere themelore në përcaktimin e shtetit modern dhe në njohjen ndërkombëtare të

tij janë e drejta dhe detyrimi, sipas së cilave shteti duhet të posedojë aftësinë e hyrjes në marrëdhënie diplomatike me shtetet e tjera. Kjo konventë si parakusht për ekzistimin e shtetësisë futi kriterin e njohjes ndërkombëtare, e cila e fuqizoi parimin e respektimit të sovranitetit e integritetit territorial mes shteteve.

Përmbledhtazi, shtetin do të mund ta përkufizonim si autoritet politik e legjitim që ka sovranitet mbi një territor dhe popullatë të caktuar, dhe pranohet nga shtetet e tjera si i tillë. Sigurisht që ky definicion është më shumë për hir të qartësisë, sepse nuk përcakton përmbajtjen, funksionin dhe mbi të gjitha procesin e formimit dhe bashkërendimit të këtyre attributeve qenësore.

## 5.2. Shtetformimi në kërkimet shkencore

Ekzistojnë dallime të shumta në qasje teorike e analitike mbi shtetin që mundohen të zbërthejnë si proceset dhe shkaqet e krijimit të shteteve, ashtu edhe funksionimin e tanishëm dhe dallimet e ndryshme ndërmjet shteteve. Ndër qasjet kryesore teorike mbi shtetin dallohen ato pluraliste, statiste, marksiste dhe postmoderniste (Poggi, 2012). Viteve 1950 dhe 1960 me Robert Dahl, Quentin Skinner, Earl Latham etj. ishte një shkollë e shkencave politike, e cila shtetin e konceptonte dhe e përshkruante si një rregullator shoqëror-politik, i cili duhet të jetë në parim i paanshëm ndaj zhvillimeve të përgjithshme ekonomike. Ose, më mirë të thuhet, të mos ndërhyjë në tregti, por ashtu siç Adam Smith kërkonte të lejojë “dorën e padukshme” të tregut, të vetërregullohet. Shteti duhej të ishte në rolin e baraspeshuesit të interesave ekonomike dhe shoqërore. Sipas këtij interpretimi, çka është mirë për biznesin konsiderohej se është mirë edhe për shtetin. Shteti në këtë kuptim teorik përshkruhet nganjëherë si një institucion publik mbikëqyrës e rregullues, instancë e autoritet që bën regjistrimin e veturave dhe lëshon certifikata.

Kështu, jo rrallëherë, shteti përkufizohet në aspekte organizative dhe në atë funksional. Në formën e parë të konceptimit shteti bëhet sinonim i qeverisjes dhe pushtetit. Në anën tjetër, e ashtuquajtura shkolla pluraliste e shihte shtetin përmes këndvështrimit funksional, ku shteti merr rolin e një ndërmjetësuasi të interesave të grupimeve të

ndryshme dhe të shumta shoqërore. Harold Laski (1948) konsiderohet themelues i kësaj shkolle të mendimit politik dhe njihet si një nder pionierët e parë të shkencave politike në ShBA, edhe pse ai vetë ishte me prejardhje britanike.

Me konceptin e shtetformimit, në anën tjetër, zakonisht përkufizohen aspektet institucionale, shoqërore dhe aktorët kyç politikë. Në mesin e viteve 1960, Theodor Schieder paraqiti një tipologji të formave të shfaqjes së komb-shtetit në Evropë. Ai bën dallimin midis modelit perëndimor, evropiane-qendror dhe lindor të ndërtimit të shtetit kombëtar. Ndërsa shtetet moderne, të tilla si Anglia dhe Franca, u zhvilluan përmes integritit të brendshëm ose revolucionit, shtetet e Evropës Qendrore, të tilla si Gjermania dhe Italia, u shfaqën si shtete përmes procesit të bashkimit kombëtar, e përshkruar edhe si “mënyra asociative ose bashkuese”. Nga ana tjetër, në Evropën Lindore dhe Juglindore shtetet moderne dolën nga shpartallimi i perandrive shumëkombëshe, proces i quajtur edhe si “mënyra disociative ose shpërbërëse” (Lemberg: 603ff., në Berding, 1996).

Shumica e shteteve ekzistuese u shfaqën në rrjedhën e shekullit XX, edhe pse disa janë më të hershme dhe ka të tilla që janë shpërbërë ndërkohë. Gjatë kësaj periudhe mund të veçohen tri faza kryesore të formimit të shteteve. Vala e parë e shtetformimeve ndodhi pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe me shembjen e Austro-Hungarisë, Perandorisë Osmane dhe Rusisë Cariste. Parimi i vetëvendosjes së popujve u bë një kriter vendimtar për krijimin e shteteve të reja. Së këndejmi, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe si rezultat i shkolonizimit u formuan një numër i madh i shteteve të reja, kryesisht në kontinentin aziatik dhe atë afrikan. Dhe së fundmi, me shembjen e Bashkimit Sovjetik, të Jugosllavisë dhe Çekosllovakisë, pas rënies së sistemit komunist, erdhi vala e tretë e formimit të shteteve, veçanërisht në Evropën Lindore dhe Juglindore, Shtetet Baltike dhe Azinë Qendrore. Por disa shtete jashtë këtyre rajoneve u formuan gjithashtu në këtë kohë, të tilla siç janë; Eritrea, Timori Lindor ose Namibia (Migdal, 2004).

Sipas Charles Tilly, sistemi modern i shteteve ka origjinën në Evropë duke filluar nga viti 990 e tutje. Ai i sheh arsyet për formimin e shteteve moderne në kombinim me rritjen e kapitalit, me rritjen dhe zhvillimin e qyteteve, me zgjerimin e pushtetit të qeverisë, të rritjes e forcimit të ushtrive dhe të sistemit më të organizuar e të centralizuar të administrimit e të tatimgrumbullimit. Sipas Tilly, një shtet duhet t'i përmbushë këto parime për t'u konsideruar si i tillë, së pari nëse dallon nga organizatat e tjera që veprojnë në territorin e njëjtë; nëse është i pavarur dhe nëse institucionet e tij janë formalisht të koordinuara në mes vete (Tilly, 1992: 67ff.). Shteti duhet të funksionojë si një organizatë me një ndarje të qartë të detyrave, pastaj duhet të ketë zotërim të forcës, të jetë në gjendje të ushtrojë sovranitetin e plotë brenda territorit, autoriteti i tij duhet të jetë i centralizuar deri në atë masë që të jetë në koordinim me të gjitha pjesët e vendit, si dhe duhet të ketë një sistem funksional politik-shtetëror (Poggi, 1990: 19). Kurse Quentin Skinner (2009) thekson se komb-shtetet janë rezultat, ndër tjerash, i idesë së lirisë të projektuar nga mendimtarët e hershëm evropianë, sikurse edhe fillimisht të vetëqeverisjes që u formësua në qytet-shtetet italiane të shekullit XVI, për t'iu kundërvënë sundimit të vrazhdë e qeverisjes së huaj e të centralizuar.

Në anën tjetër, shteti bashkëkohor karakterizohet me decentralizimin e pushtetit nga qeveria qendrore në atë lokale, por edhe në shpërndarjen e pushtetit nëpër agjenci tjera autonome, të cilat janë pjesë e administratës shtetërore. Kjo formë e organizimit të shtetit, në rend të parë, i bën elementet e sistemit politik më të pavarura, demokratike dhe më efikase. Sidoqoftë, globalizimi i shtuar në shumë fusha, sidomos globalizimi i tregjeve financiare, paraqitet gjithnjë e më shumë si një sfidë me të cilin shtetet duhet të përballen, duke kufizuar mundësitë dhe rregullimin e ekonomisë së brendshme. Por shfaqen edhe sfida në sektorin e sigurisë, kulturës, sociale e ambientale, të cilat i shtyjnë shtetet t'u përshtaten rrethanave dhe të ndryshojnë. Shfaqja e shteteve të dobëta dhe ekonomikisht të pafuqishme e me sovranitet të kontestuar është një dukuri e cila, sipas studiuesve, ndikon që pikëpamjet dhe përkufizimet e deritashme rreth nocionit të shtetit përmbajtësisht të rimendohen.

Pavarësisht përkufizimeve të panumërta që mund të ekzistojnë, në diskutimet politologjike mbizotërojnë tri qasje të rëndësishme analitike. Nga njëra anë, shteti konceptohet si shuma e institucioneve të bashkërenduara dhe vetë si një strukturë institucionale themelore. Nga ana tjetër, shteti kuptohet edhe si një autoritet politik legjitim brenda së cilës veprojnë aktorë të ndryshëm. Dhe, në kuptimin tjetër, shteti mund të përkufizohet si një organizatë që përmbush detyra e funksione të caktuara për shoqërinë (Benz, 2001). Nisur nga ky kategorizim, tutje shteti dhe procesi i formimit të tij do të shtjellohen për nga aspekti i krijimit dhe konsolidimit të autoritetit, gjegjësisht të sovranitetit shtetëror. Më pas do të trajtohet organizimi institucional dhe konstitucional si përpjekje për vendosje të rendit, rregullave dhe funksionalizimin e tyre, si njëra ndër aspektet qenësore në procesin shtetformues. Dhe së fundi, do të elaborohet shteti për nga dimensionin kulturor, gjegjësisht i marrëdhënieve të shtetit me shoqërinë dhe përpjekjeve për legjitimitet të tij nga ana e qytetarëve.

## 6. Qasjet teorike

Trajtimi i shtetformimit nga aspekti teorik përgjithësisht mund të ndahet në qasje që e trajtojnë atë nga lart-poshtë apo anasjelltas. Studiues të shumtë, kryesisht nga fushat e historisë dhe sociologjisë, janë përpjekur që shtetformimin ta hulumtojnë në kuadër të proceseve të gjata historike (longue durée). Ajo çka shpeshherë u mungonte argumentimeve të tilla ishte sqarimi se çka i veçoi dhe i bëri më efikase shtetet moderne prej formacioneve të mëparshme politike. Ishte pikërisht kjo çështje që nxiti shkollarët të shqyrtonin shtetin nga qasja e krahasimit me entitetet e mëparshme dhe të ngjashme paramoderne. Me qëllim të shmangies nga këto analiza krahasimtare do të përpiqemi t'i zbërthejmë tiparet thelbësore që e përbëjnë shtetin modern.

### 6.1. Shteti dhe autoriteti

Një atribut përgjithësisht i pranuar mbi shtetin është se posedon autoritetin më të lartë të ushtrimit të pushtetit në popullatë dhe brenda një territori të caktuar. Ajo që e dallon shtetin nga entitetet ose organizata të tjera që mund të përdorin forcën apo dhunën është fakti se shteti posedon monopolin e përdorimit legjitim të forcës fizike. Sipas përkufizimit të mirënjohur nga Max Weber "shteti është ai komunitet njerëzor i cili brenda një territori të caktuar - ky: "territor" hyn në tiparet e tij - e deklaron (me sukses) si të tijin monopolin e përdorimit legjitim të dhunës fizike" (Weber, 2006: 5). Me këtë rast theksi vihet tek ekzistimi i monopolit, që do të thotë se krahas shtetit nuk mund të ketë organizatë ose njësi tjetër me të njëjtin autoritet sikur shteti. Vetëm shteti posedon të "drejtën" legjitime të përdorimit të dhunës fizike dhe vetëm shteti mund të lejojë apo t'u delegojë të tjerëve përdorimin e saj. Sikurse që nënvizohet legjitimiteti i përdorimit të forcës, kjo nënkupton se autorizimi për këtë të drejtë vjen nga shtetasit të cilët e pranojnë dhe i binden autoritetit të shtetit.

"Shteti, po ashtu si formacionet politike pararendëse të tij në histori, është një marrëdhënie sundimi e njerëzve ndaj njerëzve, e cila mbështetet në mjetin e dhunës legjitime (d.m.th. e gjykuar si legjitime).



Me qëllim që shteti të ekzistojë duhet pra patjetër që njerëzit në sundim t' i nënshtrihen çdoherë autoritetit të kërkuar prej sunduesve." (Weber, 2006: 5)

Në këtë kuptim shteti konceptohet si tërësia e institucioneve publike brenda një territori të përcaktuar me qëllim të krijimit të një pushteti dhe rendi shoqëror. Për Weberin, territori, krijimi i strukturave administrative (shërbimi civil) dhe aparati ushtarak e politik ose monopoli i forcës, të cilat sigurojnë rendin dhe ligjin, përfaqësojnë fillimet dhe premiset e shtetit modern (Weber, 2006). Sipas tij, ne nuk mund t'i qasemi shtetit për nga qëllimi i tij, por para së gjithash për nga mjetet të cilat janë më të veçanta krahasuar me formacionet e organizatat e tjera politike. Mjeti thelbësor i shtetit del të jetë autoriteti legjitim detyrues, qoftë edhe përmes dhunës fizike, që ka përballë individëve e organizatave të tjera. Këto marrëdhënie të pushtetit legjitimohen përmes llojit tradicional, karizmatik dhe legalo-racional të legjitimitetit. Sigurisht që ideali i shtetit modern është i bazuar në llojin racional, i cili e fiton legjitimitetin nga besimi në ligjshmërinë e rendit të vendosur dhe rregullat e përcaktuara në të.

Në këtë linjë të argumentimit qëndron edhe Charles Tilly (1992), i cili konsideron se krahas dhunës fizike, të cilën ai e emërton shtrëngim ose detyrim (coercion), është edhe kapitali faktor tjetër që ka ndikuar në formimin e shteteve, si dhe në format e krijimit të tyre. Me këtë rast kapitali nënkupton zotërimin e burimeve të duhura ekonomike dhe pretendimeve të realizueshme për burime të tilla. Dallimet në përqendrimin dhe akumulimin e kapitalit dhe të forcës detyruese, sipas tij, shpjegojnë edhe shfaqjen e formave divergjente të shteteve të para moderne. Në këtë kontekst, në procesin shtetformues dallohen tri trajektore; ajo ku kishte më shumë kapital sesa forcë shtrënguese; ajo ku kishte forcë por kapitali ishte i shpërndarë; dhe së fundmi, ku kishte një kombinim të duhur të forcës me kapitalin, siç ishte rasti me formimin e Britanisë. Kjo për faktin se këto shtete ishin në gjendje të krijonin dhe të mirëmbanin ushtri të rregullta, që do t'u ofronin dominim si të jashtëm karshi rivalëve ashtu edhe pavarësim në ushtrim të autoritet brenda territorit të tyre.

Nga ky shpjegim rrjedh edhe përkufizimi i famshëm i Tilly-it se luftërat ishin nxitësit e formimit të shteteve (Tilly, 1992). Meqenëse nxitja e luftërave kërkonte financim të konsiderueshëm, kjo imponoi mbledhje të haraçit/tagrave në mënyrë më efikase dhe më të centralizuar, për të krijuar një strukturë administrative dhe sistem më të përsosur të mbledhjes së tyre. Si rezultat u forcuan ushtritë që i mposhtën ose i detyruan të shërbenin në këto ushtri të rregullta prijësit lokalë të grupeve më të vogla ushtarake (war-lords). Ngjashëm, kjo pasoi edhe me krijimin e një rendi ligjor që i sfidonte normat sociale dhe prijësit lokalë përmes forcave të brendshme policore, si dhe aparatit burokratik (Tilly, 2002). Me fjalë të tjera, karshi formacioneve rivale dhe institucioneve të tjera pararendëse, ishte autoriteti i shtetit ai që duhej konsoliduar duke mos lënë hapësirë dhe mundësi për ndonjë autoritet tjetër, qoftë ai fisnor, fetar apo çfarëdo tjetër. Në librin që mbron tezën mbi luftën si instrument i politikës shtetërore dhe shtytës i shtetformimit, "Shteti, lufta dhe gjendja e luftës", Kalevi Holsti (2008) veçon se që nga 1648, pra Paqja e Vestfalisë, lufta kishte tri forma të ndryshme. Luftëra të institucionalizuara, që zhvilloheshin midis shteteve, luftëra të përgjithshme, sidomos midis aleancave ushtarake e ideologjike, siç ishin ato në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, dhe së fundmi, luftëra popullore ose të tilla për çlirim e vetëvendosje.

Në ato shtete ku parakushtet dhe rrethanat për konsolidimin e këtij autoriteti ishin më të favorshme, edhe procesi i shtetformimit ishte më i hershëm dhe më i suksesshëm sesa në ato ku këto mungonin, ishin të zbehta apo të shpërndara. Pavarësisht që sqarimi i Tilly është mjaft i përhapur dhe i rëndësishëm, qasjet "belliciste" apo militariste rreth shkaqeve e faktorëve që çuan në shtetformim ishin më të hershme. Ishte studiuesi gjerman Otto Hinze ai që doli me një tezë të tillë qysh në fillim të shekullit të kaluar. Sipas tij, të gjitha kushtetutat e shteteve janë në zanafillën e tyre kushtetuta ushtarake, pra të bëra për luftëra apo të dala nga luftërat (Poggi, 2012: 99). Kjo qasje ngërthen edhe disa aspekte të rëndësishme në elaborimin e tyre, atë që luftërat dhe ushtritë ndikuan në sistemin e taksave dhe rrjedhimisht në ekonomi. Sikurse edhe në teknologji, që fillimisht ishin shpikur e përdorur për qëllime ushtarake, por me kalimin e kohës ndikuan në zhvillime të industrive dhe segmenteve tjera të rëndësishme për shtetet.

Komb-shtetet e hershme ishin si rend pushteti mjaft atraktive për shumë sundimtarë, sepse ofronin lojalitet dhe siguri ushtarake më të madhe, si dhe përkrahje politike më masive nga popullata (Wimmer, 2013: 20). Këta dy komponentë, pra lojaliteti ushtarak dhe legjitimiteti politik, prodhuan lëvizje kombëtare dhe nacionalizmin që mundësuan luftëra të suksesshme për pavarësi dhe për krijim të shtetit kombëtar. Nga studimi i tij sistematik dhe analizës statistikore të ndërlidhjes së luftës dhe shtetformimit, Wimmer arrin në përfundim se forma më e shpeshtë e luftës në dy shekujt e kaluar ishte e llojit secesionist, pra luftë për pavarësi e shtet, krahasuar me periudhat e mëhershme historike, kur luftërat ishin pushtuese ose kolonizuese. Sipas tij, formimi i shteteve moderne u mundësua nga një aleancë mes elitave të kombëtarizuara, prej klerikëve, ushtarakëve, intelektualëve, deri te tregtarët me masën popullore në krijimin e ushtrisë dhe entitetit politik të përbashkët.

Një tipar i dalluar i shtetit modern është sovraniteti, si burim i autoritetit brenda territorit nën juridiksionin e vet. Sovraniteti, si parim qenësor i shtetësisë dhe temë boshte në të drejtën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, ka qenë debat i shumë punimeve shkencore që nga koha e filozofit Jean Bodin (1529-1596), i cili e shtjellonte sovranitetin si absolut dhe të patjetërsueshëm, ku monarku kishte pushtet të pakufizuar e të pacenuar nga askush, madje as nga populli. Që nga ajo kohë koncepti i tillë për sovranitetin ka evoluar mjaft shumë dhe është tejkaluar dukshëm, si zbatim të tij brenda shteteve ashtu edhe në praktikën e së drejtës ndërkombëtare.

Kurse studiuesja Janice Thomson e definon sovranitetin në këtë mënyrë: "(...) si pranim nga aktorët e brendshëm dhe të jashtëm që shteti ka autoritet ekskluziv për të ndërhyrë edhe me forcë në veprimtaritë dhe çështjet brenda territorit të tij." (Thomson, 1995: 219). Duke iu referuar konceptit tradicional të sovranitetit vlejné edhe rregullat për njohjen e entiteteve si shtete të pavarura dhe si subjekte ndërkombëtare. Ndër parimet themelore janë: ai i barazisë ligjore ndërmjet shteteve, si dhe parimi i mosndërhyrjes së një shteti në çështjet e brendshme të shtetit tjetër (Goldstein, 2003: 90ff). Sipas autorit të mirënjohur mbi sovranitetin, Stephen Krasner, ky i rendit katër lloje të sovranitetit:

- ▶ Së pari e veçon kategorinë gjinore - kriteri biologjik. sovraniteti sipas së drejtës ndërkombëtare,
- ▶ sovraniteti vestfalian, që bazohet mbi parimin e territorialitetit dhe mosndërhyrjen e jashtme në çështje të brendshme,
- ▶ sovraniteti i brendshëm apo vendor, që i referohet organizimit formal të autoritetit politik brenda shtetit dhe aftësive të autoriteteve që të ushtrojnë kontroll efektiv brenda juridiksionit të vet.
- ▶ sovranitetin e ndërvarur që i referohet aftësisë së shtetit për të rregulluar marrëdhëniet dhe kushtet në planin global në aspekte të ndryshme (Krasner, 2001: 15ff.).

Por, sovraniteti është një koncept dinamik i cili ka evoluar me kalimin e kohës dhe rrethanave politike e shoqërore, duke ndryshuar kështu vazhdimisht kuptimin e vet. Në këtë kontekst Roland Paris përshkruan këtë transformim në këtë mënyrë: ku vala e parë ishte me revolucionet amerikane dhe franceze prej së cilave liria dhe barazia e qytetarëve ishin postulatet kryesore; duke kaluar deri tek periudha pas Luftës së Parë Botërore, kur hyri parimi i vetëvendosjes që u mundësoi disa shteteve në Evropë shtetformimin, e deri pas Luftës së Dytë Botërore, kur ky parim u universalizua edhe në kuadër të proceseve të dekolonizimit e u përhap botërisht; si dhe periudha pas Luftës së Ftohtë, ku parimi i zgjedhjeve të lira dhe demokracia liberale janë bërë norma dhe standarde të legjitimitetit ndërkombëtar (Paris, 2003: 445). Edhe me gjithë faktin se sovraniteti me kalimin e kohës ka pësuar ndryshime, domethënia thelbësore mbetet si autoriteti më i lartë brenda një territori të caktuar. Rëndësia e tij qëndron në faktin se që nga ekzistimi sovraniteti ka qenë dhe mbetet parimi përcaktues në marrëdhëniet midis shteteve dhe mund të cilësohet si bazë e ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Sigurisht që autoriteti i shteteve nuk mbështetet vetëm në forcë dhe dhunë si mjete të nevojshme të shtrirjes dhe mirëmbajtjes së autoritetit, ato duhet të pranohen dhe të mbështeten si të tilla edhe nga qytetarët dhe nga shtetet e tjera.

Ushtrimi i autoritetit kërkon detyrimisht edhe një dozë bashkëpunimi, sado i vogël që të jetë, të atyre ndaj të cilëve drejtohet ky autoritet. Në këtë rast ne flasim për legjitimitetin e shtetit, i cili lidhet ngushtë me konsolidimin dhe funksionimin e mirëfilltë të demokracisë brenda vetë shtetit. Kjo, në anën tjetër, kushtëzohet nga ndarja e pushteteve, sundimi i ligjit, kultura politike dhe, mbi të gjitha, nga stabiliteti dhe efikasiteti i institucioneve, për të cilat aspekte edhe do të diskutohet më gjerësisht në pjesën në vazhdim.

## 6.2. Shteti dhe institucionet

Më shumë sesa thjesht si autoritet dhe marrëdhënie pushteti, shteti është edhe shuma e të gjitha institucioneve publike dhe njëkohësisht bartës kyç institucional. Kjo do të thotë se ka një strukturë dhe organizim me të cilat përmbush funksionet e tij themelore dhe ato shoqëruese, duke përfshirë me këtë sistemin juridik, sistemin partiak, atë ekonomik, rendin kushtetues dhe një varg sistemesh e organesh të tjera shtetërore të domosdoshme për qeverisje. Kjo gjë nënkupton se ekzistenca dhe funksionimi i shtetit nuk janë të lidhura me fatin e udhëheqjes politike apo udhëheqësit të shtetit, qoftë presidentit apo kryeministrit, që kanë një mandat të kufizuar e të caktuar. Por, shteti në rend të parë varet nga institucionet përkatëse e të përhershme, të cilat i kryejnë funksionet e përcaktuara me ligjet në fuqi.

Derisa për autorët e lartpërmendur roli i institucioneve në procesin e shtetformimit nuk e merr interesimin e duhur në tezat e tyre, literatura më bashkëkohore sugjeron që institucionalizimi ka pasur ndikim thelbësor në shtetformim. Kështu që, institucionalizimi mund të konsiderohet edhe si elementi përfundimtar, në mos edhe vendimtar në procesin e shtetformimit (Zartman, 2020: 979). Meqenëse me kalimin nga shoqëritë agrare e feudale në ato industriale e urbane, ishte çdoherë e më vështirë dhe komplekse grumbullimi i taksave, kërkohej një sistem më efikas tatimor. Përdorimi i dhunës dhe ushtrisë për këtë nuk ishte më aq efektiv, sepse ishte e nevojshme një sistem gjithnjë e më unik dhe më i centralizuar, gjë që çoi në krijimin e institucioneve administrative si të taksambledhësve ashtu edhe të ofrimit të shërbimeve publike. Ky ishte roli i institucioneve në krijimin dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe qytetarit,

rrjedhimisht në konsolidimin e legjitimitetit të shtetit. Kjo nënkupton se qytetarët jo vetëm që i nënshtrohen autoritetit shtetëror dhe u binden rendit ligjor e rregullave të caktuara nga ana e shtetit, por krijojnë besimin e përgjithshëm në institucionet shtetërore. Legjitimiteti në këtë kuptim do të thotë se qytetarët kanë besim në drejtësinë e shtetit jo vetëm nga frika apo interesi vetjak, por që shteti posedon edhe autoritet moral në dhënien e udhëzimeve dhe urdhrave ndaj qytetarëve. Sipas Kalevi Holstit (2008: 84) "Shtetet e suksesshme bazohen në dy dimensione legjitimiteti: (1) përcaktimi i bashkësisë mbi të cilën do të ushtrohet qeverisja dhe (2) parimi (-et) mbi të cilin bazohet 'e drejta për të qeverisur'. Të dyja janë të lidhura në mënyrë të pazgjydhshme." Kjo nënkupton që një shtet nuk është vetëm shuma e institucioneve publike dhe strukturave administrative, ai presupozon që organet shtetërore të shihen nga shoqëria si të tyre dhe se qytetarët të jenë besnikë dhe të përgjegjshëm ndaj këtyre institucioneve (Benz, 2001).

Tradita e kohës antike përqendrohej rreth oikosit (ekonomisë shtëpiake) si njësi përkatëse ekonomike, e cila përbënte edhe bazën për marrëdhënie shoqërore, respektivisht politike. Shoqëria nënkuptonte rendin hierarkik dhe shtresëzimin politik të komunitetit ku shteti përfshinte në rend të parë autoritetin apo, thënë më mirë, vetë elitën politike. Prandaj në demokracinë athinase do të merrnin pjesë vetëm ata që kishin status qytetar, duke përjashtuar ardhacakët dhe skllëverit. Shoqëria dhe shteti shiheshin dhe kuptoheshin si dy anët e një monedhe deri në shekullin XVII. Ndryshimet që ndodhnin më pas vinin si rezultat i konceptimeve të reja për shoqërinë, ekonominë dhe gjendjen e përgjithshme politike. Jeta e qytetarit filloi dalëngadalë të vlerësohej nga kushtet dhe pronësia (statusi ekonomik), angazhimi politik (statusi qytetar) dhe dituria (arsimimi, kultura) dhe më pak nga statusi aristokratik (Poggi, 1990). Individualizmi filloi të bëhej gjithnjë e më shumë rregull sesa përjashtim i marrëdhënieve shoqërore. Rendi i vjetër shoqëror i hierarkisë aristokratike dhe rregullimi i kaluar ekonomik (feudal) tashmë sfidohej nga lëvizje të reja shoqërore që synonin ndryshime të gjithëmbarshme. Rendi dhe vlerat e reja shoqërore të shfaqura në vende dhe trajta të ndryshme në një anë, dhe dinamika e zhvillimeve politike dhe arritjet teknologjike e shkencore,

në anën tjetër, sajuan premisat për krijimin e bashkësisë politike shtetërore. Një bashkësi e cila formohet jo vetëm nga interesat e njëjta apo karshi një armiku të përbashkët, por një formë institucionale e organizimit të tyre në përbushje të nevojave e kërkesave dhe e lidhur ngushtë rreth shtetit të përbashkët.

Një tipar veçues gjatë shtetformimit ishte vendosja e administratës publike, e cila në parim është e hapur për të gjithë qytetarët që i përbushin kushtet e kërkuara e të përshkuara të punës. Kjo ishte një risi kur kihet parasysh që në të kaluarën parashtetërore pjesë e shërbimeve administrative ishin kryesisht shtresat më të larta shoqërore, aristokracia apo me lidhje fisnore të caktuara. Administrata është e formuar në atë mënyrë që posedon një hierarki të qartë përgjegjësish e detyrash, të përcaktuara me rregulla dhe autoritet të qartë. Vendimet qeveritare rrjedhin në drejtim vertikal, nga instanca më e lartë qeveritare deri te shërbyesit civilë të administratës që zbatojnë udhëzimet e vendimet. Konceptimi weberian mbi shtetin si njësi e centralizuar dhe e organizuar nga burokracia, me rend ligjor e kushtetues, i udhëhequr nga ekzekutivi, me sovranitet, me territor, si dhe me monopol të përdorimit legjitim të forcës – janë atributet kryesore të shtetit dhe ndër përkufizimet më të përhapura për shtetin modern. Një aspekt tjetër që e veçon shtetin modern është edhe ndarja e ligjeve nga doket, zakonet dhe nga ritet fetare përgjithësisht. Kjo njihet zakonisht si proces i shekullarizimit apo laicizmit, pra ndarjes së kishës dhe religjionit nga shteti, duke nënkuptuar që autoriteti politik i zbatuar nëpërmjet institucioneve shtetërore brenda popullatës e territorit të caktuar ndikon dhe vepron përtej dhe i pavarur prej të gjitha normave e besimeve. Shteti me këtë rast ka edhe legjitimitet që mund të sigurojë rendin publik dhe sundimin e ligjit brenda shtetit.

Sipas studiuësit të shquar gjerman Georg Jellinek (1851-1911), shteti përcaktohet si formë organizative me pushtet për të sunduar mbi një kolektiv njerëzish vendas (Benz, 2001). Këto forma organizative nënkuptojnë institucionet themelore të shtetit. Sipas tij, popullata (Statsvolk), territori (Staatsgebiet) dhe autoriteti politik (Staatsgewalt) janë elementet përbërëse të shtetit. Shtetet moderne apo bashkëkohore shquhen mbi të gjitha me ekzistimin e disa attributeve, e ndër

kryesoret janë: territor me kufij të caktuar, pra sovranitet; popullatë rezidente, institucione qeveritare dhe njohje ndërkombëtare nga shtetet e tjera (Krasner, 2001). Ndërkaq Pierson, duke u bazuar në literaturën përkatëse, zgjeron përcaktimin e këtyre tipareve dalluese të shtetit modern: kontrolli (monopoli) mbi mjetet e dhunës, territori, sovraniteti, kushtetutshmëria, pushteti jopersonal, burokracia, legjitimiteti dhe shtetësia. Konceptimi weberian mbi shtetin si njësi e centralizuar dhe mirë e organizuar nga burokracia, me rend ligjor e kushtetues, i udhëhequr nga ekzekutivi, me sovranitet, me territor dhe me monopol të përdorimit legjitim të forcës fizike (dhunës) – janë atributet kryesore të shtetit dhe ndër përkufizimet më të përhapura për shtetin modern (Pierson, 2009: 19).

### 6.3. Shteti dhe shoqëria

Pjesa më e madhe e literaturës shkencore rreth shtetit e shtjellon atë qoftë nga perspektiva e raportit të forcave ushtarake, qasja institucionaliste apo nga aspekti ekonomik. Vetëm kohëve të fundit ka një interesim më të shtuar rreth rolit të shoqërisë, kulturës dhe të komponentëve të tjerë sentimentalë e simbolikë në procesin e shtetformimit. Qasja pluraliste mbi shtetin sugjeron se pushteti dhe burimet brenda shtetit janë të shumanshme, të shumëllojshme dhe të shpërndara, pra pluralë, legjitimiteti i të cilit shtet rrjedh nga lojaliteti dhe përkrahja e grupeve të ndryshme bazuar në konsensusin politik (Dryzek/ Dunleavy, 2009: 47).

Ndërkaq qasjet e tjera si ajo neomarksiste dhe neoliberales i shohin marrëdhëniet mes shtetit dhe shoqërisë nga pikëpamjet teorike dhe ideologjike diametralisht të kundërta (Pierson, 2009). E para pohon se shtetet janë krijuar nga shoqëritë gjatë procesit të shoqërizimit. Dhe, sipas tyre, roli i shtetit në politika publike duhet të jetë vendimtar, i pavarur dhe ndërhyrës, me qëllim të ofrimit të barazisë dhe mirëqenies së plotë në shoqëri. Në praktikë janë shtetet e mirëqenies dhe me drejtësi sociale (p.sh. shtetet skandinave), që në masë të konsiderueshme kultivojnë një raport të tillë shtet-shoqëri. Ndërsa, në anën tjetër, qasja neoliberales thekson e vë të kufizimi i rolit të shtetit në ndërhyrjet në shoqëri dhe në efikasitetin e sistemit publik të menaxhimit.



Elementet përbërëse të saj janë liria, individualizmi, ku vjen në konsideratë afirmimi i njerëzve si individë para formacioneve grupore, dhe së fundi vjen fryma tolerante si në politikë përmes mekanizmave demokratikë ashtu edhe në ekonomi duke afirmuar tregtinë e lirë dhe pronën private (Gray, 2010: 11).

Studiuesi Joel Migdal (2001) përmes qasjes “shteti në shoqëri” (“state in society”) hedh dritë mbi marrëdhëniet mes shtetit dhe shoqërisë. Ai pohon se jo vetëm shteti ndikon dhe e transformon shoqërinë, por edhe shoqëria ka ndikim të padiskutueshëm në natyrën dhe në vetë funksionimin e shtetit. Sipas tij, shteti është i formësuar nga dy elemente, që i shquan si Imazhi dhe Praktikrat. Me imazh ai nënkupton pranimin e shtetit si një entitet dominues, të pavarur dhe të bashkuar brenda një territori të kontrolluar përmes rregullave e sundimit të ligjeve. Gjithashtu, me imazh nënkuptohet edhe perceptimi i shtetit si i tillë qoftë nga brenda apo edhe jashtë tij, duke përfshirë edhe perceptimin mbi dy lloje kufijsh, atë territorial, që e kufizon shtetin nga shtetet e tjera, dhe kufijtë socialë, që ndajnë institucionet publike dhe agjentët shtetërorë prej subjekteve që i nënshtrohen këtij autoriteti. Me fjalë tjera, ky kufi paraqet atë të ndarjes së sferës e interesit publik nga ajo private apo partikulare. Ndërsa me praktikë ai i përshkruan praktikrat simbolike, si festat zyrtare, inaugurimet, memorialët etj., dhe ato të përditshme me të cilat shtetet krijojnë relacionet me shoqëritë, si të brendshme ashtu edhe të huaja. Kjo përfshin edhe konstruktimin diskursiv e narrativ, por edhe rregullimin institucional përmes praktikave të shumëllojshme, si lejet, hartat, tekstet shkollore etj., me të cilat edhe mund të përforcohet imazhi mbi shtetin (Migdal, 2001: 15-22).

Siç edhe e cekëm më lart, raporti mes shtetit e shoqërisë varet edhe nga sistemi politik ekzistues, sepse në shtetet absolutiste e regjime diktatoriale marrëdhëniet janë të bazuara zakonisht në nënshttrim, dhunë e frikë kolektive. Ndërkaq në sistemet demokratike marrëdhëniet ndërmjet shtetit e shoqërisë janë komplementare dhe të ndërvarura. Në demokracitë liberale ndër pikat qendrore janë zgjedhjet periodike si një mjet i kontrollit të pushtetit nga ana e qytetarëve.

Mbrojtësit e interesave të shoqërisë në një shtet demokratik nuk janë vetëm ligjet dhe institucionet, si alfa dhe omega e çdo shteti, por janë edhe mediet e pavarura dhe shoqëria civile ato që mbrojnë të drejtat, interesat dhe vlerat e shoqërisë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kjo varet edhe nga kultura politike, e cila përfshin qëndrimet, vlerat dhe sjelljet që kanë qytetarët për politikë, qeverisje dhe në përgjithësi rreth institucioneve shtetërore. Koncepti i kulturës politike nënkupton se vlerat, besimet e normat e shoqërisë të kenë ndikim të rëndësishëm mbi politikën, veçanërisht mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe shoqërisë. Duke e marrë si rast studimor Italinë, politologu Robert Putnam ka argumentuar se si ka ndikuar kultura politike ose, siç e quan ai, kapitali social në sistemin politik, në zhvillimin ekonomik dhe në efikasitetin e qeverisjes italiane në përgjithësi. Kapitali social përbën besimin e ndërsjellë, normat sociale dhe ndërlidhjet që mundësojnë veprime më efektive për të mirën publike, ku ai edhe gjen shkaqet e dallimeve politike, por edhe socio-ekonomike mes veriut të pasur italian dhe jugut më pak të zhvilluar (Putnam, 1993).

Ndërsa autorët Daren Acemoglu dhe James A. Robinson (2018) në librin mjaft voluminoz e të pasur me shembuj, "Pse dështojnë kombet", parashtrojnë pyetjen e thjeshtë pse disa shoqëri janë të varfra e disa tjera të pasura? Pasi që i pasqyrojnë kushtet jetësore diametralisht të ndryshme në qytetin e Nogales, në të dyja anët e kufirit, në atë amerikan dhe meksikan, autorët e trajtojnë zhvillimin historik të këtyre shteteve dhe gjejnë në krijimin e konsolidimit të institucioneve politike burimin e këtyre pabarazive ekonomike. Sikurse edhe në dallime të tjera të shumta mes shteteve të varfra e pasura, pabarazia rezulton, sipas tyre, jo nga dallimet kulturore, gjeografike, vlerat shoqërore apo popullsia që mund të kenë ato ndërmjet vete, por nga cilësia e institucioneve politike që përcaktojnë edhe institucionet ekonomike dhe të tjerat. Në fakt, dallimi thelbësor mes shteteve të dështuara dhe atyre prosperuese qëndron në atë që ata i quajnë institucione ekstraktive - kur këto i shërbejnë vetëm një rrethi të caktuar pushtetarësh, dhe atyre inkluzive - kur këto janë gjithëpërfshirëse, duke iu mundësuar qytetarëve pjesëmarrje si në vendime politike ashtu edhe në përfitime ekonomike. Nga prizmi teorik ky thjeshtësim mund të duket si një

emërtim tjetër për dallimet mes sistemeve demokratike e autoritare apo mes atyre liberale e totalitare, por ata besojnë se këto mund të jenë pasoja të llojit të institucioneve e jo shkaktarë të këtyre regjimeve. Çka është e domosdoshme për sukses të institucioneve inkluzive, është gjithsesi centralizimi i tyre fillimisht, në mënyrë që të sigurohen rendi dhe ligji, shërbimet e nevojshme publike dhe edukimi. Ndërsa, qëndrueshmëria e tyre vjen nga pluralizmi politik dhe shpërndarja e drejtë dhe e barabartë e pasurisë.

Sidoqoftë, rastet e shtjelluara të Acemougut dhe Robinsonit tregojnë se ka shembuj të mjaftueshëm që popujt e civilizimet edhe nën institucione ekstraktive - si ato të Maja apo Romës, kishin zhvillim të konsiderueshëm politik e ekonomik, por ato dështuan pasi që nuk kishin bazë të qëndrueshme. Arsyet, përveç tjerash, qëndrojnë në bllokimin e “kreativitetit shkatërrues” - novacionit teknologjik dhe konkurrencës ekonomike, dhe rrjedhimisht krizës ekonomike e socio-politike. Pushtetarët absolutistë u druheshin ndryshimeve të shpejta ekonomike, sidomos gjatë revolucionit industrial, dhe kjo bëri që ato vende të stagnojnë (si Rusia cariste, Perandoria Austro-Hungareze, Osmane) në krahasim me ato vende ku elitat politike hapën tregun e lirë dhe i konsoliduan institucionet inkluzive (si në Britani, Amerikë, Australi). Edhe pse, siç e shpjegojnë ata, në rastet e kombeve afrikane dhe latino-amerikane është roli i faktorëve të jashtëm, respektivisht i kolonizatorëve, ajo që i themeloi këto institucione eksploatuese.

Por, pse edhe pas pavarësimit të tyre ato nuk prosperuan? Sepse, në shumicën e rasteve elitat e sapoardhura në pushtet jo vetëm që e trashëguan, por e kopjuan mënyrën përjashtuese e abuzuese të politikbërjes. Janë rastet e shtjelluara nga Etiopia, Zimbabveja, Kongoja apo edhe Guatemala e Kili ato që ofrojnë dëshmi për dështim dhe katastrofë në njerëz. Mirëpo, ka edhe tregime të tilla suksesi që kaluan nga forma ekstraktive e institucioneve politike e ekonomike në ato inkluzive, si Japonia, Koreja Jugore, Kili, Botsuana etj. Kështu, argumenti i tyre është se nuk ka bazë shkencore për një ndarje të botës në atë perëndimore apo lindore, apo të botës së pare e të tretë. Por, ka shtete e kombe që janë të hapura ndaj ndryshimeve të vazhdueshme dhe konkurrencës së lirë, dhe shtete të tilla që mbyllen nga rrethet e

ngushta e vicioze pushtetarësh dhe kështu varfërohen tutje. Sigurisht që ka edhe faktorë të tjerë dhe rrethana të caktuara, përtej atyre që theksohen në këtë qasje, që mund të ndikojnë në zhvillim apo varfërim të shteteve. Sidoqoftë, fakt i pamohueshëm mbetet se janë marrëdhëniet e shëndosha shtet-shoqëri, që krijojnë bazën e barazisë e lirisë politike dhe prosperitetit socio-ekonomik.

## 7. Shtetndërtimi bashkëkohor

Siç arritëm të kuptojmë deri më tani, shumica e qasjeve mbi shtetformimin përpiqen ta përcaktojnë këtë në bazë të disa tipareve strukturore, faktorëve dhe qëllimeve të deklaruara. Në interpretimin e tij të gjerë, shtetformimi në esencë përshkruan procesin socio-politik dhe historik të formimit të shteteve. Kjo fushë kërkimore fillimisht lidhet me studimet e shkencave shoqërore rreth shfaqjes së shteteve të para në Evropën Perëndimore, ndryshimet dhe dallimet e tyre strukturore, sikurse dhe shtrirjen e pushtetit brenda shtetit dhe përballë shteteve të tjera. Vitet e fundit, dhe veçanërisht në qarqet dhe diskursin politik, “shtetndërtimi” kuptohet më pak si proces historik i formimit të shteteve, por më tepër përshkruan konceptin e ndërtimit ose rindërtimit të strukturave politike, institucioneve publike, infrastrukturës dhe kapaciteteve ekonomike në shoqëritë e dala nga luftërat ose tek shtetet e dështuara.

Njëri nga autorët më të shquar të saj, Simon Chesterman, e përshkruan në këtë mënyrë: “shtetndërtimi i referohet ndërhyrjes së zgjeruar ndërkombëtare (kryesisht, edhe pse jo ekskluzivisht, përmes Kombeve të Bashkuara) që shkon përtej mandateve tradicionale të misioneve paqeruajtëse dhe paqëndruesë, dhe drejtohet në ndërtimin ose rindërtimin e institucioneve qeverisëse të afta për t’u siguruar qytetarëve siguri fizike dhe ekonomike” (Chesterman, 2004: 5). Gjithashtu edhe Richard Caplan vuri në pah dallimin midis misioneve paqeruajtëse dhe intervenimeve shtetndërtuese duke i përkufizuar këto të fundit si: “Shtetndërtimi u referohet përpjekjeve për të rindërtuar, ose në të njëjtat raste për të krijuar për herë të parë struktura efektive dhe autonome të qeverisjes në një shtet ose territor ku nuk ekziston një kapacitet i tillë ose ku është dëmtuar thellësisht” (Caplan, 2005: 3).

Shtetndërtimi kuptohet gjithashtu si angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare në vendet e dala nga lufta, në mënyrë që të mbështesë procesin e kalimit në shtete të qëndrueshme dhe funksionale. Ky koncept normativ bazohet në idenë se shtetet e dobëta ose të

dështuara nga konfliktet duhet të (ri) ndërtohen me mbështetje të drejtpërdrejtë nga aktorët e jashtëm, që të jenë në gjendje të bëhen anëtarë legjitimë të bashkësisë ndërkombëtare si shtete funksionale. Me misione të shtetndërtimit synohet që përmes krijimit të institucioneve dhe konsolidimit të funksioneve shtetërore paqja dhe stabiliteti mund të sigurohen jo vetëm në vendin e prekur, por edhe në të gjithë rajonin dhe botën. Kjo presupozon që në njërin anë duhet të ekzistojë gatishmëria nga ana e aktorëve lokalë për të pranuar në mënyrë konstruktive e bashkëpunuese një mision të tillë, por edhe aftësinë që përmes veprimeve e masave të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të vetë shtetndërtimit (Schneckener, 2004: 21).

Në këtë kuptim shtetndërtimi përfshin qëllime të ngjashme me ato që kërkoheshin të arriheshin me modernizimin në vitet 1950 dhe 1960, me programet e donacionet për zhvillim gjatë viteve 1970 dhe 1980 dhe me përpjekjen për demokratizim në vitet 1990, përkatësisht synimin e një niveli të caktuar të sigurisë për të arritur qëndrueshmërinë ekonomike në vendet në zhvillim dhe ato të pasluftës. Megjithatë, një dallim domethënës është se këto masa mbështetëse të shtetndërtimit organizohen dhe zbatohen në masë të madhe në vend edhe nga vetë aktorët e jashtëm: duke filluar nga organizimi dhe vëzhgimi i zgjedhjeve deri në hartimin e një kushtetute të re (Chandler, 2006). Qëllimi përfundimtar i shtetndërtimit duhet të jetë (ri) krijimi i plotë i shtetësisë dhe sovranitetit, apo siç e përmbledh në mënyrë mjaft koncize Fukuyama (2010: 17) "Ndërtimi i shtetit është krijimi i institucioneve të reja qeverisëse dhe fuqizimi i atyre ekzistuese."

Në publikimet dhe diskutimet rreth shtetndërtimit janë në përgjithësi tri këndvështrime që mbizotërojnë, përkatësisht njëra qasje nga siguria - ku kryesisht fenomeni i shteteve të dobëta lidhet me ndërtimin e shtetit. Së dyti, ka shpjegime nga qasja zhvillimore - në të cilat pasqyrohen kritikantët ndaj imperializmit dhe neoliberalizmit. Së fundi, perspektiva e lidhur me paqen dhe demokratizimin si synim dhe si sfidë e proceseve shtetndërtuese.

## 7.1. Shtetndërtimi përballë shtetdështimit

Temë boshte në debatet mbi misionet e shtetndërtimit është vetë shteti, dhe në kontekstin e kushteve të ndryshimeve globale - rikonceptimi i shtetit dhe funksioneve të tij. Në fund të shekullit XX roli i shtetit në ruajtjen e rendit juridik dhe stabilitetit të brendshëm, si dhe në formësimin e sigurisë ndërkombëtare u perceptua si gjithnjë e më i rëndësishëm. Për më tepër, është shumë e rëndësishme se si shtetet qeverisen dhe përmbushin detyrat e tyre thelbësore pasi vendet me struktura shtetërore të brishta mund të shkaktojnë edhe konflikte të dhunshme, të cilat më pas mund të përhapen edhe jashtë kufijve shtetërorë. Rrjetet kriminale dhe terroriste gjithashtu mund të veprojnë më lehtë në zona që nuk i nënshtrohen autoritetit shtetëror (Krasner, 2004). Dukuria e shteteve të dështuara përfshin humbjen e kontrollit të qeverisë mbi territorin, dështimin e institucioneve shtetërore dhe funksioneve themelore, dhe në përgjithësi, mungesën e autoritetit shtetëror. Së këndejmi, shkaku kryesor i shumicës së konflikteve e luftërave aktuale i atribuohet problemit të rezultuar prej shteteve të brishta ose atyre të dështuara.

Kërcënimet që vijnë nga shtetet e dobëta ose të dështuara e shtynë gjithnjë e më shumë komunitetin ndërkombëtar të zhvillojë kundërmasa të përshtatshme strategjike. Sidomos pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001, në Qendrën Botërore të Tregtisë në Nju-Jork, problemi i shteteve të dështuara hyri në agjendën e politikës ndërkombëtare dhe u evidentua se ishte një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare dhe atë ndërkombëtare (The White House, 2002). Çështja me shtetet e dështuara u lidh kështu me terrorizmin global, përshkallëzimin e konflikteve dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Duke pasur parasysh potencialin kërcënues të tyre dhe implikimet e lidhura në sigurinë ndërkombëtare, shtetndërtimi u bë strategjia dhe mekanizmi i bashkësisë ndërkombëtare në trajtimin e problemeve të shteteve të dështuara (Dobbins, 2003). Kjo përfshinte intervenimin ushtarak nga aktorët e jashtëm - qoftë nga një aleancë ad hoc e disa shteteve, organizatave rajonale apo ndërkombëtare (në rastin më të mirë nga OKB-ja) - në shtetet e brishta ose të dala nga konflikti i armatosur, me qëllim të ngritjes së një lloj protektorati ose administrate të përkohshme në mënyrë që të (ri) ndërtojë shtetin.

Njëri nga përkrahësit më të njohur të shtetndërtimit, Francis Fukuyama (2010), e sheh këtë si reagim ndaj shteteve të dështuara dhe pasojave të tyre, dhe pohon se kjo është detyra imediate e politikës ndërkombëtare për të siguruar rendin global. Angazhimi dhe përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare në misionet e tilla lidhet, ndër të tjera, edhe me një konceptim të ndryshuar të shtetësisë dhe sovranitetit, ashtu siç Stephen Krasner (2002) e elaboron bazuar në konceptin e “sovranitetit të përbashkët” (shared sovereignty). Me këtë nënvizohet përfshirja e aktorëve të jashtëm në struktura dhe autoritetet e brendshme për perioda të pacaktuara kohore me qëllim të arritjes së kapaciteteve qeverisëse.

Kështu, shteti perceptohet si pjesë e problemit dhe njëkohësisht si pikënisje për zgjidhjen e problemit. Me konceptin e shtetndërtimit aktorët e jashtëm në vendet e prekura duhet të mundësojnë konsolidimin e autoritetit dhe të krijojnë një bazë për stabilitet politik dhe zhvillim ekonomik. Në këtë mënyrë krijohen kushtet për paqe dhe siguri si në vendet e prekura ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Megjithatë, shtetndërtimi nuk bëhet vetëm për motive altruiste e humanitare nga ana e bashkësisë ndërkombëtare ose shteteve të fuqishme. Janë edhe interesat gjeopolitike e strategjike dhe politikat e sigurisë kombëtare arsyet e mundshme të ndërmarrjes së misioneve të tilla nga ana e shteteve të fuqishme. Disa autorë madje shkojnë aq larg me kritika sa të supozojnë se shtetndërtimi është vetëm një emër tjetër për tendencat imperialiste të fuqive të mëdha (veçanërisht SHBA-së) dhe se dëshirojnë të përdorin këto misione për të justifikuar politikat e tyre ekspansioniste.



## 7.2. Shtetndërtimi përballë kolonializmit

Shteti ka pësuar ndryshime thelbësore në dekadat e fundit, kështu që “punët e brendshme” të një shteti nuk mund të jenë më të paprekshme dhe politika e tij nuk mund të jetë plotësisht e pavarur nga ndikimi i bashkësisë ndërkombëtare. Nga ana tjetër, bashkësia ndërkombëtare (shtetet, organizatat ndërkombëtare e rajonale dhe OJQ-të aktive në nivel global) gjithashtu e kuptojnë dhe e trajtojnë shtetin si faktorin më të rëndësishëm për stabilitetin dhe prosperitetin kombëtar dhe si një aktor thelbësor për sigurinë dhe paqen ndërkombëtare. Kjo është arsyeja pse problemet e thella dhe krizat - qofshin ato luftëra të armatosura apo dështim i shtetit - me të cilat përballlet një shtet paraqesin sfida të mëdha për bashkësinë ndërkombëtare, të cilat vështirë se mund të injorohen.

Disa raste dhe situata të tilla rezultojnë me ndërhyrje ushtarake nga jashtë dhe misione të shtetndërtimit në shtete pas konflikteve. Këto ndërhyrje ndodhin ose përmes projekteve të ndryshme humanitare dhe masave të gjera mbështetëse nga jashtë, ose përmes krijimit të një misioni të administratës së përkohshme, që do të thotë se funksionet e shtetit merren përsipër dhe kryhen nga aktorët e jashtëm. Richard Caplan (2002: 84) i quan këto lloje të misioneve edhe “Rolls-Royce” i strategjive të menaxhimit të konfliktit. Funksionet qeveritare dhe detyrat administrative, duke përfshirë të drejtat sovrane të shtetit, u delegohen organizatave ndërkombëtare si p.sh. OKB-së.

Sidoqoftë, janë pikërisht marrëdhëniet midis aktorëve të jashtëm dhe të brendshëm që përfaqësojnë një fushë komplekse dhe problematike, e cila jo rrallë është subjekt i kritikave të shumta. Në këtë kontekst Michael Ignatieff (2003) përdor shembullin e de facto protektorateve të administruara ndërkombëtarisht – siç ishin dikur Bosnja e Hercegovina, Kosova dhe Afganistani - për të ilustruar politikën e “imperializmit të butë”, ashtu siç e titullon në librin e tij “Empire Lite”. Çështja thelbësore është, sipas tij, konflikt interesash midis interesave të fuqive ndërhyrëse dhe interesave të njerëzve lokalë dhe udhëheqësve të tyre politikë në ato vende ndërhyrëse.

Një lloj ngjashmërie midis misioneve të shtetndërtimit dhe administratave koloniale ose sundimit perandorak të shekullit të kaluar vihet në spikamë edhe nga Roland Paris (2002), i cili e shpjegon këtë fenomen me termin “mision civilisatrice”. Mirëpo, ajo që i dallon misionet aktuale shtetndërtuese nga imperializmi i dikurshëm është fakti se aktorët e jashtëm sot nuk tregojnë interes për të ruajtur një formë administrate “koloniale” dhe për të qëndruar në shtetet përkatëse për një periudhë të pacaktuar. Përkundrazi, bashkësia ndërkombëtare synon të përfundojë misionet e saj (me sukses) dhe të tërhiqet plotësisht sa më shpejt që të jetë e mundur. Fukuyama (2010), nga ana tjetër, argumenton kundër tezës imperialiste, duke theksuar se përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare janë të promovojnë demokracinë, të drejtat e njeriut dhe vetëvendosjen, të cilat në parim nuk mund të jenë qëllime imperialiste. Misionet e shtetndërtimit dhe politikat e mëparshme kolonialiste të disa vendeve evropiane dallojnë edhe për shkak se aktorët e përfshirë sot janë kryesisht shtete ose organizata ndërkombëtare, ndërsa në epokën kolonialiste ishin kompanitë private të kontraktuara nga shtetet për të kontrolluar dhe sunduar kolonitë e okupuara. Një tipar tjetër dallues ka të bëjë me objektivet e caktuara, sepse synimi i deklaruar i misioneve shtetndërtuese është krijimi ose rindërtimi i institucioneve dhe strukturave shtetërore dhe më pak transformimi shoqëror ose ndikimi i normave dhe vlerave sociale. Prandaj, në kapitullin tjetër çështjet se cilat janë motivet që shtyjnë aktorët e jashtëm të përfshihen në misionet shtetndërtuese dhe mbi cilat parime themelore veprojnë do të diskutohen tutje më gjerësisht.

### 7.3. Shtetndërtimi përballë demokratizimit

Në literaturën shkencore ekziston supozimi se shtetet që janë të organizuara sipas parimeve liberale dhe demokratike kanë më shumë gjasa të pranohen në mënyrë legjitime nga shoqëritë e tyre dhe perceptohen më paqësore për rendin ndërkombëtar sesa shtetet jodemokratike. Kjo ide rrjedh nga teoria liberale e paqes, sipas së cilës sistemi demokratik përfaqëson formën më paqësore të qeverisjes dhe kontribuon si në stabilitetin e brendshëm ashtu edhe në rendin e sigurisë ndërkombëtare (Richmond, 2005). Që nga vitet 1990, kjo qasje është përfshirë gjithnjë e më shumë në konceptin dhe praktikën e operacioneve paqeruajtëse dhe ato shtetndërtuese të OKB -së. Aktorët kryesorë në misionet të tilla, si organizatat ndërkombëtare OKB-ja, NATO-ja, BE-ja, OSBE-ja, FMN-ja, Banka Botërore dhe agjenci të ndryshme shtetërore të zhvillimit, të gjitha janë të frymëzuara nga koncepti liberal i paqes dhe projektet e demokratizimit. Qasja demokratike gjithashtu u pranua gjerësisht dhe u përhap edhe në mesin e organizatave joqeveritare ndërkombëtare dhe shoqërisë civile (Paris, 2004).

Qëllimi themelor i shtetndërtimit duket të jetë krijimi i një rendi politik dhe ekonomik liberal në shoqëritë e dala nga luftërat (Dobbins, 2005). Tranzicioni demokratik është nocioni me të cilën shpesh ky proces përshkruhet, sepse demokratizimi shkon paralelisht me legjitimitetin dhe vullnetin politik të popullsisë. Nga ana tjetër, organet qeverisëse e të qëndrueshme, si dhe institucionet efektive shtetërore janë thelbësore për të zbatuar me sukses procesin kompleks dhe të brishtë të transformimit nga një gjendje e pasluftës në një shtet paqësor dhe demokratik. Promovimi i demokracisë nuk perceptohet vetëm si një aspekt i shtetndërtimit, por edhe si qëllimi përfundimtar i misioneve të tilla. Çështjet që lidhen me parimet e sundimit të ligjit, “qeverisjes së mirë”, kapacitetet institucionale, shkallën e ndarjes së pushtetit (ndërmjet ekzekutivit, legjislativit dhe judikativit), liberalizimit ekonomik (lirisë së tregut), të drejtat e njeriut, si dhe liria e shtypit, janë jo vetëm elemente përbërëse të demokracisë, por gjithashtu formojnë komponentët qendrorë të shtetndërtimit. Mirëpo, para se të konsolidohet demokracia duhet të ekzistojë fillimisht shteti, ndërsa për ndërtimin e një shteti legjitim dhe të qëndrueshëm demokracia

është një domosdoshmëri. Së këndejmi, shtetndërtimi dhe demokratizimi bëhen procese të ndërvarura e të ndërsjella. Prandaj ky kushtëzim dhe proces paralel e bën shtetndërtimin tejte sfidues. Kjo mbështetet edhe nga fakti se shtetndërtimi shpesh ndodh në shoqëritë e pasluftës dhe kështu në një mjedis të pasigurt në të cilin rregullat dhe normat e “zakonshme” shtetërore humbin vlefshmërinë e tyre, shtu kësaj që mjetet dhe kapacitetet në këso situata janë tejte të kufizuara, kjo e bën shtetndërtimin tepër kompleks dhe demokratizimin tejte të brishtë.

Misionet ndërkombëtare të shtetndërtimit për të qenë të suksesshme duhet të kenë mandat të qartë si dhe qartësi në lidhje me komponentët thelbësorë që duhet të shtyjnë përpara demokratizimin e vendit. Kjo varet sigurisht edhe nga përfshirja e gjithëmbarshme dhe angazhimi i forcave politike vendore për të ngritur institucione efikase, për të siguruar rendin dhe ligjin, si dhe për të konsoliduar një sistem demokratik (Chesterman, 2004). Meqenëse vetë procesi i shtetndërtimit është i ndërlikuar, edhe konsolidimi i shtetit sikurse edhe niveli i demokratizimit ndryshojnë prej rastit në rast. Ky fakt e bën gati të pamundur një analizë teorike të përgjithësuar të këtij fenomeni socio-politik, sepse secili rast studimor ka veçoritë e veta dhe rrethanat specifike, andaj elaborimi nënkupton që aspektet kontekstuale dhe tiparet specifike të përfshihen në trajtimin shkencor duke e bërë thujse të pamundur përgjithësimin teorik. Shembulli i shtetndërtimit në Kosovë është në vetvete një rast kompleks dhe në të vërtetë sui generis, pasi konsistonte në kontradikta të thella midis masave operacionale të misionit ndërkombëtar dhe qëllimeve politike, midis mandatit de jure që kishte misioni dhe zhvillimeve de facto politike e sociale në terren, si dhe midis mjeteve të përdorura e strategjive të zbatuara nga bashkësia ndërkombëtare dhe objektivave të arritura. Prandaj, pjesa e tretë e librit do të merret më gjerësisht me rastin e shtetndërtimit, përkatësisht shtetformimit të Kosovës, si dhe dimensioneve e aspekteve përcjellëse që përfshin ky proces.

PJESA

3

## 8. Shtetformimi i Kosovës

Siç u theksua më lart, ekziston një dallim konceptual midis shtetformimit - që në parim përshkruan procesin socio-politik dhe historik të krijimit të shteteve, dhe shtetndërtimit - si angazhim i shumanshëm i bashkësisë ndërkombëtare për (ri) ndërtimin e strukturave politike, institucioneve publike, infrastrukturës ligjore dhe administrative në shoqëritë e pasluftës ose në shtetet e dështuara (Chandler, 2006). Misionet e tilla mund të karakterizohen edhe si “autokraci dashamirëse”, siç i cilëson Chesterman (2004), për shkak se kanë deficite të konsiderueshme demokratike, por këto kontribuojnë në vendosjen e paqes dhe të stabilitetit, si dhe në funksionalizimin shtetëror në vendet ndërhyrëse.

Meqenëse në rastin e Kosovës kemi të bëjmë si me një mision të tillë mbështetës ashtu edhe me një proces të gjithëmbarshtëm të formimit të shtetit të ri, atëherë do të trajtojmë si shtetformimin ashtu edhe shtetndërtimin në mënyrë komplementare. Kjo edhe për arsye se shteti i Kosovës është rezultat i procesit historik dhe synimeve afatgjata politike, por njëkohësisht sepse u bë i mundur pas misionit dhe përkrahjes ndërkombëtare që këtë proces e mbështeti në shumë aspekte. Me gjithë faktin që një mision i tillë aq i ndërlikuar dhe gjithëpërfshirës, siç ishte ky i UNMIK-ut, kishte mangësi dhe gabime të ndryshme, mbetet ndër më unikët dhe më të jashtëzakonshmit. Gjithashtu, edhe sepse shtetësia e Kosovës, sado e vonuar dhe nga disa shtete ende e kontestuar, është derivat i një procesi që po ndjek trajektoren e shteteve të tjera evropiane, tashmë mirë të konsoliduar. Për të kuptuar më mirë shtetformimin e Kosovës, krahas rrjedhave historike dhe zhvillimeve politike, është e nevojshme të pasqyrohet konteksti i misionit ndërkombëtar dhe rrethanat politike që çuan në pavarësi, sikurse që nevojitet të shtjellohen sistemi politik, zhvillimet demokratike, rendi kushtetues dhe sfidat e ndryshme të shtetit më të ri evropian. Më tutje do të diskutohet edhe procesi i formimit të identitetit kosovar dhe attributeve kryesore që e karakterizojnë në këtë fazë.

## 8.1. Konteksti historik

Një nga çështjet më të kontestueshme në historitë kombëtare është ajo me zanafillën e paraqitjes së parë si komb dhe pikënisjes së krijimit të shtetit. Një histori e cila i paraprin shpalljes zyrtare të pavarësisë dhe sovranitetit shtetëror. Në historiografitë me qasje nacionaliste zakonisht fillohet me antikën, duke bërë kapërcim mijërvjeçar mes popujve të hershëm dhe atyre të tanishëm, për t'i stilizuar këta si paraardhësit e tyre të pastër e të drejtpërdrejtë. Këtyre qasjeve në të shumtën e rasteve u mungojnë faktet shkencore dhe zakonisht shërbehen me mite, ngjarje e narracione nacionaliste. As historia e Kosovës, në këtë kuptim, nuk përbën ndonjë përjashtim. Prandaj, cilado periudhë apo ngjarje që do të përzgjidhej mund të kontestohet dhe sulmohet si dashakeqe. Këtij rreziku i ekspozohet edhe ky trajtim i shkurtër i historikut të Kosovës. Sepse, siç edhe e kemi nënvizuar, historia dhe ballafaqimi me të kaluarën janë të ndikuara politikisht dhe të instrumentalizuara vazhdimisht nga pushtetet.

Pushtimi osman i këtyre trevave rreth vitit 1455 ndoshta paraqet pikënisjen më të duhur të historisë së Kosovës (Schmidt, 1999: 82). Pasi që me këtë ndryshoi konstelacioni i forcave politike në rajon, pasuan dyndjet e popullsi, gradualisht konvertimi fetar, si dhe përfshin një hark kohor mbi pesëqindvjeçar të sundimit, me pasoja afatgjate deri në ditët e sotme. Emërtimi si Kosovë hyri në përdorim të gjerë vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kur Vilajeti i Kosovës si një njësi territoriale e administrative u krijua në Perandorinë Osmane (Malcolm, 2001: 11). Me rritjen e ndikimit të fuqive të mëdha si Austro-Hungaria dhe Rusia dhe dobësimin e Perandorisë Osmane në Ballkan, popujt e këtij gadishulli i shtuan përpjekjet për të arritur pavarësinë e tyre (Bozbor, 2002). Në fillim të shekullit XIX pati kryengritje popullore gati në të gjithë Ballkanin. Pas Traktatit të Adrianopojës midis Rusisë dhe Perandorisë Osmane, Serbia u njoh si principatë e pavarur. Nën drejtimin e Otto von Bismarck, në qershor të vitit 1878, u organizua Kongresi i Berlinit, ku u ripërcaktuan kufijtë në Ballkan. Për këtë arsye një lëvizje rezistence kundër copëtimit të vendbanimeve shqiptare filloi të organizohej. Abdyl Frashëri, një nga intelektualët më të shquar shqiptarë dhe deputeti i Parlamentit osman, themeloi "Komitetin qendror për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve" në Stamboll, në

fillim të vitit 1878 (Malcolm, 2001: 229). Ky komitet thirri prijësit fisnorë shqiptarë më me ndikim të kohës në një kuvendim në qytetin e Prizrenit më 10 qershor të të njëjtit vit, ku u themelua lëvizja kombëtare shqiptare, e cila hyri në histori si Lidhja e Prizrenit. Lidhja dërgoi një memorandum në Berlin duke dënuar copëtimin e planifikuar të trevave. Programi politik i kësaj organizate parashihte që viset e populluara me shqiptarë të arrinin autonominë brenda Perandorisë Osmane dhe kërkonte që katër vilajetet me shumicë shqiptare të shkriheshin në një të vetme. Në Kongresin e Berlinit këto kërkesa nuk u pranuan, përkundrazi, Serbisë iu dha territori përreth Nishit, ndërsa Malit të Zi iu dhurua Ulqini, sikurse iu njoh pavarësia e të dyja vendeve (Malcolm, 2001: 245). Rezistenca e armatosur e trupave të Lidhjes së Prizrenit u mposht përfundimisht më 1881. Shpërbërja e Perandorisë Osmane nxiti gjithashtu rivalitete dhe aspirata territoriale midis popujve të Ballkanit, që çuan në konfliktet e njohura si Luftërat Ballkanike të viteve 1912-1913. Gjatë Luftës së Parë Ballkanike, Serbia e pushtoi Kosovën. Si pjesë e Konferencës së Londrës, e nisur më 1912, dhe e cila përfundoi me Traktatin e Paqes më 30 maj 1913, detyra kryesore e së cilës ishte riorganizimi i Ballkanit pas tërheqjes së Perandorisë Osmane, Shqipërisë iu njoh statusi i shtetit të pavarur (Bartl, 1995). Mirëpo, Kosova dhe trevat e tjera të banuara me shqiptarë u ndanë midis Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe me shpërbërjen e Perandorisë Austro-Hungareze, më 1 dhjetor 1918 u shpall Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, e cila tanimë e përfshinte edhe Kosovën. Disa vjet më vonë, saktësisht në vitin 1929, u vendos diktatura monarkiste dhe emërtimi iu ndryshua në Mbretëria e Jugosllavisë (Petritsch, 1999). Në vitet 1930 autoritetet jugosllave filluan gjithnjë e më shumë të shpronësojnë shqiptarët, duke shtyrë popullsinë e Kosovës buzë mbijetesës me qëllim për t'u shpërngulur nga trojet e tyre. Për këtë qëllim në vitin 1937 historiani dhe anëtari i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve, Vasa Çubrilović, shkroi memorandumin famëkeq me titull "Dëbimi i shqiptarëve". Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe të pushtimit italian e gjerman të vendit, ky plan për fat nuk arriti të realizohej. Pas përfundimit të luftës ushtria partizane, nën udhëheqjen e Josip Broz Titos, më 29 nëntor të vitit 1945, shpalli



Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Megjithëse komunistët jugosllavë premtuan që Kosovës t'ia ofrojnë statusin e republikës dhe Këshilli Nacionalçlirimtar i Kosovës në konferencën e Bujanit votoi në favor të bashkimit me Shqipërinë, Kosova në fund të luftës mbeti krahinë autonome brenda Jugosllavisë. Shqiptarët nuk u njohën si komb konstituiv, por vetëm si kombësi (narodnost), pra pakicë kombëtare (Malcolm, 2001: 325).

Pozita politike dhe socio-ekonomike e shqiptarëve edhe në këtë Jugosllavi mbeti jashtëzakonisht e rëndë. Madje u përkeqësua edhe më tej, veçanërisht pas prishjes së marrëdhënieve midis Titos dhe Stalinit në vitin 1948, dhe më pas përkeqësimi i marrëdhënieve midis Beogradit dhe Tiranës. Që nga kjo kohë presioni politik mbi shqiptarët u rrit në mënyrë drastike përmes masave represive nga shërbimi sekret jugosllav (UDBA) i kryesuar nga ministri i Brendshëm, Aleksandër Rankovič, me pretekstin për luftimin e spiunazhit dhe posedimin e paligjshëm të armëve nga shqiptarët e Kosovës. Sipas Malcolm (2001: 323) mes viteve 1946-1966 nga Jugosllavia emigruan për në Turqi rreth 246.000 njerëz, shumica shqiptarë të Kosovës. Vetëm pas shkarkimit të Rankovičit dhe sigurimin e më shumë të drejtave politike, përfshirë krijimin e Universitetit të Prishtinës, për Kosovën filloi një fazë e normalizimit dhe emancipimit. Me Kushtetutën e re të vitit 1974, Kosovës si krahinë iu dhanë të drejta më të gjera dhe statut të barabartë si entitet autonom brenda shtetit federal. Në krahasim me republikat, krahinat në ish-Jugosllavi nuk kishin të drejtën e shkëputjes, mirëpo gëzonin autonomi të cilat praktikisht i vendosën në një pozitë të barabartë me republikat e tjera.

## 8.2. “Republika” e Kosovës

Vitet 1980 me vdekjen e Titos, krizat ekonomike e politike, protestat studentore në Prishtinë dhe ardhjen e Slobodan Miloševićit në pushtet paraqesin fillimin e fundit të Jugosllavisë, si dhe krijimin e rrethanave të vështira për Kosovën. Politika e regjimit të Miloševićit kishte për qëllim dominimin serb dhe forcimin e pushtetit në Jugosllavi, si dhe sigurimin e këtyre qëllimeve me çdo mjet. Ai u personifikua nga serbët si simbol uniteti dhe si një shpëtimtar mitik, duke e keqpërdorur çështjen e Kosovës për qëllimet e errëta nacionaliste. Në mars 1989, parlamenti serb miratoi një amendament kushtetues që revokoi statusin autonom të Kosovës. Qytetarët e Kosovës reagoan me protesta masive, të cilat u shuan nga forcat e sigurisë, duke vrarë mbi njëqind demonstrues (Malcolm, 2001: 345). Një vit më vonë qeveria serbe miratoi një ligj të ashtuquajtur “Për rregullimin e punës” (e njohur në popullatë si “masat e dhunshme” ) me të cilin pothuajse të gjithë shqiptarët e Kosovës u përjashtuan nga administrata publike, gjyqësori, shkollat, universitetet dhe spitalet (Clark, 2000: 73). Diku rreth 80.000 qytetarë mbeten pa vendet e punës dhe pa të ardhura.

Ambiciet patologjike për pushtet të Miloševićit, situata politike e tensionuar në nivelin federal dhe kriza e rëndë ekonomike çuan në përforcimin e ideologjive nacionaliste dhe në pavarësim të republikave të tjera. Në këto rrethana edhe delegatët e Kuvendit të Kosovës reagoan duke shpallur në shtator 1990 përmes Kushtetutës së Kaçanikut “Republikën” e Kosovës dhe më pas u zgjodh dr. Ibrahim Rugova presidenti i parë i saj. Filozofia e tij politike rrjedh nga një qëndrim pacifist, duke insistuar në politikë të rezistencës paqësore karshi regjimit të ashpër serb. Një vit më vonë, në shtator 1991, mbi 90% e shqiptarëve në një referendum votuan për pavarësinë e plotë. Gjithashtu, qytetarët e Kosovës filluan gradualisht të krijojnë struktura paralele socio-politike, me të cilat trasuan rrugëtimin e pavarësimit. Howard Clark, i cili shkroi një libër të shkëlqyeshëm për zhvillimin politik të Kosovës, e përshkroi si një fenomen “shtetin në embrion” (Clark, 2000: 117). Kjo do të thotë që Kosova ishte në një proces formimi parashtetëror, me sistem paralel shëndetësor dhe arsimor. Një sistem i veçantë tatimor u organizua për mirëmbajtjen e këtij “shteti në hije”, ku shqiptarët si në Kosovë ashtu edhe ata në diasporë duhej të

paguanin tre për qind të të ardhurave të tyre për të. Strategjia e shqiptarëve të Kosovës gjatë rezistencës paqësore përbëhej nga tri shtylla: mbajtja e vazhdueshme e një qëndrimi pacifist, ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës përmes përfshirjes së një pale të tretë për zgjidhjen e problemit dhe refuzimi gjithëpërfshirës i autoritetit serb përmes bojkotimit të zgjedhjeve të regjimit serb dhe zhvillimin e mëtejshëm të strukturave të nevojshme për të etabluar “Republikën” e Kosovës (Baliqi, 2009).

Sidoqoftë, Marrëveshja e Dejtonit, e vitit 1995, e cila i dha fund luftës në Bosnjë e Hercegovinë, nuk solli zgjidhje për çështjen e Kosovës, siç shpresonte udhëheqja politike e LDK-së në Prishtinë. Që nga ajo kohë forcat e ndryshme politike në Kosovë filluan të bëhen më kritike ndaj kursit politik të udhëheqjes dhe më radikale në veprime. Sulmet e para të armatosura ndaj policisë serbe u kryen në pranverën e vitit 1996, për të cilat Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) mori përgjegjësinë. Gjatë vitit 1998 përleshjet e armatosura midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave serbe të policisë u intensifikuan. UÇK-ja ishte faktor i rëndësishëm, jo aq për shkak të forcës ushtarake apo numrit të pjesëtarëve, por, para së gjithash, sepse mishëronte aspiratat dhe përkrahjen e popullit të Kosovës (Reuter, 2000; Hedges, 1999).

Regjimi serb përmes përdorimit masiv të ushtrisë dhe policisë speciale përdori luftën kundër UÇK -së si pretekst për të terrorizuar dhe dëbuar popullsinë nga vatrat e tyre. Pas javëve të presionit politik dhe negociatave diplomatike, më në fund presidenti serb nënshkroi të ashtuquajturën “Marrëveshje Holbrooke-Milošević”. Kjo marrëveshje parashihte përfundimin e menjëhershëm të luftimeve, tërheqjen e trupave serbe në pozicionet e mëparshme dhe vendosjen e një misioni verifikues të OSBE-së në Kosovë (Petritsch, 1999). Mirëpo, gjendja në terren nuk ishte përmirësuar me të vërtetë. Misioni vëzhgues i OSBE-së, në krye me diplomatin amerikan William Walker, ishte dëshmitar i një masakre ndaj 45 civilëve shqiptarë nga forcat serbe në fshatin Reçak. Prandaj, më 29 janar 1999, ministrat e jashtëm të Grupit të Kontaktit hartuan në Londër një listë të kërkesave që duhet të shërbente si bazë për negociatat e paqes. Në bazë të kësaj rezolute, negociatat midis palës kosovare dhe asaj serbe filluan më 6 shkurt në kështjellën e

Rambujesë mbi statusin dhe zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Pas më shumë se dy javësh negociatat u pezulluan më 23 shkurt pa arritur ndonjë rezultat. Konferenca më 15 mars të të njëjtit vit vazhdoi në Paris. Derisa përfaqësuesit e Kosovës nënshkruan marrëveshjen, delegacioni serb e refuzoi atë me arsyetimin e mbrojtjes së integritetit territorial e sovranitetit të shtetit (Petritsch, 1999: 278). Dështimi i përpjekjes së fundit për negociata në Beograd dhe tërheqja e misionit vëzhgues të OSBE-së nga Kosova çoi në sulmet ajrore të NATO-s mbi objektivat ushtarake serbe më 24 mars 1999.

Pas rreth 77 ditësh (nga 24 marsi deri më 9 qershor) të sulmeve ajrore kundër Jugosllavisë dhe pas negociatave të mundimshme midis, asokohe, ministrit të Jashtëm finlandez, Martti Ahtisaari, dhe homologut të tij rus, Viktor Chernomyrdin, me presidentin serb Milošević, për tërheqjen e njësisë ushtarake nga Kosova, më në fund u arrit marrëveshja. Komanda e Paktit Veriatlantik dhe ushtria jugosllave nënshkruan një marrëveshje ushtarake për tërheqjen e trupave nga Kosova, më 9 qershor, në Kumanovë të Maqedonisë. Më 10 qershor Këshilli i Sigurimit i OKB -së miratoi Rezolutën 1244 (UNSCR) mbi vendosjen e një force paqeruajtëse nën komandën e NATO-s dhe vendosi Kosovën nën administrimin e përkohshëm të Misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK). Që nga atëherë Kosova është e kontrolluar dhe e siguruar ushtarakisht nga trupat e KFOR -it (përbërë nga 58 shtete të ndryshme), dhe ndarë në katër zona ushtarake, të cilat udhëhiqen nga shtetet më të fuqishme.

### 8.3. Nga administrimi deri te pavarësimi

Me krijimin e Misionit të Administratës së Përkohshme të OKB -së në Kosovë (UNMIK), OKB -ja, në bashkëpunim me organizatat e tjera ndërkombëtare, për herë të parë u përqendrua plotësisht në segmentet civile, ndërsa detyrat ushtarake dhe të sigurisë ishin të rregulluara nga Kosovo Force (KFOR) nën komandë të NATO-s. UNMIK-u u krijua dhe operoi në një klimë të tensioneve të larta ndëretnike, si rezultat i marrëdhënieve antagonistike midis shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Me tërheqjen e forcave ushtarake serbe dhe aparatit të pushtetit, strukturat shtetërore dhe e gjithë administrata mungonin tërësisht në vend.

Në këto rrethana UNMIK-u praktikisht duhej ta plotësonte këtë vakum dhe të kryente të gjitha funksionet bazike të një shteti si zëvendësim i strukturave që mungonin, derisa të rindëronte institucionet e duhura (Stahn, 2000). Kështu që, misioni i UNMIK-ut ngjashëm me atë në Timorin Lindor nga UNTAET mund të cilësohen pa dyshim si unike dhe ndoshta misionet e fundit shtetndërtuese të OKB-së (Chesterman, 2005: 3).

Mandati i UNMIK-ut buron nga Rezoluta 1244 e Këshillit të sigurimit të OKB-së, nga data 10 qershor 1999, sipas së cilës objektivat kryesore janë: të krijojë institucione të qëndrueshme dhe funksionale, të krijojë autonomi substanciale dhe vetëqeverisje, dhe së fundi të përgatisë procesin negociues për caktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës (Baliqi, 2009: 119). Si mision i administratës së përkohshme, UNMIK-u gjithashtu duhej të organizonte e të menaxhonte procesin e transferimit të kompetencave tek institucionet vendore. Misioni udhëhiqej nga i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB -së (Special Representative of the Secretary-General for Kosovo- SRSG), i cili ishte gjithashtu autoriteti më i lartë civil në vend dhe kishte kompetenca të zgjeruara si ekzekutive ashtu edhe legjislative. I dërguari i parë në Kosovë ishte Sergio Vieira de Mello (Brazil), i cili u zëvendësua një muaj më vonë nga Bernard Kouchner (Francë), i pasuar nga Hans Hakkerup (Danimarkë), Michael Steiner (Gjermani), Harry Holkeri (Finlandë) Soren Jessen-Petersen (Danimarkë) dhe Joachim Rücker (Gjermani). Statusi juridik i Kosovës ishte një lloj "sovrانيتeti i pezulluar" sepse de jure akoma konsiderohej në kuadër të sovranitetit territorial jugosllav, sipas së drejtës ndërkombëtare, edhe pse ky sovranitet de facto nuk ushtrohej pasi që Kosova ishte nën administrimin ndërkombëtar (Yannis, 2001: 19). Për këtë çështje kishte debate të shumta e trajtime shkencore në të drejtën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në misionin e UNMIK-ut përveç OKB-së ishin të përfshira edhe organizata të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, siç janë: Bashkimi Evropian, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Këshilli i Evropës dhe (ushtarakisht) aleanca e NATO-s. Gjithashtu ishin të përfshirë disa agjenci të OKB-së, të tilla si: UNHCR, UNDP, UNICEF, UNIFEM etj. Për të mos e mbingarkuar shumë OKB-në dhe për të

qenë në gjendje t'i përmbushë më mirë detyrat e saj, UNMIK-u u nda në katër dikastere të ndryshme - të njohura edhe si shtylla (Pillars). Secila nga këto shtylla udhëhiqej nga një përfaqësues i SRSG-së, në terminologjinë e UNMIK-ut i njohur edhe si Deputy SRSG (DSRSG). Shtylla e parë kishte të bënte me themelimin dhe avancimin e sektorit të policisë dhe sistemit juridik, shtylla e dytë kishte për detyrë formimin e një administrate publike funksionale, si në nivelin qendror ashtu edhe atë lokal. Ndërtimi i institucioneve qeverisëse, të drejtat e njeriut dhe demokratizimi ishin funksionet thelbësore të shtyllës së tretë, e cila udhëhiqej nga OSBE-ja. Ndërsa në shtyllën e katërt Bashkimi Evropian ishte bartësi kryesor për zbatimin e rindërtimit infrastrukturor dhe ekonomik të Kosovës. Detyra qendrore e BE-së ishte të rindërtonte infrastrukturën e shkatërruar dhe të hartonte një plan afatmesëm që do të mundësonte zhvillimin ekonomik.

Misioni i UNMIK-ut në Kosovë nuk ishte vetëm operacion paqësor, por edhe një mision politik që synonte të demokratizonte shoqërinë dhe politikën e Kosovës. Megjithëkëtë, nëse duam të shqyrtojmë objektivat specifike të UNMIK-ut dhe mekanizmat e përdorur për këtë qëllim, shtrohet pyetja se çfarë dhe si donte vërtet të arrinte UNMIK-u? Për të mos paragjykuar statusin final të Kosovës, bazuar në Rezolutën 1244, OKB-ja kishte krijuar një mision në Kosovë pa pasur një qëllim të qartë ose një strategji të duhur për ta ndjekur. Kështu, UNMIK-u mund të mohonte të drejtën për vetëvendosje, por nga ana tjetër nuk mund të krijonte situatë ose opsion që do të ishte ndonjë alternativë e zbatueshme. Si rrjedhojë, UNMIK-u dhe e gjithë bashkësia ndërkombëtare ndiqnin politikën e një "status quo-je" në lidhje me zgjidhjen e konfliktit dhe statusit të Kosovës, duke shpresuar se kërkesat për vetëvendosje dhe pavarësi mund të zëvendësoheshin me një shkallë të gjerë të vetëqeverisjes, si dhe prisnin që palët pas një kohe të ishin gati për një zgjidhje kompromisi. Strategjitë e UNMIK-ut lidheshin me plane veprimi, siç ishte Agjenda për bashkëjetesë e iniciuar nga Bernard Kouchner, pastaj Standardet para Statusit, si nismë nga Michael Steiner, për të përfunduar në Standardet për Kosovën të Harri Holkerit.

Megjithëkëtë, siç vëren edhe O'Neill (2002: 30) me të drejtë, pasiguria për statusin dhe të ardhmen e Kosovës minoi mundësitë për bashkëpunim mes dy komuniteteve, pasi që vetëm forcoi qëndrimet ekstreme të dyja palëve.

Me gjithë kritikën e shumta, jo rrallëherë edhe të arsyeshme, nuk duhet të anashkalohen edhe arritjet e Misionit të UNMIK-ut, sidomos gjatë viteve të para të ekzistimit. Por, cilat ishin arritjet e UNMIK-ut në të vërtetë? Së pari, ky mision ka arritur të krijojë paqen dhe stabilitetin, si parakusht të zhvillimit të jetës normale, sado që këtë mund ta cilësojmë si "paqe negative" (në kuptimin e Johann Galtung si mungesë e dhunës). Së dyti, ka arritur të ndërtojë dhe të konsolidojë institucionet administrative dhe qeverisëse të dala përmes procedurave demokratike, duke mundësuar legjitimitetin e autoriteteve vendore. Dhe së fundi, ka hapur rrugën për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Kështu UNMIK-u ishte në parim mision shtetndërtues pa e pranuar faktin se qëllimi final ishte pavarësia e Kosovës. Këtë paradoks Michael Ignatieff (2003) në librin 'Empire Lite' (Perandoria e butë) e quan "political science fiction" ose edhe më ashpër, me alegorinë absurde me virgjinitetin e një nëne. Paradoksi kryesor i këtij misioni qëndronte pikërisht te mungesa e strategjisë dalëse. UNMIK-u ishte konceptuar si një mision i përkohshëm, por sa duhet të zgjasë kjo dhe si duhet të përmbyllte misionin e vet nuk e kishte asnjëherë të qartë.

Bashkësia ndërkombëtare dhe UNMIK-u më shumë u angazhuan në formimin e institucioneve dhe demokratizimin, të cilat supozohej se do të zbusnin marrëdhëniet e tensionuara ndëretnike, dhe se kjo do mundësonte të zgjidhte çështjen e statusit në të ardhmen. Sidoqoftë, misioni i OKB-së në Kosovë së shpejti doli të ishte një mision i pamundur, sepse shumica e kosovarëve ishin thëllësisht të vendosur të krijonin shtetin e tyre të pavarur. Trazirat e 17 dhe 18 marsit të vitit 2004, të cilat ishin demonstrim i pakënaqësive me një gjendje të paqartë politike e të rëndë ekonomike, çoi në vdekjen e 18 qytetarëve të pafajshëm. Së shpejti u krijua një komision, i cili duhej të vlerësonte situatën e përgjithshme në vend dhe të raportonte për këtë në OKB. Raporti, i cili udhëhiqej nga norvegjezi Kai Eide, theksoi se ishte e nevojshme edhe koha e domosdoshme për të filluar procesin e zgjidhjes së

statusit të Kosovës. Më 24 tetor 2005, Këshilli i Sigurimit diskutoi gjetjet dhe rekomandimet e raportit, si dhe autorizoi fillimin e negociatave për zgjidhjen e statusit (Baliqi, 2009). Grupi i Kontaktit për Ballkanin (Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rusia, Franca, Britania e Madhe, Gjermania dhe Italia) miratoi udhëzimet të përbëra nga dhjetë pika dhe të cilat përcaktonin rregullat bazë, dhe kornizën e procesit të negociatave për statusin përfundimtar të Kosovës. Këto parime, ndër tjera, përfshinin që ndarja e Kosovës nuk vihet në konsideratë. Duke qenë të vetëdijshëm për këtë, Serbia synonte që brendapërbrenda Kosovës të krijonte njësi federale ose së paku entitete territoriale serbe, të cilat pastaj do të mund të pengonin pavarësimin ose të rrisnin presionin për ndarjen mbi baza etnike.

Negociatat u udhëhoqën nga i dërguari i posaçëm i OKB-së për Kosovën, ish-presidenti finlandez Martti Ahtisaari, zëvendës i tij ishte diplomati i lartë austriak Albert Rohan, të cilët vepronin në kuadër të zyrës e njohur si UN Office of the Special Envoy for Kosovo - UNOSEK, me seli në Vjenë. Kjo zyrë bashkëpunonte ngushtë me shtetet e Grupit të Kontaktit dhe autoritetet e tjera relevante si Këshilli i Sigurimit i OKB -së, NATO, Komisioni Evropian, etj. Në shkurt të vitit 2006, përfaqësuesit e Kosovës dhe Serbisë u takuan zyrtarisht për herë të parë në Vjenë për të diskutuar të ashtuquajturat çështje teknike. Temë e negociatave ishin të drejtat e pakicave dhe më pas çështja mjaft diskutabile e decentralizimit, përkatësisht krijimit të komunave të reja me shumicë serbe. Derisa delegacioni serb kërkonte krijimin e 17 komunave të reja me shumicë serbe, pala kosovare ishte e gatshme të krijonte 5 komuna dhe një këshill lokal për pjesën veriore të Mitrovicës. Pas disa muajsh negociatash intensive, një takim i nivelit të lartë u zhvillua më 24 korrik midis presidentit kosovar, Fatmir Sejdiu, kryeministrit Agim Çeku dhe presidentit serb, Boris Tadiq dhe kryeministrit Vojislav Koštunica. Pas më shumë se një viti negociatash në Vjenë, shtatëmbëdhjetë raunde bisedimesh dhe udhëtimesh të panumërta ndërmjetësimi (shuttle diplomacy), Ahtisaari dhe ekipi i tij hartuan një propozim për të zgjidhur çështjen e statusit. Më 2 shkurt 2007 iu prezantua Prishtinës dhe Beogradit "Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen Finale të Çështjes së Statusit të Kosovës" i njohur edhe si Plani i Ahtisaarit, i cili përmban një udhëzues të përgjithshëm në 62 faqe me gjithsej 14 artikuj dhe



dymbëdhjetë fusha kryesore, të titulluara si Annex. Plani i Ahtisaarit shmangte përkufizimin specifik të statusit, por në thelb parashihte një pavarësi të monitoruar ndërkombëtarisht, ku termi pavarësi nuk përdorej në mënyrë eksplicite. Edhe pse nuk specifikohesh si shtet sovran, Kosova do të kishte pothuajse të gjitha elementet e shtetësisë. Përveç një kushtetute të re, përfshinte të drejtën për të miratuar traktate dhe për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare, për të bërë politikën e jashtme, për të përdorur emblemat dhe himn shtetëror, dhe, mbi të gjitha, për të krijuar një ushtri nën emërtimin Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK). Megjithatë, për një fazë kalimtare Kosova do të monitorohej nga një mision i BE-së nga i ashtuquajtimi Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (International Civilian Representative - ICR).

Megjithëse plani u mirëprit nga pothuajse të gjitha palët si zgjidhja më e mirë, kompromis për zgjidhjen e statusit të Kosovës, ai nuk ishte në gjendje të kalonte në Këshillin e Sigurimit. Pas disa përpjekjeve për të zëvendësuar Rezolutën 1244 përmes një rezolute të re në Këshillin e Sigurimit dhe si rezultat i presionit nga vetoja e mundshme e Rusisë, bashkësia ndërkombëtare u detyrua të hapte negociatat të reja. Prandaj, zgjidhja e statusit duhej të vazhdonte të negociohej jashtë këtij organi dhe të ndërmjetësohej nga Grupi i Kontaktit përmes së ashtuquajturës Trojka e Kosovës (Baliqi, 2009). Ky grup negociator përbëhej nga përfaqësuesi i BE-së (Wolfgang Ischinger), ai i SHBA-së (Frank Wiesner) dhe i Rusisë (Alexander Bozhan-Chartchenko). Më 28 shtator 2007, bisedimet e drejtpërdrejta midis delegacioneve serbe dhe kosovare filluan në Nju-Jork. Negociatat duhej të përfundonin brenda një afati kohor prej katër muajsh dhe Trojka duhej t'ia paraqiste një raport përfundimtar sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki-moon, më 10 dhjetor të po atij viti. Këshilli i Sigurimit i OKB-së diskutoi raportin përfundimtar më 19 dhjetor dhe nuk ishte në gjendje të arrinte në një qëndrim të përbashkët mbi statusin e Kosovës. Rusia këmbëngulte në negociatat të mëtejshme, shtetet perëndimore refuzonin. Pasi të gjitha përpjekjet diplomatike ishin shteruar dhe mandati i "Trojkës" kishte përfunduar, Prishtina deklaroi se shpallja e njëanshme e pavarësisë tanimë nuk mund të përjashtohet. Pas përpjekjeve të gjata diplomatike për të gjetur një zgjidhje kompromisi dhe mbështetur nga shtetet e

BE-së, SHBA-së dhe shtete të tjera demokratike, Parlamenti i Kosovës shpalli Republikën e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran më 17 shkurt 2008. Sidoqoftë, periudha e “pavarësisë së mbikëqyrur”, ku sovraniteti iu delegua aktorëve ndërkombëtarë me prezencë në vend, u përmyll dhe tanimë udhëheqja politike dhe institucionet e Kosovës ishin plotësisht të pavarura dhe përgjegjëse për veprimet, sjelljet dhe rezultatet e tyre. Kjo ishte një sprovë aspak e lehtë për një shtet të ri, që u përball me kriza të njëpasnjëshme politike dhe lufatje në besueshmëri ndaj institucioneve qeveritare e sistemit të drejtësisë në vend. Sidoqoftë, siguria në Kosovë u përmirësua, rimëkëmbja e ekonomisë kishte përparim modest, ngritja institucionale dhe korniza ligjore u avancuan dukshëm dhe procesi i demokratizimit po hynte në një etapë të re zhvillimi.

## 8.4. Tranzicioni politik dhe demokratik

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës ka përmyllur një kapitull të gjatë të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, e karakterizuar nga luftërat brutale dhe dëmet e mëdha njerëzore e materiale. Në anën tjetër, Kosova si shtet i ri ka kaluar nëpër disa procese tranzicioni që prej përfundimit të luftës e deri më sot, për të ndërtuar struktura shtetërore dhe institucione demokratike. Kështu, kalimi nga një regjim komunist në sistem demokratik dhe shumëpartiak, nga një vatër lufte në një vend paqësor, nga një administrim ndërkombëtar në qeverisje vendore, si dhe nga një shoqëri e mbyllur dhe tradicionale në atë moderne e të hapur, ka bërë që zhvillimet politike në vend të jenë dinamike dhe me sfida të shumta. Bashkësia ndërkombëtare kishte ndërhyrë ushtarakisht në Kosovë për të ndalur dhunën sistematike të ushtruar nga regjimi i Serbisë. Përveç këtij qëllimi, Misioni i UNMIK-ut ishte vendosur në Kosovë për të krijuar institucionet e përkohshme vetëqeverisëse në Kosovë. Këto institucione përfshinin Parlamentin, Presidencën, Qeverinë dhe gjykatat e pavarura, si mekanizma që synonin krijimin e një shoqërie shumëpartake, paqësore dhe demokratike, nëse këto objektiva do të arriheshin nga lidhshipi politik, atëherë do të hapesh mundësia për zgjidhjen e statusit të Kosovës (Caplan, 2005).

Pas konstituimit të Republikës së Kosovës, Plani i Ahtisaarit kishte paraparë një fazë tranzitore prej 120 ditësh, pas së cilës institucionet vendore duhej të merrnin përsipër të gjitha kompetencat nga UNMIK-u, duke përfshirë ndërkohë edhe miratimin e Kushtetutës së Kosovës, sikurse që, në përputhje me mandatin kushtetues, institucionet pritej të kryenin funksione të reja tani shtetërore. Kjo paraqet edhe fazën përfundimtare të ndërtimit e konsolidimit të strukturave shtetërore, si dhe autorizimin e plotë të vendorëve të legjitimuar politikisht nga zgjedhjet e lira dhe demokratike. Kuvendi i Kosovës përbëhet nga 120 deputetë, me njëzet vende të rezervuara për pakicat dhe për një mandat prej katër vjetësh. Kapitulli i katërt i Kushtetutës rregullon të drejtat themelore, strukturën, procedurat dhe detyrat kryesore të Kuvendit të Kosovës, duke e vendosur atë si institucionin më të lartë dhe të zgjedhur drejtpërdrejt që përfaqëson popullin e Kosovës. Presidenti i Kosovës nuk zgjidhet drejtpërdrejt nga populli, por nga Kuvendi me shumicë votash prej dy të tretave nga deputetët, apo në raundin e tretë të votimit me shumicë të thjeshtë prej më shumë se gjysmës së deputetëve për një mandat pesëvjeçar, me mundësi të rizgjedhjes për vetëm edhe një mandat. Sipas Kushtetutës, presidenti i Kosovës përfaqëson unitetin e vendit dhe është kreu i shtetit. Presidenti ka kompetenca të gjera në shumë fusha, nga përcaktimi i politikës së jashtme, rreth sigurisë deri në emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Krahas formatit dhe mandatit të mëhershëm, Qeverisë së Kosovës iu shtua edhe Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe ajo e Mbrojtjes. Përveç këtyre, krijimi i Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Forcave të Armatosura, Bankës Qendrore dhe një varg institucioneve dhe agjencive të pavarura paraqesin përmbylljen e procesit formal të institucionalizimit dhe ndërtimit të shtetit. Ndërkaq menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë Bashkimi Evropian vendosi të dërgonte një mision të sundimit të ligjit për të siguruar mbështetje në fushën e gjyqësorit, Doganës dhe Policisë, të quajtur EULEX - me rreth 2.200 pjesëtarë. Se sa ia doli të forconte sundimin e ligjit me të vërtetë dhe çfarë bilanci mund të nxirret nga EULEX-i, si misioni evropian më i madhi dhe më i kushtueshmi, lë mjaft hapësirë për diskutim dhe vend për kritikë.

Me qëllimin e menaxhimit të tensioneve ndëretnike, në sistemin politik të Kosovës ekzistojnë elemente të demokracisë konsocionale (bashkëqeverisëse mes grupeve etnike), sipas së cilës vendime të caktuara, përshembull për çështjet e lidhura me komunitetet joshumicë, kërkohen jo vetëm nga shumica prej dy të tretave të deputetëve, por edhe midis përfaqësuesve të pakicave. Gjithashtu, ky model përfshin aranzhime për ndarjen e pushtetit ekzekutiv, kuotat etnike në gjykata, polici dhe administratë, dygjuhësinë zyrtare, të drejtën e vetos për çështje të caktuara dhe vetëqeverisjen në nivel lokal. Kushtetuta dhe legjislacioni përkatës ofrojnë një shkallë të gjerë autonomie pushtetit lokal, veçanërisht për komuna me popullsi joshumicë, në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, ekonomike, kulturore dhe fetare (Baliqi, 2019).

Sistemi partiak i Kosovës do të mund të klasifikohet si pluralizëm i moderuar, ku të gjitha partitë janë reciprokisht të hapura për koalicione për shkak se nuk janë shumë të polarizuara dhe nuk kanë mospërputhje të mëdha ideologjike, por më shumë të ndara në bazë të figurave të liderëve partiakë apo (pa) kënaqësisë me performancën e tyre qeverisëse. Partitë politike në Kosovë janë formuar më shumë si lëvizje popullore me kauzë kombëtare, sesa që kanë përfaqësuar shtresa ose klasa të caktuara shoqërore brenda sistemit politik. Ato janë më shumë si grupe të lidhura fillimisht rreth liderit dhe në baza regjionale, me objektiv kryesor pavarësimin e Kosovës, pa ndonjë program të duhur qeverisëse dhe platformë të mirëfilltë elektorale (Baliqi, 2013). Me kalimin e viteve dhe pas çdo palë zgjedhesh, skena politike pësoi ndryshime të shumta si për nga fuqia elektorale dhe pushteti ashtu edhe nga lidhshipi e programet.

Kosova ka një sistem shumëpartiak dhe një model zgjedhesh të sistemit të përfaqësimit proporcional, nga të cilat dalin përfaqësuesit politikë për një mandat katërvjeçar. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 45 i përcakton parimet themelore të zgjedhjeve, të drejtës së votës dhe të pjesëmarrës në zgjedhje. Zgjedhjet në nivel lokal zhvillohen çdo katër vjet për të përzgjedhur asamblistët për Këshillin Komunal me sistem proporcional si dhe kryetarin e komunës, i cili duhet të fitojë sipas parimit mazhoritar mbi 50% të votave, në të kundërtën shkohet

në raundin e dytë ose në balotazh mes dy kandidatëve me më së shumti vota. Për herë të parë Kosova mbajti zgjedhjet për pushtetin lokal më 28 tetor të vitit 2000. Pjesëmarrja e votuesve ishte mjaft e lartë, respektivisht 79% dhe, meqë ishin zgjedhjet e para pas luftës dhe procesi zgjedhor relativisht i qetë, u konsideruan si zgjedhje të suksesshme. Mirëpo, mungesa e dokumenteve identifikuese të votuesve, të listës zgjedhore të mirëfilltë, fletëvotime të komplikuar, si dhe incidente gjatë fushatës elektorale dhe procesit zgjedhor, lënë vend për dyshime në rregullshmërinë e plotë të tyre. Pjesëmarrja që nga zgjedhjet e para ka shënuar rënie të vazhdueshme, por procese më të qeta e të rregullta gjithsesi. Pragu zgjedhor, i cili është 5%, ka bërë që një numër i subjekteve politike të shuhen apo t'u bashkohen subjekteve të tjera. Partia ORA në zgjedhjet e vitit 2007 nuk e kishte kaluar pragun zgjedhor. Pragu i lartë do ta nxjerrë jashtë kuvendit edhe LDD-në në zgjedhjet e përgjithshme të 2010-s. Në zgjedhjet e përgjithshme të 2014-s, AKR-ja u ballafaqua me të njëjtin fat, duke mbetur parti jashtëparlamentare, sikurse edhe Nisma në zgjedhjet parakohshme të vitit 2021, duke mos llogaritur këtu edhe nisma e lista qytetare të shumta, të cilat pas një kohe u shuan. Pakënaqësitë me udhëheqësin, skandalet korruptuese, nepotizmi dhe mungesa e demokracisë brendapartiake kanë bërë që disa subjekte politike të fragmentohen dhe të ketë kalime të shpeshta të anëtarëve e funksionarëve nga një parti në tjetrën. Demokratizimi i Kosovës është i lidhur ngushtë me vetë demokratizimin e partive politike, që kjo të arrihet, nevoja për kuadro politike me integritet, sistem zgjedhor me përfaqësues kompetentë dhe votues më kërkues është e domosdoshme. Prandaj sistemi politik i Kosovës është në proces e sipër të konsolidimit demokratik, sikurse edhe të emancipimit politik të votuesve.

Derisa shtetformimi, siç u përshkrua më sipër, përshkon një rrugëtim mjaft të gjatë historik dhe përfshin transformime socio-politike, ndërtimi i shtetit në shoqëritë e pasluftës përmes një misioni të përkohshëm administrativ bëhet brenda një kohë shumë të shkurtër dhe në rrethana tejet të brishta e veçanta. Së këndejmi edhe konsolidimi dhe funksionimi i mirëfilltë i institucioneve shtetërore, por edhe niveli i demokracisë është vështirë të krahasohet me ato shtete, të cilat i kanë

këto mirë të etabluara dhe një shoqëri që i mirëmban e i zhvillon ato tutje. Shteti kosovar në këtë aspekt ka ende mjaftë punë për të bërë dhe hapësirë për t'u përmirësuar, për këtë arsye edhe zhvillimi i duhur politik u paraprin zhvillimeve të tjera e të gjithmbarshme në vend.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në procesin e shtetformimit lidhet me njohjet ndërkombëtare dhe anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, përfshirë me këtë edhe anëtarësimin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në NATO dhe në BE. Fakti që pas më shumë se një dekade pavarësie çështja e njohjes së Kosovës mbetet çështje e papërfunduar, paraqet sfidën kryesore të politikës së jashtme të Kosovës. Arsyet kryesore për ngecjen e njohjeve dhe të mosanëtarësimin në organizata ndërkombëtare janë konstelacionet gjeopolitike të pafavorshme, veçanërisht të pozicionit kundërshtues të Serbisë, Rosisë, Kinës dhe të disa shteteve të tjera të fuqishme. Megjithatë, argumentet politike, etike dhe juridike në favor të njohjes së Kosovës dhe pranimit në organizatat ndërkombëtare, si dhe potenciali i saj diplomatik janë më të mëdha sesa që janë shfrytëzuar nga politika e jashtme sa duhet.

Sidoqoftë, deri më tani (2021) Kosova është njohur nga 117 shtete, është anëtarësuar në më shumë se njëzet organizata ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe ka nënshkruar marrëveshje të shumta ndërkombëtare, siç është Marrëveshja për Stabilizim-Asociim me Komisionin Evropian etj. Po ashtu shërbimi diplomatik i Kosovës aktualisht operon në mbi tridhjetë ambasada dhe rreth njëzet misione konsullore në të gjithë botën, si dhe me dy zyra ndërlidhëse. Edhe pse Kosova i plotëson kriteret formale dhe normative të kërkuara për njohje dhe anëtarësim në shumicën e organizatave ndërkombëtare, pjesa e argumentimit politik dhe shkathtësisë diplomatike mbeten vendimtare në arritjen e njohjeve dhe të anëtarësimin në këto organizata. Politika e jashtme e Kosovës duhet të fokusohet si në krijimin e marrëdhënieve dypalëshe me shtetet që nuk e njohin Kosovën, ashtu edhe në forcimin e aktiviteteve shumëpalëshe në samitet, forumet dhe organizatat ndërkombëtare. Këto dy fushëveprime janë komplementare, kështu që nuk ka sukses në marrëdhëniet multilaterale pa përmirësime

bilaterale, sikurse edhe anasjelltas. Ashtu si integrimi në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi në NATO që janë të interesit nacional për Kosovën, ashtu edhe anëtarësimi në OKB duhet të jetë prioritet kryesor i politikës së jashtme. Në një konfigurim gjeopolitik gjithnjë e në ndryshim, Kosova nuk e ka luksin të presë pafundësisht në këtë drejtim. Sepse përderisa Kosova nuk arrin të anëtarësohet në OKB, me të drejta të plota, shtetësia e saj nuk mund të konsiderohet plotësisht e përmbyllur.

## 9. Formimi i identitetit kosovar

Pas shpalljes së Pavarësisë në shkurt 2008, Qeveria e Kosovës filloi me lëshimin e letërnjoftimeve, pasaportave, patentë shoferëve dhe dokumenteve tjera të reja me emblema shtetërore. Fushata informuese dhe vetëdijesuese që e shoqëroi këtë ishte nën parullën afirmative “Tash kam një identitet”. Pas më shumë se një dekade që nga atëherë, shtrohet ende pyetja kundërthënëse: A kanë vërtet kosovarët identitet? Dhe nëse po, çka e përbën atë dhe në çfarë bazohet? Çështja e përkatësisë dhe identitetit kolektiv, siç edhe u shtjellua në kapitujt paraprakë, është një nga çështjet më të ndërlikuara, dhe në shumë aspekte më së paku të diskutuara me të cilat ballafaqohen shoqëritë e pasluftës. Qarqet akademike dhe literatura shkencore, nga ana tjetër, merren kryesisht me sfidat institucionale dhe strukturore të shtetit, duke anashkaluar çështjen që lidhet me vetë bartësit dhe identitetin e tyre përkatës. Ishin pikërisht ngjarjet dramatike dhe luftërat në Ballkan që shpërfaqën tragjikisht shkallën në të cilën përkatësia etnike apo kombëtare, e kuptuar në mënyrë rigoroze e përjashtuese, mund të keqpërdoret për mobilizime politike dhe nxitje të urrejtjes ndaj të tjerëve. Pasojat e kësaj etnonacionalizmi e shovinizmi thuhet askush më shumë se vetë populli i Kosovës nuk kanë përjetuar gjatë dekadave të kaluara. Prandaj, një temë e tillë është tejet e ndjeshme dhe në trajtim të gjerë ndërthuret me kundërthënie të shumëllojshme.

Një debat publik dhe mjaft kundërthënës mbi çështjen e identitetit u zhvillua në vitet e para pas luftës në javoren “Java”, ku shumë intelektualë dhe politikanë të Kosovës u shprehën skeptikë apo edhe kundërshtues ndaj idesë së zhvillimit të identitetit kosovar. Nga ana tjetër, disa intelektualë të tjerë në komentet e tyre kanë mbrojtur konceptin e një bashkësie të veçantë politike e mbi-etnike. Sidoqoftë, në këto polemika kishte ngjyrimet politike e qëndrime të njëanshme ideologjike dhe pak e hiç argumentime shkencore dhe diskutime akademike. Edhe në vitet e mëvonshme rreth kësaj çështjeje vazhduan debatet e shumta, të cilat u zhvilluan kryesisht në studiot televizive apo nëpër portale.



Në mesin e studiuësve të huaj që trajtuan këtë çështje kishte njëlloj entuziazmi për ndërtimin e paqes përmes transformimit të marrëdhënieve ndëretnike e qëndrimeve etnonacionaliste në një identitet multi-etnik kosovar. Kështu antropologu norvegjez Aasmund Andersen (2002) në tezën e tij të doktoratës shtjellonte këtë hipotezë duke theksuar që identiteti kosovar ka potencialin për të kapërcyer politikën e përhapur etnonacionaliste në Kosovë, fillimisht te shqiptarët, por në afat më të gjatë edhe te serbët dhe pakicat e tjera. Një linjë të ngjashme argumentimi kishte edhe studiuesi Simonsen (2004), i cili vinte në pah rëndësinë e krijimit të një identiteti kosovar, i cili jo vetëm se do të tejkalonte ndasitë etnike dhe do të siguronte paqen e qëndrueshme, por që do të ishte i domosdoshëm në procesin afatgjatë të shtetformimit. Ndërsa eksperti i mirënjohur për Ballkanin, Janusz Bugajski, (2002) në një kumtesë të hershme dallonte tri variante apo ide të ndryshme rreth identitetit kosovar. Në variantin e parë ky identitet nënkupton një pjesë të mëtejshme dhe ndoshta rajonale të identitetit kombëtar shqiptar. Në trajtën tjetër mund të shihet si identitet i veçantë (shqipfolës) kombëtar. Kuptimi i tretë i identitetit kolektiv kosovar dhe i preferuar nga Bugajski nuk është përcaktimi i tij sipas përkatësisë etnike, por nga marrëdhënia e besnikëria e qytetarëve me shtetin. Vlen të theksohet që me gjithë interesimin e madh vendor e ndërkombëtar, rreth kësaj çështjeje deri më tani ka pak kërkime shkencore të bazuara në të dhëna empirike. Ndër hulumtime të pakta empirike prej nga mund të merren të dhëna është nga anketa e vitit 2016, bërë nga instituti "Kipred", pak a shumë në stilin e pyetësorit të Morenos me të cilën bëhet matja e shkallës së vetëperceptimit. Në pyetjen: "Cila nga këto kategori ju përshkruan më mirë se si ndiheni?", 44 për qind të respondentëve u përgjigjën më shumë shqiptarë se kosovarë, 32 për qind më shumë kosovarë se shqiptarë, 17 vetëm si shqiptarë dhe 7 për qind vetëm si kosovarë. Sigurisht, këto të dhëna lëvizin me kohë dhe kërkojnë interpretim më krahasues dhe gjithëpërfshirës.

Ngjashëm sikur tek qasjet e nacionalizmit, edhe rreth identitetit kolektiv bëhet dallimi midis koncepteve esenciale (ose primordiale) dhe konstruktive. Derisa te qasja e parë identitetet lidhen me elemente esenciale kulturore si; zakonet, simbolet, gjuha dhe historia

e përbashkët, në konceptimin konstruktiv identitetet shihen si rezultat i zhvillimeve politike e shoqërore, si dhe lidhen me perceptimin e vetes dhe të tjetrit. Në këtë kontekst rezultatet e deritanishme të shtetformimit paraqesin një bazë të rëndësishme për përkatësinë politike dhe unitetin shoqëror, dhe politika e identitetit është jetike në procesin e shtetndërtimit. Procesi i formimit të shteti varet në masë të madhe nga identitetet kolektive të përfshira në të, sikurse edhe vetë politika e identitetit që zbatohet nga shteti. Identiteti kolektiv vjen në konsideratë nga disa karakteristika që pjesëtarët e tij i kanë të përbashkëta, siç janë trupi apo uniteti politik, por edhe gjuha, e kaluara historike e kujtesa kolektive (Smith, 1991). Derisa për atributin e parë mund të thuhet se kosovarët janë në konsolidim e sipër, elementet e tjera përbërëse të identitetit shumica dërrmuese i ndajnë me shqiptarët e tjerë jashtë Kosovës. Kjo nënkupton që sa i përket çështjes së identitetit kemi dy tendenca kundërtë, në njërin anë të vetëperceptimit e manifestimit kulturor, historik, simbolik, ideologjik e sentimental të përkatësisë kombëtare shqiptare, dhe, në anën tjetër, të përpjekjes institucionale e kushtetuese për të formësuar një identitet shtetëror e politik që shkon përtej përkatësisë etnike. Ky është një proces i cili varet nga marrëdhënie, faktorë dhe rrethana të shumta, e të cilat në këtë stad të zhvillimit vështirë se mund të parashikohen. Gjithsesi, dilema nuk duhet të jetë në atë se a ekziston apo jo identiteti kosovar, por çfarë identiteti po krijohet dhe cilat janë veçoritë e tij krahasuar me identitetet e tjera? Ky identitet nuk do të thotë të jetë kombëtar, në kuptimin e atyre të krijuara historikisht e kulturalisht, por shtetëror, si bazë e konsolidimit të një qytetarie apo bashkësie politike pa të cilën shtetet nuk mund të funksionojnë mirëfilli.

Një nga sfidat më të mëdha për shoqëritë e pasluftës është pikërisht formimi paralel i shtetit dhe i kombit, i cili mund të jetë i vështirë dhe mjaft sfidues. Në këtë kontekst autorë të spikatur, siç janë Dobbins, Fukuyama, Chesterman etj., theksojnë se rimëkëmbja e suksesshme e Gjermanisë dhe Japonisë ndodhi kryesisht sepse të dy shtetet përfaqësonin identitet të konsoliduar kombëtar si dhe lojalitet e legjitimitet të fortë shtetëror, si parakusht për stabilitet dhe zhvillim. Në të vërtetë, me krijimin e institucioneve e të strukturave shtetërore dhe me procesin e demokratizimit në Kosovë u krijua bazamenti për

emancipimin politik dhe zhvillimin e identitetit kosovar. Me shpalljen e Pavarësisë dhe miratimin e Kushtetutës u vendosën bazat normative për zhvillimin e një bashkësie ose trupi politik e shtetëror. Në nenin e saj të parë Kushtetuta përkufizon Republikën e Kosovës si shtet në pronësi të qytetarëve të saj. Pra, nuk është përkatësia etnike në rend të parë, por ajo qytetare, që shërben si element përbërës i sovranitetit popullor. Më tutje Kushtetuta nënvizon se: “Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore.” (Kushtetuta e Kosovës, 2008).

Sidoqoftë, kjo çështje më tepër diskutohet si debat partiak e politik, ndërkohë që një qasje gjithëpërfshirëse e bazuar në shkencë ende mungon. Arsyet për këtë janë marrëdhëniet e tensionuara ndëretnike, mungesa e ballafaqimit me të kaluarën dhe aranzhimet konsocionale për ndarje etnike të pushtetit. Një pengesë shtesë është gjendja e rëndë socio-ekonomike, si dhe krizat e legjitimitetit të qeverive të ndryshme (humbja e besueshmërisë tek elita dhe sistemi politik për shkak të keqpërdorimeve e korrupsionit), të cilat dëmtojnë lojalitetin dhe legjitimitetin e qytetarëve ndaj shtetit. Prandaj shpeshherë trajtimi i çështjes së identitetit kosovar refuzohet me arsyetimin banal se paraqet rrezik dhe tradhti ndaj “kauzës” kombëtare. Në fakt, këtu ne do të mundohemi të bëjmë një skicim sa më gjithëpërfshirës të procesit, duke u munduar që lexuesit të analizojnë vetë më mirë këtë, si dhe të krijojnë një pasqyrë më të qartë rreth kësaj çështjeje, duke mos paragjykuar apo konstatuar pa e parë tablonë e gjerë dhe për të kuptuar ndikimet rrethanore. Një vështrim më i afërt në procesin e formimit të identitetit na shtyn që të dallojmë tri faza themelore të zhvillimit, të cilat edhe do t’i shtjellojmë në vijim.

## 9.1. Procesi i formimit të identitetit

Edhe pse Kosova ka një histori të gjatë, si një entitet me institucionet e veta dhe me profil kulturor, ekonomik dhe politik të formuar prej tyre, megjithatë nuk është edhe aq e vjetër. Vetëm në fund të viteve 1960 filluan reformat e mirëfillta në pothuajse të gjitha fushat e sektorët publikë. Gjatë kësaj faze kishte zhvillim të hovshëm ekonomik, industrializim dhe urbanizim, të cilat ndryshuan mënyrën tradicionale të jetesës në mesin e popullatës duke e modernizuar në mjaft aspekte. Me Kushtetutën e vitit 1974, Kosovës iu dha statusi i një krahine vetëqeverisëse dhe kishte Kushtetutën, Parlamentin, Gjykatën Supreme, struktura administrative dhe organe ekzekutive, si dhe Polici dhe njësi të së ashtuquajturës mbrojtje territoriale. Gjithashtu, gjuha shqipe ishte tanimë e barabartë me atë serbokroate në përdorim zyrtar dhe lejohej të përdorej flamuri kombëtar shqiptar.

Gjatë kësaj periudhe u rrit vetëbesimi kulturor dhe politik i kosovarëve, i cili kulmoi me themelimin e Universitetit të Prishtinës, të Akademisë së Shkencave dhe Arteve dhe institucioneve të tjera kulturore, edukative e shkencore. Sidomos në art, letërsi, muzikë, në shkenca, si dhe në fushat e kulturës dhe arsimit pati ngritje të konsiderueshme. Shkalla e analfabetizimit u ul nga 94% (para viteve 1950) në rreth 30% në vitet 1970 (Clark, 2000: 35). Ndërsa numri i studentëve në Universitet të Prishtinës shumë shpejt arriti në 30.000 (Malcolm, 2001: 331). Mirëpo, demonstratat studentore të vitit 1981 dhe shtypja e dhunshme e tyre, me pasoja politike dhe profesionale për intelektualët e rinj, pati ndikim në organizimin e mëvonshëm të lëvizjeve politike. Situata politike në Kosovë gradualisht u përkeqësua, veçanërisht pas ardhjes në pushtet të regjimit të Slobodan Miloševićit dhe suprimimit të autonomisë së Kosovës.

Faza e dytë mund të përmblihet me togfjalëshin rezistencë dhe luftë për liri, andaj shumë fëmijë të lindur gjatë kësaj kohe bartin emra si: Qëndresa, Qëndrim, Liridon, Fitore, Çlirim etj. Në kohën e rezistencës paqësore kundër represionit serb në vitet 1990 kishte një unitet politik rreth kauzës e aspiratës për shtet dhe vetëdija kolektive për këtë u rrit dukshëm, figura si Adem Demaçi, Ukshin Hoti dhe aktorë të tjerë politikë ishin kritikë ndaj kësaj qasjeje.

U krijua një lloj solidariteti i papërshkueshëm dhe ndjenjë e fortë bashkimi brenda së cilës çlirimi i Kosovës ishte mision i shenjtë dhe qëllimi përfundimtar i çfarëdo veprimi. Kjo ndjenjë e përbashkësisë, të cilën Weber e quante *Zusammengehörigkeitsgefühl*, ishte e lidhur me vlerat e normat tradicionale, me rezistencë jo të dhunshme dhe, mbi të gjitha, me zgjidhjen e çështjes kombëtare. Për më tepër, identiteti kolektiv e politik u formua nga kufizimi i shumanshëm nga komunitetet e tjera, kryesisht dhe në rend të parë nga ai serb.

Më pas lufta çlirimtare e UÇK-së kundër trupave serbe dhe përgjithësisht përjetimet e luftës në Kosovë luajnë rol themelor në historinë moderne të vendit, në kujtesën kolektive, në ligjërimin publik dhe në mobilizimin politik, dhe kështu edhe në politikën e identitetit. Kujtimi i ngjarjeve dhe heronjve të luftës gjithashtu manifestohet edhe në hapësirën publike në formën e monumenteve, emra rrugësh dhe të institucioneve publike si shkolla, stadione, aeroporti etj. Kështu periudha pas çlirimit paraqet etapën e re të vetëdijesimit dhe zhvillimit politik e social. Ndërsa me shpalljen e Pavarësisë procesi i krijimit të identitetit mori një dimension krejt të ri, duke u nisur gradualisht të institucionalizohet. Në këtë aspekt shtetësia e Kosovës mundësoi demokratizimin e mëtejshëm dhe krijimin e një uniteti politik dhe të një kulture më të theksuar institucionale, të cilat krijojnë parakushtet thelbësore për politikën e identitetit shtetëror, një politikë e tillë e identitetit deri më tani është avancuar pak nga udhëheqësit dhe më pak është diskutuar në qarqet akademike në Kosovë. Përkundrazi, çështja e identitetit vazhdon të trajtohet kryesisht nga qëndrimet përjashtuese e stigmatizuese dhe nga diskursi në thelb romantik.

## 9.2. Dimensionet e formimit të identitetit

Për diskutimin rreth formimit të identitetit politik shtetëror në Kosovë tri lloj marrëdhëniesh ose dimensione përkatëse janë të një rëndësie të veçantë. Dimensioi i parë ka të bëjë me natyrën e marrëdhënieve që kanë dhe do të kenë në të ardhmen shqiptarët e Kosovës me shqiptarët e tjerë në rajon, si në Shqipëri, Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi. Këto marrëdhënie zhvillohen në mënyrë dinamike dhe përcaktohen gjithashtu nga strukturat e brendshme të pushtetit politik dhe interesat e tyre, si dhe nga ndikimi i faktorëve të jashtëm (ndërkombëtar dhe

/ose rajonal). Në përgjithësi mund të thuhet se zhvillimet politike në vitet dhe dekadën e fundit kanë çuar në një diferencim në rritje të identiteteve rajonale (territoriale) midis shqiptarëve. Këtë lloj diferencimi e kishte parasysh edhe antropologu francez Gille de Rapper (1998), i cili theksonte se për shqiptarët e Shqipërisë, ata nga Kosova paraqesin “të tjerët”, prandaj edhe fakti që përdorin dy lloj etnonimesh të ndryshme, për vete shqiptarë dhe tjetrën për kosovarë, është indikativë për këtë dallim. Edhe albanologu Peter Schubert (2003) në një studim të hershëm mbi këto marrëdhënie vuri në dukje zhgënjimin nga ana e kosovarëve për kushtet e rënda ekonomike dhe për pamundësinë e Shqipërisë që t’i përkrahë ata më fuqishëm në çështjen e Kosovës.

Nga ana tjetër, bashkëpunimi shoqëror, kulturor, ekonomik dhe politik midis shqiptarëve në rajon viteve të fundit është intensifikuar më shumë se kurrë më parë. Infrastruktura rrugore midis trevave shqipfolëse, e përmirësuar dukshëm viteve të fundit, si dhe mundësitë teknologjike për komunikim, ka forcuar lidhjet dhe mundësitë e ndërveprimit dhe bashkëpunimit në shumë mënyra. Në kulturë, sport, arsim dhe fusha të ngjashme është krijuar një audiencë e përbashkët dhe është zhvilluar një sferë publike thuajse e integruar. Bashkëpunimi ekonomik gjithashtu është shumëfishuar, veçanërisht në tregti dhe turizëm. Autoudha midis Kosovës dhe Shqipërisë jo vetëm që përcjell një mesazh të caktuar politik me emrin e saj simbolik “Rruga e kombit”, por gjithashtu ka shtuar konsiderueshëm komunikimin dhe bashkëpunimin. Ndërkaq edhe autoudha, e cila ka lidhur Prishtinën dhe Shkupin, jo vetëm që mundësoi trafik më të shpejtë midis këtyre shteteve fqinje, por gjithashtu përmirësoi ndjeshëm lidhjet midis shqiptarëve të dy vendeve. Ky lloj përafrimi në rritje midis shqiptarëve në rajon ndikon veçanërisht në mesin e të rinjve, në një bashkim kulturor më të fortë dhe në një manifestim shpesh sentimental të etnonacionalizmit. Kështu, në një hulumtim të opinionit rreth raportit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, në pyetjen rreth bashkimit kombëtar, 63% e të anketuarve në Shqipëri dhe 54% e të anketuarve në Kosovë deklarohen se dëshirojnë që bashkimi kombëtar të realizohet, kurse vetëm 23% e shqiptarëve të Shqipërisë dhe 17% e atyre të Kosovës besojnë se një gjë e tillë është edhe e mundshme (KFOS/OSFA, 2019).

Kështu shtrohet pyetja nëse marrëdhënia e shqiptarëve të Kosovës me Shqipërinë do të zhvillohet në mënyrë të ngjashme me atë të pakicave dhe grupeve etnike në Ballkan si një lloj "atdheu" i tyre etnik dhe ideologjik. Apo, në analogji me raste tjera të ngjashme, shtrohet pyetja: A do të korrespondojë ky identitet kosovar me vetëperceptimin e sotshëm austriak si të pavarur karshi atij gjerman - ose ndoshta më shumë si një lloj versioni "gjermano-lindor" brenda një kombi të përbashkët shqiptar? Është herët për të prognozuar se si do të zhvillohen këto marrëdhënie në të ardhmen dhe si do të ndikojnë këto në vetëperceptimin e kosovarëve. Sidoqoftë, nëse do të formohet dhe konsolidohet identiteti kosovar, si i veçuar nga përkatësia etnike, shqiptarët e Kosovës, si shumicë dërrmuese dhe forcë politike mbizotëruese, pa dyshim që do të ishin bartësit apo titullarët e tij.

Aspekti i dytë ka të bëjë me marrëdhënien e serbëve të Kosovës me Serbinë dhe gatishmërinë për ta pranuar Kosovën si shtetin e tyre, për t'u integruar në bashkësinë politike dhe në këtë mënyrë për të kontribuar në zhvillimin e identitetit shtetëror. Edhe pse serbët e Kosovës përmes vetëqeverisjes lokale dhe sipas modelit konsocional të ndarjes së pushtetit marrin pjesë në Qeveri, Kuvend dhe përgjithësisht në institucionet e Kosovës, qëndrimet e tyre politike vazhdojnë të diktohen nga politika armiqësore e Beogradit karshi shtetësisë së Kosovës në pothuajse të gjitha sferat e jetës. Në këtë mënyrë gatishmëria e serbëve të Kosovës për t'u bërë politikisht të pavarur dhe për t'u integruar pengohet dhe parandalohet në mënyrë të vazhdueshme nga Beogradi zyrtar. Në krahasim prej komunitetit serb, komunitetet e tjera, si: turk, boshnjak, goran, rom e ashkali, janë të kyçur tërësisht në shoqëri dhe institucione shtetërore duke kontribuar kështu për zhvillimin e identitetit qytetar kosovar.

Një aspekt i tretë dhe thelbësor i çështjes së identitetit ka të bëjë me rolin dhe ndikimin e mërgatës kosovare. Ky dimension është gjithashtu shumë i rëndësishëm jo vetëm për nga numri i lartë i tyre, me ç'rast vlerësohet të jetë më shumë se një e treta e popullsisë së përgjithshme, por edhe nga ndikimi i madh politik, social, kulturor dhe ekonomik që kanë në vend. Marrëdhënia midis diasporës dhe Kosovës, veçanërisht ndikimi i tyre në politika të identitetit, ndodh në shumë sfera dhe

mënyra, nga lidhjet e ngushta familjare e miqësore deri te shkëmbimet e ideve, vlerave dhe ndikimi i emigrantëve të suksesshëm kosovarë si shembuj për t'u ndjekur. Po ashtu, përvojat e mërgatës në proceset e integritimit kulturor e social në vendet ku jetojnë, sikurse shpesh ballafaqimi me çështje të identiteteve të shumëfishta (shtetësi, kombësi, gjuhë etj.,) i bën ata një kategori edhe më të veçantë në këtë aspekt.

Ajo që të tri dimensionet kanë të përbashkët është se një ballafaqim me të kaluarën dhe proces pajtimi mund të ketë një efekt pozitiv në këto dimensione përmes përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe një raporti më pozitiv e më të shëndoshë me shtetin. Në këtë kontekst ka mendime edhe të tilla që, me konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të shtetit kosovar, të krijohet një lloj nacionalizmi kosovar që do të përfshinte të gjitha komunitetet etnike (Andersen, 2002:177). Sidoqoftë, një "kombformim" i tillë mbi bazën "subjektive" (por kurrsesi jo "objektive" sipas kriterëve të gjuhës, etnisë etj.) nuk mund të vërehet akoma. Në rrethanat ekzistuese një gjë e tillë vështirë se mund të pritët. Sepse përkatësia etnike, si dhe ajo gjuhësore, fetare dhe kulturore janë ende attribute vendimtare për identifikimin e shumicës dërrmuese të banorëve dhe me gjasë do të mbeten të çimentuara për aq kohë sa nuk mund të transformohen nga ndonjë identitet tjetër, ekonomikisht më tërheqës dhe politikisht më i lidhur me shtetin. Ky do të jetë proces i gjatë dhe jo linear që do të përballet me probleme të ngjashme me të cilat, në parim të gjitha shtetet e sapokrijuara i kishin në fazat e tyre fillestare të konsolidimit.

Identitet i synuar shtetëror nuk nënkupton humbjen e identiteteve ekzistuese etnike ose kulturore të komuniteteve, siç Ingimundarson e shpjegon me të drejtë në shembullin e shqiptarëve: "Ndërsa ata mund të identifikohen në aspekt kulturor me shqiptarët e Shqipërisë, si dhe me ata të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë jugore, entiteti i tyre politik duhet të përcaktohet në nocionin territorial të Kosovës." (Ingimundarson, 2007: 115). Për më tepër, ky identitet politik nuk zëvendëson kulturat dhe vetëdijen kombëtare, por thekson konceptin e identitetit të përbërë përtej ndjenjës dhe përkatësisë kombëtare.



Nga ana tjetër, shtetet përbëjnë dhe formojnë identitetet e subjekteve politike si autoriteti i vetëm legjitim, sepse vetëm përmes identitetit shtetëror mund të arrihet legjitimiteti politik dhe ndjenja e përkatësisë në një bashkësi politike.

Për të sqaruar më hollësisht politikën e identitetit në Kosovë, një vështrim në simbolet shtetërore dhe ndërthurjen e tyre me qytetarët, si dhe çështjen e shtetësisë (si në kuptim legal edhe në atë identitar) do të shtjellohen më tutje.

### 9.3. Simbolet e Kosovës

Simbolet janë elemente përbërëse të identitetit kolektiv dhe njëkohësisht janë mjete ndihmëse për identifikim. Një shtet dhe një komb përfaqësohen nga simbolet e tyre shtetërore përkatësisht kombëtare, të cilat e bëjnë shtetin dhe kombin “të prekshëm” në mënyrë simbolike dhe emocionale, si dhe u mundësojnë qytetarëve ta pranojnë dhe manifestojnë përkatësinë e tyre. Kështu në këtë kuptim studiuesja e shquar e nacionalizmit Monserrat Guibernau (1996: 81) nënvizon: “Simbolet jo vetëm që flasin për diçka ose përfaqësojnë diçka tjetër, ato gjithashtu ua mundësojnë atyre që i përdorin t’u japin njëfarë kuptimi, duke mos u imponuar njerëzve ‘kufizime në kuptimin e njëtrajtshëm.’”

Prandaj, komponentët simbolikë të identitetit kanë edhe qëllime funksionale, ata afrojnë, identifikojnë dhe bashkojnë anëtarët e “vet” kundrejt “të tjerëve”, të cilët përkufizohen e dallohen përmes simboleve të tjera. Në rrethana e raste të caktuara, simbolet janë të lidhura ngushtë me mitet kombëtare, kujtesën kolektive dhe narrativen nacionaliste duke shërbyer shpesh si pjesë përbërëse e veprimeve politike dhe objektivave ideologjike. Mund të supozohet se kjo ishte edhe njëra ndër arsytet se përse Plani i Ahtisaarit në nenin 1, pika 7, përcaktonte simbolet që do të zgjidheshin se nuk duhej të korrespondonin me ato të mëparshmet dhe as me ndonjë model të zakonshëm të komuniteteve etnike. “Kosova do të ketë simbolet e veta të veçanta nacionale, duke përfshirë flamurin, stemën dhe himnin, të cilët pasqyrojnë karakterin e saj shumetnik.”

Përpjekjet për të krijuar simbolet shtetërore për Kosovën nuk kanë munguar as në kohën para Planit të Ahtisaarit. Bie fjala, presidenti i parë i Kosovës, Ibrahim Rugova, paraqiti një flamur dhe himn shtetëror në një konferencë për shtyp në tetor të vitit 2000. Ai këtë e arsyetonte me nevojën që Kosova të ketë simbolet e veta shtetërore me të cilat edhe do të anëtarësohej në OKB. Sikurse që me këtë flamur ruhen elementet kombëtare të vendit (Schubert, 2003). Flamuri përmbante shqiponjën dykrerëshe në një rreth të kuq dhe në një sfond të kaltër me përshkrimin “Dardania” në mes. Me gjithë ngjashmëritë e pjesshme me ikonografinë shqiptare, këto simbole nuk u pranuan nga aktorët e tjerë politikë, si dhe nga publiku nuk u mirëpritën aq. Prandaj ato nuk arritën të viheshin në zbatim të gjerë, edhe pse vazhduan të përdreshin në raste të caktuara si simbol i presidentit dhe i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Më vonë Shërbimi Policor i Kosovës, i cili që nga shtatori 1999 u krijua nën patronazhin ndërkombëtar, ishte institucioni i parë që paraqiti një simbol që ishte vërtet i lidhur me Kosovën (domethënë hartën territoriale), dhe që mund të ishte e pranueshme për të gjitha grupet etnike. Pastaj edhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), që u formuan nga demilitarizimi i UÇK-së, si dhe shumë institucione dhe autoritete të tjera “vetëqeverisëse” gjatë administrimit të UNMIK-ut e përdorën këtë më pas në stemën apo simbolet e tyre.

Në qershor të vitit 2007, Kuvendi i Kosovës vendosi të hapte një konkurs ndërkombëtar për të hartuar simbolet e shtetit (flamurin dhe stemën). Kushtet e konkursit ndoqën kriteret e përcaktuara në Planin e Ahtisaarit: përmbajtja e simboleve nuk u lejua të ishin identike apo edhe të ngjanin me simbolet kombëtare të vendeve të tjera. Çdo përdorim i shqiponjave heraldike shqiptare dhe serbe ose përdorimi i vetëm ose mbizotërues i kombinimeve të ngjyrave kuq-zi (shqiptar) ose kaltër-bardhë-kuq (serb) u përjashtua që në fillim. Për më tepër, sipas këtyre kërkesave, flamuri dhe stema duhej të pasqyronin karakterin shumetnik të vendit. Vetëm në ditën e shpalljes së Pavarësisë, më 17 shkurt 2008, flamuri i ri shtetëror dhe stema e re e Kosovës, që kishte dalë nga ky konkurs, u shpallën në Parlament për herë të parë për publikun. Flamuri dhe stema janë dizajnuar nga ish-ushtari i UÇK-së, Muhamer Ibrahim. Modeli bazë për të dy ishte pa dyshim flamuri i Bashkimit Evropian, sepse në sfondin blu është skica territoriale e

Kosovës me ngjyrë ari dhe të verdhë. Mbi këtë simbol kishte gjashtë yje të bardhë, të llojit të yjeve të BE-së të vendosura në një gjysmëhark, interpretuar në atë mënyrë që secili yll përfaqësonte komunitetet etnike, si të shqiptarëve, serbëve, boshnjakëve, turqve, goranëve, dhe një yll për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët. Në një film dokumentar të titulluar “Branding Kosovo”, regjisori spanjoll Diego Hurtado de Mendoza arriti të shfaqte një përshkrim mbresëlënës dhe autentik të krijimit të simboleve shtetërore, si flamuri dhe himni.

Ashtu siç ishte rasti me aspektet e tjera të çështjes së identitetit, edhe diskutimet rreth simboleve shtetërore (flamuri, stema dhe himni) ishin kundërthënëse dhe me mjaft polemika. “Heqja dorë” nga simbolet etno-kombëtare, që ishin të zakonshme deri atëherë, nga një pjesë e shqiptarëve të Kosovës si dhe e serbëve të Kosovës vazhdon ende të perceptohet si një lloj tradhtie e herezie. Këto simbole për një pjesë të popullatës ende perceptohen si simbole të tyre “të vërteta”. Kjo ka të bëjë me faktin se këto simbole jo domosdo duhet të identifikohen me shtetin përkatës (Shqipërinë), por lidhen kryesisht me përkatësinë etnike dhe lidhjet e ngushta emocionale dhe historike.

Stema e re është identike me flamurin; vetëm forma e jashtme ndryshon në atë që është e rrethuar nga një vijë kufizuese me ngjyrë të verdhë. Në mënyrë domethënëse, simboli i tretë themelor i shtetit, himni kombëtar, është i pranishëm vetëm në formën e një kompozimi thjesht melodik pa tekst. Kjo me qëllim për të shmangur çdo keqinterpretim dhe çdo preferencë të mundshme për një grupim politik ose komunitet etnik. Pas një konkursi publik komisioni i emëruar qeveritar kishte përzgjedhur himnin me titullin mjaft ekspresiv “Evropa” nga kompozitori kosovar Mendi Mengjiqi, i cili u miratua në Parlament më 11 qershor 2008, dhe që tashmë është himn i Kosovës. Ashtu si edhe me rastin e flamurit, publiku i gjerë e kishte pranuar këtë himn me ndjenja të përziara, pasi konsiderohej të ishte himn i imponuar që sfidon “vlerat kombëtare” dhe përpiqet të zëvendësojë himnin kombëtar shqiptar.

Simbolet janë të rëndësishme për integrimin socio-politik dhe formimin e identitetit. Sidoqoftë, pranimi i simboleve kosovare në shoqëri dhe identifikimi i tyre me këtë ikonografi të re shtetërore mbetet ambivalente. Në një matje të opinionit të vitit 2011, vetëm 29.5 për qind e të anketuarve mund të identifikoheshin me flamurin kosovar, për shumicën dërrmuese flamuri shqiptar ose për serbët e Kosovës ai serb perceptoheshin si flamuj me të cilët ata identifikoheshin në rend të parë (Krasniqi, 2014: 148). Edhe nëse të dhënat aktuale të anketave mungojnë, qëndrimet ndaj këtyre simboleve janë gjithnjë e më shumë afirmative (Boguslaw, 2019). Ndikimi i dobët apo pranimi jo aq i madh i simboleve shtetërore, sigurisht ka të bëjë edhe me faktin se Kosova dhe simbolet e saj shtetërore në arenën ndërkombëtare shfaqen rrallëherë dhe vetëm në mënyrë selektive. Kjo mangësi e përfaqësimit ndërkombëtar në njërën anë, sikurse edhe mungesa e promovimit e manifestimit të duhur brenda vendit, paraqesin problem serioz për krenarinë, identifikimin, si dhe vetëvlerësimin kolektiv, për të cilën Kosova ka nevojë imanente, si në nivelin emocional e kulturor ashtu edhe në atë social e politik, në proces të formimit të identitetit. Kujtojmë me këtë rast se çfarë efekti dhe ndikimi pozitiv kishin fitoret e skuadrës së Kosovës në futboll apo edhe medaljet e arta në Olimpiada të xhudistëve si Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, kur u ngrit flamuri dhe u intonua himni i shtetit. Emocionet e krijuara me rastet e tilla mundësojnë perceptimin dhe pranimin më të gjerë të këtyre simboleve, si në rrafshin e përfaqësimit, njëkohësisht edhe të krenarisë kolektive.

Simbolet shtetërore nuk janë dekorime zyrtare, por kërkojnë një ndërgjegjësim shoqëror, kulturor e politik, si dhe një manifestim më të përhapur institucional të tyre, si parakusht për identifikimin dhe lidhjen e qytetarëve me këto simbole.

## 9.4. Shtetësia në Kosovë

Shtetësia nënkupton përkushtimin dhe lidhjen me një shtet sovran. Ashtu siç edhe u shtjellua më herët, në kuptimin më të gjerë, përfshin të drejtat, detyrimet, statusin legal dhe lojalitetin e të gjithë shtetasve ndaj shtetit dhe rendit të tij. Për qëllime të qartësimit analitik, shpesh bëhet një dallim midis kombësisë (nationality) dhe shtetësisë (citizenship). Megjithatë, në realitet të dyja plotësojnë dhe kushtëzojnë njëra-tjetrën në atë që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e rregulluara ligjërish dhe politikisht midis qytetarit dhe shtetit. Nisur nga kategorizimi klasik i bërë nga T. H. Marshal, në të cilën ai e lidh shtetësinë me të drejtat civile, ato politike si dhe shoqërore, politologu austriak Rainer Bauböck (2006: 15-17) e ka ndarë konceptin e shtetësisë në tri dimensione:

- ▶ Shtetësia si status politik dhe juridik;
- ▶ Të drejtat dhe detyrimet që lidhen dhe dalin nga ky status;
- ▶ Si dhe dispozitat dhe identitetet individuale që i janë caktuar me këtë status ose që detyrohen nga ky status.

Për këtë arsye shtetet përdorin modele të ndryshme të shtetësisë për të formuar identitetin shtetëror dhe/ose kombëtar, si dhe mbi këtë bazë për të krijuar lojalitet dhe legjitimitet më të fortë. Në këtë kuptim shtetësia nënkupton edhe përkatësi shtetërore (statehood) dhe jo vetëm status qytetar (citizenship).

Gjatë kohës së misionit të administratës së UNMIK-ut kosovarët u përcaktuan zyrtarisht si “banorë” (residents), por jo si qytetarë apo shtetas (citizens), pra, sipas kësaj qasjeje, sikur institucionet vendore ashtu edhe vetë kosovarët ishin “të përkohshëm”. Për shkak të statusit të papërcaktuar, edhe çështja e shtetësisë ishte e papërkufizuar. Në kuptimin formal ligjor, një udhëzim i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil (Central Civil Registry) rregullonte se kush dhe si mund të posedonte statusin ligjor si banor i Kosovës, por kjo kurrësi nuk ishte ligj i shtetësisë. Vetëm me shpalljen e Pavarësisë qytetarët e Kosovës fituan status të vërtetë ligjor dhe mund të udhëtojnë si shtetas kosovarë dhe të përfaqësojnë shtetin jashtë vendit. Në Kushtetutën e Kosovës

shtetësia rregullohet me nenin 14 dhe më hollësisht rregullohet me Ligjin për Shtetësinë, i cili u miratua në vitin 2008, vetëm tri ditë pas shpalljes së Pavarësisë. Derisa në dokumentet personale të lëshuara, si letërnjoftimi, pasaporta, certifikata dhe të tjera, tek rubrika shtetësia përshkrimi shënohet me kosovar/kosovare, kjo gjë në gjuhën angleze kësaj rubrike i referohet çuditërisht me nationality. Ndërkohë që nuk i referohet termit kosovar, ashtu sikur edhe Ligji për Shtetësinë, i cili flet më shumë për komunitete; të përcaktuara mbi baza etnike, sesa për shtetasit. Modeli liberal e demokratik i shtetësisë kështu bie ndesh me modelin konsocional, i cili detyron ndarje të pushtetit mes komuniteteve etnike në strukturat shtetërore. Kjo ndodh sepse të drejtat, përfaqësimi dhe pjesëmarrja politike mund të realizohen vetëm brenda këtij rendi kushtetues dhe në kuadër të komuniteteve. Në emër të njëlloj “multietniciteti”, bashkësia ndërkombëtare ka kontribuar më tepër në përcaktimin e jetës politike në Kosovë, në bazë të vijave etnike sesa qytetare. Kjo është një kundërthënie e madhe demokratike dhe pengesë për zhvillimin e vetidentifikimit, si dhe krijimit të një “ideologjie shtetërore identitet-formues” (Krasniqi, 2010), duke e reduktuar shtetësinë më shumë sikur nënshtetësi, pra njëlloj statusi legal, sesa në përkatësi politike e komunitare dhe përbërës kyç të identitetit.

Edhe pse shtetndërtimi në Kosovë, sipas Planit të Ahtisaarit dhe Kushtetutës, në parim bazohet në qasjen shumetnikë dhe ndjek politikën integruese të shtetësisë, Kosova nuk mund të cilësohet as komb-shtet (nation-state) i shumicës shqiptare, mirëpo në rrethana ekzistuese as shtet qytetar (civic state). Në vend të kësaj, ashtu siç e përkufizon edhe Dana Landau (2017: 463), Kosova mbetet “shtet i komuniteteve” dhe për këtë arsye pamundëson krijimin e bashkësisë politiko-shtetërore (në kuptimin e statehood dhe jo vetëm të citizenship) që në plan afatgjatë vë në dyshim edhe legjitimitetin e shtetit. Kështu, formimi i një identiteti të përbashkët dhe forcimi i legjitimiteti shtetëror kërkon jo vetëm përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike, por edhe ndryshime thelbësore kushtetuese dhe institucionale. Shtetësia në esencë është ajo çka qytetarët bëjnë prej saj dhe përmes saj. Prandaj ndikimi i saj varet edhe nga emancipimi politik dhe potenciali integrues shoqëror, se a shfrytëzohet në shërbim të formimit të identitetit apo vlen thjesht si pjesëmarrje formale në një entitet politik. Përveç funksionit demokratik të pjesëmarrjes politike, ligjore dhe shoqërore, shtetësia mundëson edhe bashkëdyzimin dhe pajtimin e identiteteve të ndryshme brenda saj (Van Gunsteren, 1998). Shtetësia është njëkohësisht çështje e vetëdijesimit politik, kohezionit social dhe integritetit socio-ekonomik, të gjitha bashkësive etnike që jetojnë në një shtet dhe përfshihen aktivisht në të gjitha segmentet e tij. Për konsolidimin dhe zhvillimin e shtetit, përveç strukturave shtetërore, nevojitet edhe identiteti i përbashkët politik, në mënyrë që vetë shteti të pranohet dhe të trajtohet si i “tyre”.

Ngatërrimet më të mëdha në lidhje me çështjen e identitetit, shtetësisë dhe të simboleve kosovare qëndrojnë në keqkuptimet konceptuale, si dhe në perceptimet skajshmërisht të politizuara të tyre. Çështja që mbetet hapur dhe që kërkon diskutim të thukët në qarqe akademike, si dhe konsensusi mes elitave politike ashtu edhe të shoqërisë, ka të bëjë me atë se çka e konstituon këtë identitet, dhe bazuar në këtë çfarë politike të identitetit duhet ndjekur më pas? Sepse heshtja dhe mospërfillja nuk do ta zgjidhin këtë dilemë, përkundrazi mund të shpjerë edhe në një krizë të identitetit, e cila herët a vonë do të thellohej më shumë. Kjo krizë mund të shfaqet në kohërat e transformimeve të mëdha shoqërore, ekonomike dhe politike, përveç tjerash, edhe si

rezultat i problemeve në vlerat, normat dhe botëkuptimet e shoqërisë si dhe të gjendjes së pasigurisë që mund të ketë individi në raport me atë ambient social e kulturor.

Për të përmbledhur, vlen të thuhet se identiteti kosovar mbetet akoma peng i botëkuptimeve nacionaliste ekzistuese mbi identitetin, që si kundërpërgjigje nuk mund të ketë nacionalizmin kosovar, i cili në konceptimin Gellnerian do të duhej edhe të krijonte kombin kosovar. Mirëpo, identiteti kosovar si alternativë duhet të ketë atdhedashurinë, lojalitetin e përkushtimin shtetëror, pra të jetë një identitet qytetar mbi-etnik dhe krahas atij kulturor e kombëtar.



PJESA

# 4

## 10. E ardhmja e kombit dhe shtetit

Me gjithë pikëpamjet optimiste se globalizimi dhe demokratizimi i shtuar i shoqërive do të çojë dalëngadalë në zbehjen e nacionalizmit dhe të armiqësive ndërmjet kombeve, gjendja aktuale në botë nuk ofron edhe aq shumë shpresë për këtë. Numri i shteteve, të cilat po rrëshqasin në regjime autoritare ose gjysmë-autoritare, madje edhe në demokracitë e konsoliduar, është në rritje. Madje edhe projekti më madhor e shpresëdhënës në këtë aspekt, si ai i Bashkimit Evropian, me gjasë nuk është duke u dëshmuar aq i suksesshëm në krijimin e bashkimit në shumëllojshmëri (unity in diversity), ashtu siç titullohet parulla themelore e saj. Për më tepër, gjendja e krijuar me pandeminë Covid-19 dhe rrjedhimisht beteja për sigurimin e vaksinës vunë në pah një betejë të ashpër mes shteteve e kombeve, duke i lënë BE-në dhe organizatat ndërkombëtare si vëzhguese të pafuqishme e të paafta që të marrin përsipër organizimin dhe shpërndarjen e drejtë e të barabartë në botë. Gjithashtu, çështja e emigrimit dhe refugjatëve viteve të fundit po ndikon në rritjen si të ksenofobisë (urrejtjes ndaj të huajve) ashtu edhe të një nacionalizmi të ri. Ky nacionalizëm sot, sado që ka ndryshuar në mjete dhe manifestim të jashtëm, po arrin që përmes nxitjes së frikës ekonomike dhe sociale të vërë në përdorim diskursin nationalist, ku i huaji dhe “tjetri” personifikohen me dyshim dhe me rrezikshmëri potenciale. Në këtë situatë ndikon edhe rritja enorme e përdorimit dhe ndikimit të rrjeteve sociale dhe internetit, të cilat mundësojnë përhapjen e shpejtë e të pakontrolluar të informatave e dezinformatave (fake news) dhe të mobilizimit politik.

Nga ana tjetër, ashtu siç edhe arritëm të shpalojmë, shtetformimi është proces i gjatë dhe kompleks i zhvillimit të strukturave shtetërore dhe transformimit socio-politik. Shfaqja e shteteve moderne ndodhi së pari në Evropën Perëndimore dhe më pas u eksportua në të gjithë botën në formë të modifikuar si një model universal, ose u imponua shteteve të tjera përmes kolonializmit. Vetëm me rënien e shteteve shumëkombëshe, si ajo e Bashkimit Sovjetik, Çekosllovakisë dhe Jugosllavisë, sikurse edhe më pas me krijimin e shteteve të reja, ky

proces nxiti interesim të shtuar në qarqe shkencore; veçanërisht, roli i bashkësisë ndërkombëtare në misione shtetndërtuese ishte temë boshte në diskutime akademike. Zhvillimet e viteve të fundit në skenën ndërkombëtare tregojnë se krijimi i shteteve të reja nuk ka të ndaluar, kur kësaj i shtohet edhe dukuria e shteteve të brishta e të dështuara, atëherë duket se harta politike e botës akoma do të vazhdojë të rikonfigurohet.

Në vazhdim çështja e kombit dhe e nacionalizmit do të trajtohen nga prizmi i shpjegimit të populizmit sikurse edhe çështja e shtetit dhe shtetformimit nga aspekti i ndikimi të globalizmit. Këto, qoftë si dukuri apo edhe si faktorë, do të kenë ndikim të pamohueshëm dhe afatgjatë në atë se si do të zhvillohen dhe sa do të ndryshojnë kombet dhe shtetet në të ardhmen.

## 10.1. Populizmi dhe nacionalizmi bashkëkohor

Kohëve të fundit janë shtuar raportet studimore dhe shqetësimet e intelektualëve mbi kahen e ndryshimeve në skenën politike botërore, veçanërisht rreth regresit të demokracisë dhe shtimit të tendencave autoritare. Ngritja në pushtet e liderëve kundërthënës dhe sukseset elektorale të lëvizjeve ekstremiste kanë shtuar shqetësimin mbi rreziqet e një nacionalizmi të ri, i cili shkon shpesh përtej dallimeve ideologjike e tradicionale të majtë e të djathtë të partive politike. Sistemi demokratik po rrezikohet pikërisht nga vetë atributi qenësor i saj, pra nga sovraniteti i popullit. Sikurse në disa sëmundje e çrregullime tek njeriu, kur sistemi i imunitetit lufton qelizat e veta të shëndosha, ashtu edhe në shumë vende siç duket masa popullore po rrezikon të fundosë demokracinë liberale. Duke sulmuar pluralizmin politik dhe shoqëror, si dhe duke akuzuar elitat politike për korrupsion dhe tradhti kombëtare, liderët demagogë dhe lëvizjet e tyre politike shfaqen mbrojtëse dhe përfaqësuese të vërteta të interesave popullore. Kjo dukuri njihet në shkencën politike edhe si populizëm, përkufizimi i së cilës është mjaft ambivalent. Në një nga studimet e para mbi populizmin të vitit 1969, Ionescu Gita e Ernest Gellner vënë në pah shumanshmërinë e populizmit dhe pamundësinë për një përkufizim të prerë.

Suksesi në zgjedhje i liderëve dhe lëvizjeve populiste vë në pah nevojën për rikonceptim të sistemit partiak, orientimeve ideologjike, si dhe paraqet kthesë paradigmatiske në politikën çfarë njihej deri më tani. Në mënyrë paradoksale këta zëra populistë dalin kundërshtuesit më të ashpër të globalizmit dhe liberalizmit, ndërkohë që prijësit e këtyre rrymave politike shpesh janë përfituesit më të mëdhenj të tyre. Meqë dallimet konvencionale rreth të majtës dhe të djathtës nuk janë thelbësore, populizmi ka një zbrazëti ideologjike për t'u shërbyer me çështje e kërkesa nga të dyja krahët, në mënyrë dhe trajtë pothuajse të njëjtë, siç ishte rasti me lëvizjet e ekstremit të majtë si: Syriza në Greqi e Podemos në Spanjë, apo me të djathtën ekstremiste në Francë, Austri, Hungari, Poloni, Finlandë etj.

Por, çka e përbën populizmin si rrezik ndaj demokracisë? A është kritika e ashpërsuar ndaj të huajve dhe bashkësive të tjera etnike e fetare kundërshtimi i kapitalizmit, luftimi i elitave politike apo diçka tjetër, që çon në rritjen dhe suksesin elektoral të tyre? Ndoshta çelësi i suksesit të tyre është afërsia me popullin e “rëndomtë”, gjuha banale dhe thjeshtësia e ofrimit të zgjidhjeve tejet komplekse sociale dhe ekonomike?

Në botëkuptimin e thjeshtësuar populist shoqëria ndahet në dy grupe antagoniste, ku “populli” përbën pjesën e pastër dhe ideale, kurse elitat në pushtet elementin e korruptuar e të dëmshëm të shoqërisë. Kjo çon në polarizim të skajshëm të raporteve politike e shoqërore, mes “tyre” si përfaqësues e mbrojtës popullorë dhe elitës politike, në anën tjetër, si e keqja e përgjithësuar. Një faktor që e thëllon këtë ndarje është kundërshtimi i sistemit ekzistues dhe manipulimi me frikën dhe paragjykimet latente ndaj grupeve të caktuara shoqërore. Të dyja këto, zhgënjimi dhe frika, janë ushqyesit e radikalizmit politik, qoftë si nacionalizëm apo populizëm. Akuzat për gjendjen sociale dhe ekonomike shfrytëzohen për të rritur urrejtjen ndaj “sistemit” politik e me këtë edhe të rritjes së dyshimit ndaj vlerave dhe institucioneve të demokracisë. Derisa në botën perëndimore ksenofobia (urrejtja ndaj emigrantëve) po kthehet si forcë shtytëse në rritjen e populizmit.

Në rajonin e Ballkanit janë retorika nacionaliste e tonet shoviniste ato që përfshihen dhe ndikojnë në rritjen e saj, sidomos para dhe gjatë fushatave zgjedhore. Interesimi i shtuar populist për “njerëzit e rëndomtë” është i ngjashëm me përkushtimin nationalist ndaj “kombit të vërtetë”.

Prandaj, në vend të diskutimit normativ ose teorik të populizmit si “ideologji e hollë”, sipas Cass Mudde (2004), atë mund ta konceptojmë edhe si mjet duke u fokusuar në strategjinë politike, bazuar në mobilizim dhe diskurs. Meqenëse duhet pajtuar këtu me Robertsin (2006: 127), ky pohon se “thelbi i populizmit është mobilizimi i masës nga liderë që synojnë të sfidojnë elitat e etabluara.” Atëherë karakteristikë e populizmit është roli i udhëheqësit të partisë, i cili mishëron “vullnetin e popullit” dhe ka afinitet personal të shquar. Mirëpo, këtu duhet të kemi kujdes të shtuar sepse termi populizëm dhe populist ka një inflacion në përdorimin e përditshëm, sepse përdoret për të atakuar rivalët politikë. Në anën tjetër, populizmi nuk është ndonjë ideologji e kapshme apo doktrinë e qartë politike me të cilën mund të mburrej ose të identifikohet ndokush. Prandaj askush nuk e përshkruan veten si populist. Kontestimi i mëtejshëm vjen nga ndërlikimi konceptual, meqë secili politikan dhe çdo autoritet demokratik burimin e legjitimitetit të vet pretendon që e ka nga populli, kjo në parim e bën demokracinë të përputhshme me populizëm.

Meqenëse populli është sovran dhe pushteti buron nga populli, a nuk do të thotë kjo që politikanët janë të përzgjedhurit popullorë dhe me të drejtë mund të thirren në emër të tij? Pra, a nuk janë a priori populistë? Duke pretenduar atë që studiuesi i njohur Jan Werner-Muller (2019: 35) e përshkruan si “përfytyrim moralist i politikës”, duke e vendosur popullin e pastër dhe të vërtetë kundrejt elitave të korruptuara dhe sigurisht duke e portretizuar veten si përfaqësues të vërtetë të popullit. Duke pretenduar se janë kujdestarët dhe përfaqësuesit e vërtetë të interesave të popullit, partitë populiste në thelb sfidojnë pluralizmin. Ata e konsiderojnë shoqërinë të ndarë në dy grupe antagonistë, ku “populli” përbën pjesën e pastër dhe ideale dhe elitat politike pjesën “korruptuese dhe jokompetente” të këtyre dy poleve (Mudde, 2004).

Populizmi është kështu i lidhur ngushtë me polarizimin politik dhe nacionalizmin, dhe në rrethana të caktuara mund të shtyjë demokracinë drejt kolapsit. Përveç kësaj, politikat populiste ndikojnë në konflikte shoqërore, në të cilat dallimet midis bashkësive shtohen dhe hendeku mes kategorisë “ne” dhe “ata” mund të thellohet. Kjo qarje fillon të ashpërsohet kur “ata” fillojnë të paraqiten dhe të perceptohen si të rrezikshëm, kur nxitet urrejtja, si dhe kur kjo merr përmasa të veprimeve të dhunshme. Rastet e sulmeve ndaj të huajve apo grupeve të marginalizuara gjithandej në botë ilustrojnë se populizmi, po aq sa edhe nacionalizmi, nuk janë vetëm retorikë e qëndrim i caktuar politik, ato mund të shndërrohen lehtësisht edhe në nxitëse të përçarjeve dhe luftërave të përgjakshme, ashtu siç kemi qenë dëshmitarë nga e kaluara jo fort e largët.

## 10.2. Shteti në shekullin XXI

Ashtu sikur modernizimi dhe industrializimi që ishin forca shtytëse të komb-shtetformimit, ashtu edhe globalizimi dhe digjitalizimi janë faktorë në transformimin e tyre. Së këndejmi, shtetet dhe shoqëritë gjatë këtij shekulli do të pësojnë ndryshime të thella e të shumanshme, ani pse diku më shumë e më shpejt, e diku më pak e më ngadalë. Kjo do të shënojë atë që filozofi i shkencës Thomas Kuhn (1970) e quante “paradigma”, e me të cilën nocion ai i përshkruante ndryshimet fundamentale në mendimin dhe kulturën njerëzore, që sollën kthesat e mëdha e rrjedhimisht krijuan edhe parakushtet për revolucionet shkencore dhe më pas ato kulturore. Paradigmat e tilla dhe revolucionet teknologjike gjithmonë u kanë paraprirë transformimeve të thella shoqërore, që si rrjedhojë kanë pasur kalimin nga një rend politik në një tjetër. Edhe tani me trendin e përshpejtuar të globalizimit dhe digjitalizimit në ekonomi e shërbime, vërehen tendenca të transformimeve gjithëpërfshirëse. Kështu, çështjet që lidhen, bie fjala, me inteligjencën artificiale, realitetin virtual, kriptovalutën, automatizimin e prodhimit, teknologjinë e sofistikuar të komunikimit, rrjetet sociale, mësimin online dhe shumëçka tjetër, nuk janë më thjesht vetëm zhvillime e arritje teknologjike, por tashmë janë pjesë përbërëse dhe të pandashme të jetës sonë të përditshme. A nuk paraqet kjo një lloj paradigme më vete, në të cilën pandemia nga Covid-19 ishte katalizator i përkryer, qoftë për t’i shtuar e përshpejtuar,

qoftë edhe për t'i vendosur ato përfundimisht në “normalitetin” tonë? Sot pjesa dërrmuese e ndërmarrjeve dhe fushëveprimtarive kanë marrë parashtesën “E”, sikurse që është; E-government, E-banking, E-learning dhe kështu me radhë, në pothuajse çdo sferë tjetër të jetës janë digjitalizuar dhe kanë kaluar në formë virtuale.

Kështu mund të shtrojmë pyetjen se: a ishin të vetëdijshëm për një “Zeitenwende”, ashtu siç gjermanisht quhet mbarimi dhe fillimi i një epoke të re, njerëzit në kapërcyell nga mesjeta në periudhën e renesancës apo nga feudalizmi në epokën e industrializimit, apo vetëm nga këndvështrimi i tanishëm mund të përcaktohen periudhat e kaluara? Në kapërcyellin e epokave nga absolutizmi në periudhën e modernes, sipas studiuesit Raj Kollmorgen (2015), tri parakushte strukturale ishin vendimtare; në aspektin politik ishte krijimi i komb-shteteve sovrane dhe kushtetuese, në atë ekonomik përhapja e mënyrës kapitaliste të prodhimit si model mbizotërues i zhvillimit ekonomik, si dhe lidhur me dy të parat zbulimet shkencore dhe avancimet teknologjike ato që çuan në transformime të thella shoqëro-politike dhe kalimin në epokën e industrializimit.

Në këto dekadat e fundit shumë shkollarë diskutuan gjerësisht rreth rikonfigurimit të sistemit ndërkombëtar, si dhe relacioneve të pushtetit brenda vetë shteteve, duke hamendësuar “përplasjen e civilizimeve” sipas Huntigtonit, “fundin e historisë” e triumfin e liberalizmit sipas Fukujamës dhe deri te rritja e autoritarizmit, populizmit, regjimeve hibride dhe shtimin e shteteve të dështuara. Ndërkaq Habermasi (2001) përmes asaj që ai e quan “paparashikueshmëria” - ose një lloj konfuzioni i ri (neue Unübersichtlichkeit), ka herë na e ka tërhequr vërejtjen e fryrjes së utopisë sociale në një rën të anë dhe rritjes së mosbesimit karshi shtetit, në anën tjetër, që vjen si rezultat i paaftësisë dhe pavendosmërisë së pushtetarëve për reformat dhe ndryshimet e duhura. Këto hezitime të vendimmarrësve janë kryesisht për shkak të kalkulimeve elektorale, politikave klienteliste, si dhe përfitimeve personale, duke dobësuar besimin institucional e duke gërryer themelet e demokracisë, rrjedhimisht duke nxitur pakënaqësi me tërë sistemin politik, ekonomik e shoqëror. Si pasojë e kësaj krijohet hapësira e një lloj ambienti politik e mediativ që përshkruhet shpesh

me dukurinë e të ashtuquajtur “pas-vërtetës”, që nxjerr liderë politikë e shtetërorë mediokër e të papërgjegjshëm. Gjendja e tanishme e pandemisë vë në pah injorancën e arrogancën e tillë karshi raportit të njerëzimit me shkencën, me të vërtetën dhe natyrën, qoftë në formë të ballafaqimit me krizat, pabarazitë sociale ashtu edhe me ndryshimet klimatike.

Të gjitha këto çështje të lartcekura do të sfidojnë shtetin në vazhdimësi. Së pari, në autoritetin dhe legjitimitetin e tij, duke i dobësuar apo edhe duke zëvendësuar disa nga funksionet themelore, si në ofrim të shërbimeve ashtu edhe të sigurisë e mirëqenies. Së dyti, institucionet themelore do të transformohen në atë masë e në atë mënyrë që shteti do t’i zëvendësojë këto me ofertuesit privatë, si dhe shërbimet e administrata do të jenë më shumë virtuale sesa reale në shumë segmente të tyre. Pastaj edhe në rendin global shtetet do të ballafaqohen me presion të shtuar ekonomik. Të gjitha këto do të ndikojnë edhe në marrëdhëniet e shtetit me shoqërinë.

Sigurisht që ana tjetër e medaljes na flet se varfëria ekstreme, vdekshmëria e foshnjave dhe disa nga sëmundjet më të përhapura në shekullin e kaluar janë çrrënjësuar gati tërësisht. Ndërkaq arsimimi, shëndeti publik dhe përgjithësisht paqja dhe siguria janë në nivele të papara ndonjëherë më parë. Një tablo mjaft optimiste të arritjeve, mbështetur në të dhëna globale, na ofron mjeku dhe profesori suedez Hans Rosling në librin mbresëlënës “Forca e faktit” (2019). Kontribut të çmueshëm në këto zhvillime pa dyshim se kanë edhe shtetet e zhvilluara dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat kanë ndihmuar në forma e me mjete të ndryshme shtetet e varfra që të zhvillohen dhe t’u ofrojnë kushte e siguri më të lartë qytetarëve dhe kështu ndikojnë në paqe në botë. Këtu ndoshta vlen të përmendet njëra ndër strategjitë më të diskutuara për zhvillim, ajo me Qëllimet e Mijëvjeçarit nga Kombet e Bashkuara (2000-2015), si dhe programi pasues Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Nga ana tjetër, edhe globalizimi dhe zhvillimi i hatashëm teknologjik ka ndikuar që të rriten shkëmbimet në njerëz, mallra dhe ide në shkallë botërore dhe me shpejtësi marramendëse.



Në këtë kontekst asnjë shtet nuk është ishull, të gjitha shoqëritë e shtetet iu nënshtrohen një konkurrence dhe gare të pamëshirshme për zbulime të reja, për prodhime më të avancuara teknologjike dhe për stimulim të aftësive e dijes shkencore dhe inovative. Kjo tani është madje parakusht i zhvillimit ekonomik dhe prosperitetit social. Globalizimi ka bërë që të krijohen tregje më të hapura, mobilitet më të shtuar dhe ka nxitur procese të integrimi rajonale e bashkëpunime globale në shumë fusha. Studimet e ndryshme tregojnë se globalizmi çon në ndërvarësinë ekonomike, teknologjike, kulturore dhe në transferimin e autoritetit rregullues të nivelit kombëtar drejt institucioneve ndërkombëtare. Në fakt termi globalizëm shënon fenomenin e ndërvarësisë në shkallë botërore. Për shembull, korporatat shumëkombëshe, skuadrat e njohura sportive, organizatat jofitimprurëse ndërkombëtare etj. i tejkalojnë kufijtë e veprimit dhe identifikimit kombëtar e shtetëror, por njihen si globale. Në të vërtetë veprimtaria e këtyre organizatave po bëhet gjithnjë e më e përhapur dhe ndikimi i tyre gjithnjë e më i madh. Shumë studiues janë të mendimit se me rritjen e tendencave të lartpërmendura pushteti dhe ndikimi i shteteve do të zbehen dukshëm. Mbetet ende për t'u parë se çfarë ndryshimesh do të pësojnë shtetet nga të gjitha këto zhvillime, megjithëkëtë shtetet mbetin akoma pikë referuese dhe aktor kryesor si në marrëdhënie ndërkombëtare ashtu edhe për rendin e brendshëm politik.

## 11. Përfundim

Në shkencë shoqërore konceptet e kombit dhe të shtetit mund të cilësohen lirisht nocione si përherë të kontestuara, ngaqë nuk mund të përkufizohen aq thjesht dhe as të kuptohen me pak fjalë. Kjo ndodh edhe për arsyet e shtjelluara në libër që lidhen me pikëpamjet e studiuesve dhe fushave të tyre shkencore, me qasjet e llojllojshme teorike, me faktorët dhe aktorët më mbizotërues, por edhe për shkak të rasteve të caktuara me gjithë specifikat e tyre. Rrjedhimisht, kombformimin dhe shtetformimin duhet vështruar si procese të varura në kontekst të caktuar kohor e hapësinor dhe të ndërlidhura me rrethana të caktuara politike, ekonomike, ushtarake dhe sociale, si në nivel të brendshëm ashtu edhe në atë të rendit botëror. Fakti që numri i shteteve në botë është rritur dukshëm gjatë shekullit të kaluar, tregon qartazi rëndësinë e tyre si për shkencë politike ashtu edhe për qytetarët. Kështu, numri i shteteve anëtare të OKB-së është trefishuar që nga koha e themelimit në vitin 1945, kur ishin 51 shtete, ndërsa aktualisht janë 193 shtete anëtare me të drejta të barabarta. Anëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara kështu paraqet miratimin e shtetësisë dhe të sovranitetit të një vendi, sikurse edhe pranimin në bashkësinë e kombeve botërore. Shteti mbetet forma më e përhapur dhe e vetme e organizimit politik, rendit juridik dhe shoqëror, si dhe e rregullimit ekonomik. Ndërkaq, përvoja e fundit me pandeminë Covid-19 dëshmoi se bashkëpunimi mes shteteve është i domosdoshëm në përballje me sfida globale dhe se ato të vetme nuk mund t'ia dalin. Globalizimi i tregjeve financiare, integrimet regjionale dhe ndërvarësia kulturore, teknologjike dhe ekonomike janë paraqitur si forca gjithnjë e më me ndikim me të cilat shtetet duhet të përballen, duke transformuar sovranitetin dhe duke ndryshuar organizimin e tyre dhe funksionet thelbësore të shteteve. Ndërkaq tërheqja e trupave amerikane së fundmi nga Afganistani me gjasë lë për të nënkuptuar se epoka e ndërhyrjeve të bashkësisë ndërkombëtare dhe misioneve shtetndërtuese, siç ishte ajo në Kosovë, ka marrë fund së paku për një periudhë bukur të gjatë.

Në anën tjetër, përkatësia kombëtare, roli dhe ndikimi i tij në rendin shoqëror e organizimin politik ka qenë dhe vazhdon të jetë temë boshte si e mendimtarëve ashtu edhe doktrinave, lëvizjeve dhe

ideologjive politike. Siç kemi arritur edhe të nënvizojmë disa herë më sipër, procesi i kombformimit dhe i shtetformimit ishin komplementare dhe ndryshimet përmbajtjesore në njërin kanë akoma ndikim të drejtpërdrejtë edhe në tjetrën. Kjo nënkupton që edhe kombformimi nuk mund të konsiderohet si proces i së kaluarës, pasi që po shfaqen tendenca të vazhdueshme dhe raste të shumta, siç bie fjala me katallanët, skocezët, kurdët etj., që aspirojnë krijimin e komb-shteteve të tyre. Gjithashtu, edhe modelet e ndryshme që synojnë të akomodojnë kulturat, etnitë dhe përkatësitë e shumëllojshme në një identitet të përbashkët po bëhen gjithnjë e më të përhapura në botë, por njëkohësisht edhe më të brishta. Sidoqoftë, studimi i kombformimit nga pikëpamjet e ndryshme shkencore mundëson edhe përballje më të duhur me sfidat e së ardhmes dhe afirmon identitete kolektive që janë më paqësore, më tolerante dhe më përfshirëse.

Zhvillimet e hatashme dhe tejet dinamike që po ndodhin sot në botë, në çdo sferë të jetës, kanë ndikim të pashmangshëm edhe në shkencë. Në anën tjetër, në këto zhvillime kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë rol qendror edhe kërkimet shkencore, duke i studiuar dukuritë e ndryshme dhe duke ofruar njohuri të reja për kuptim sa më të mirë të tyre. Pikërisht në këtë frymë është përpiluar edhe ky libër, si një lloj kontributi shkencor në studim të kombit dhe të shtetit, nga prizmi i zhvillimeve bashkëkohore dhe ndryshimeve globale. Libri kështu synon të sjellë një tablo të gjerë të këtyre proceseve, si dhe një përmbledhje të këndvështrimeve dhe qasjeve më të njohura në studimet rreth kombit dhe shtetit. Mungesa e theksuar e literaturës shkencore në gjuhën shqipe të kësaj fushe studimore është edhe një faktor tjetër shtesë që i bën të nevojshme kërkimet shkencore të mirëfillta të këtyre temave. Prandaj, shpresoj shumë se me këtë libër është dhënë një kontribut në opusin e veprave shkencore të kësaj fushe, sado modeste që mund të jetë ky kontribut.

## 12. Literatura

Acemoglu, Daren dhe Robinson, James A. (2018) Pse dështojnë kombet: origjina e pushtetit, prosperitetit dhe varfërisë. (botimi i dytë në gjuhën shqipe), Cuneus, Prishtinë.

Andersen, Aasmund (2002) Transforming Ethnic Nationalism: The politics of ethno-nationalistic sentiments among the elite in Kosovo. Ph.D. Thesis, University of Oslo.

Anderson, Benedict (1991) Imagined Communities. Reflections on the Origin and the Spread of Nationalism, 2nd Edition Verso, London.

Anzulovic, Branimir (2017) Serbia Hyjnore: Nga miti te gjenocidi. Koha, Prishtinë.

Arendt, Hannah (1998) Ndërmjet të shkuarës dhe të ardhmes: tetë ese mbi mendimin politik. Onufri, Tiranë.

Assmann, Aleida (2006) Memory, Individual and Collective, in The Oxford Handbook of contextual political analysis, (edited by Robert E. Godin and Charles Tilly) 210-227. Oxford University Press, Oxford.

Assmann, Aleida, and Shortt, Linda, (eds.) (2012) Memory and Political Change. Palgrave Macmillan, Basingstoke.

Ashplant, T.G., Graham Dawson, and Michael Roper (eds.) (2000) The Politics of War Memory and Commemoration. Routledge, London.

Baliqi, Bekim (2009) State-Building durch die Vereinten Nationen: Am Fallbeispiel des Kosovo. SVH-Verlag, Saarbrücken.

Baliqi, Bekim (2013) Innenpolitik und Parteiensystem im Kosovo, pp.43-63 in: Olaf Leisse et.al (eds), Die Republik Kosovo-Der jüngste Staat Europas. Nomos, Baden-Baden.

Baliqi, Bekim (2017) The Aftermath of War Experiences on Kosovo's Generation on the Move: Collective Memory and Ethnic Relations Among Young Adults in Kosovo. *Zeitgeschichte* 1(44), 6–19.

Baliqi, Bekim (2019) Consociational democracy, citizenship and the role of the EU in Kosovo's contested state building. *Australian and New Zealand Journal of European Studies*, Vol. 11, No.1, 59-75.

Barber, Brian K. (ed.) (2009) *Adolescents and war: how youth deal with political violence*. Oxford University Press, New York.

Bartl, Peter (1995) *Albanien. Vom Mittelalter bis zur Gegenwart*, Regensburg.

Bauböck, Rainer (ed.) (2006) *Migration and Citizenship. Legal Status, Rights and Political Participation*. Amsterdam, IMISCOE Reports.

Benz, Arthur (2001) *Der Moderne Staat. Grundlagen der politologischen Analyse*, Oldenburg Verlag, München.

Berding, Helmut (Ed.) (1996): *Nationales Bewußtsein und kollektive Identität. Studien zur Entwicklung des kollektiven Bewusstseins in der Neuzeit 2*. Suhrkamp, Frankfurt a/ M.

Billig, Michael (1995) *Banal Nationalism*. Sage, London.

Boguslaw, Alissa (2019) "Suddenly Everyone Started to Love Our Anthem, Our Flag": Identity Construction, Crisis, and Change in (Almost) Sovereign Kosovo. *Nationalities Papers*. 1-16.

Bozborra, Nuray (2002) *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*. Dituria, Tiranë.

Brubaker, Rogers/Cooper, Frederick (2000) "Beyond Identity." *Theory and Society*. Vol.29/1.

Bruckmüller, Ernst (ed.) (1994) Nationalismus. Wege der Staatenbildung in der außereuropäischen Welt. Verlag für Gesellschaftskritik, Wien.

Bugajski, Janusz (2002) Democracy, Multi-Ethnicity and Kosovar Identity. OSCE Conference, Prishtina, 28 May 2002.

Burema, Lars (2012) Reconciliation in Kosovo: A Few Steps Taken, a Long Road Ahead. Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe 11(4): 7-27.

Caplan, Richard (2002) A New Trusteeship? The International Administration of War-torn Territories. Adelphi Paper 341, Oxford University Press, Oxford.

Caplan, Richard (2005) International Governance of War-Torn Territories. Rule and Reconstruction. Oxford University Press, Oxford.

Chandler, David (2006) Empire in Denial: The Politics of State-Building. Pluto, London.

Chesterman, Simon (2004) You, the People. The United Nations, Transitional Administration, and State-Building. Oxford University Press, New York.

Chesterman, Simon (2005) State-Building and Human Development. Human Development Report 2005, UNDP -Occasional Report No.1.

Clark, Howard (2000) Civil Resistance in Kosovo. Pluto Press, London.

Connor, Walker (1994) Ethnonationalism: The Quest of Understanding. Princeton University Press, Princeton.

Constitution of the Republic of Kosovo (2008)

Devine- Wright, Patrick (2003) "A Theoretical Overview of Memory and Conflict." In: The role of memory in ethnic conflict, (Eds.) Cairns and Mícheál D. Roe, 9-33. Palgrave Macmillan, Basingstoke.

Di Lellio, Anna (2009) *The Battle of Kosova 1389: An Albanian Epic*. I.B. Taurus: London.

Dobbins, James (et al.) (2005) *The UN's Role in Nation-Building. From the Belgian Congo to Iraq*. RAND, Santa Monica.

Dobbins, James (et. al.) (2003) *America's Role in Nation-Building. From Germany to Iraq*. RAND, Santa Monica.

Doyle, Michael W./Sambanis, Nicholas (2006) *Making war and building peace. United Nations peace operations*. Princeton Univ. Press, Princeton.

Dryzek, John/Dunleavy, Patrick (2009) *Theories of the Democratic State*. Palgrave Macmillan, Basingstoke.

Engin, F.Isin/Wood, Patricia K. (1999) *Citizenship and Identity*. Sage, London.

Fearon, James D. (1999) *What is Identity (As we now use the word)?* Stanford University.

Fox, Jon E., and Cynthia Miller-Idriss (2008) *Everyday nationhood*. *Ethnicities* 8, no. 4: 536-563.

Fukuyama, Francis (1992) *The End of History and the last man*. Free press, New York.

Fukuyama, Francis (2010) *Ndërtimi i Shtetit: qeverisja dhe rendi botëror në shekullin njëzet e një*. AHS, Tiranë.

Fukuyama, Francis (2018) *Identity: The demand for dignity and politics of resentment*.

Gellner, Ernest (1983): *Nations and Nationalism*. Blackwell Publishers, Oxford.

Gellner, Ernest (1995) Nationalismus: Kultur und Macht. Siedler, Berlin.

Gellner, Ernest (2009) Kombet dhe Nacionalizmi. YIHR, Prishtinë.

Gerold, Nikolaus (2014) Mit Maschinengewehr und Heiligenschein: Hybrider Opfertod, Nationale Erinnerungskultur und Patriarchat im heutigen Kosovo. disserta Verlag, Hamburg.

Goldstein, Joshua (2003) Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Dituria, Tiranë.  
Gray, John (2010) Liberalizmi. Idk. Tiranë.

Greenfeld, L./Eastwood, J. (2007) National identity. In C. Boix, & S. Stokes (Eds.), The Oxford handbook of comparative politics, New York: Oxford.

Greenfeld, Liah (1992) Nationalism: Five Roads to Modernity, Cambridge: Harvard University Press.

Guibernau, Monserrat (2007) The Identity of Nations. Polity Press, Cambridge.

Guibernau, Montserrat (2013) Belonging: Solidarity and Division in Modern Societies. Polity Press, Cambridge.

Habermas, Jürgen (2001) The Postnational Constellation: Political Essays Cambridge: Polity.

Hedges, Chris (1999) Kosovo's Next Masters? Foreign Affairs, Vol. 78, No. 3: May/June.

Hippel, Karin von (2000) Democracy by Force. A Renewed Commitment to Nation Building. in: The Washington Quarterly, 23:1 Winter

Hippler, Jochen (Hg.) (2004) Nation - Building. Ein Schlüsselkonzept für friedliche Konfliktbearbeitung? Dietz, Bonn



Hobsbawm, Eric (1992) Nations and Nationalism since 1780. Cambridge University Press, Cambridge.

Holsti, Kalevi (2008) Shteti, lufta dhe gjendja e luftës. AIIS, Tiranë.

Höpken, Wolfgang (1999). War, memory, and education in a fragmented society: The case of Yugoslavia. East European Politics & Societies 13 (1): 190-227.

Huntington, Samuel (1996) The Clash of Civilizations. Simon and Schuster, New York.

Huntington, Samuel (2014) Who are we? The Challenges to America's National Identity. Simon and Schuster, New York.

Ignatieff, Michael (2000) Gjaku dhe Përkatësia-Udhëtime në Nacionalizmin e Ri. Dituria, Tiranë.

Ignatieff, Michael (2003) Empire Lite. Nation- Building in Bosnia, Kosovo and Afghanistan. Minerva, London.

Ingimundarson, Valur (2007). The Politics of Memory and the Reconstruction of Albanian National Identity in Postwar Kosovo. History & Memory, 19 (1): 95-123.

Ionescu, Ghita and Ernst, Gellner (1969). (Eds.). Populism: Its Meanings and National Characteristics. New York: Macmillan.

Isin, Engin F. / Wood, Patricia K (1999) Citizenship & Identity. Sage, London.

Jenkins, Richard (1996) Social Identity. Routledge, London.

Karolewski, Ireneusz Pawel (2009) Citizenship and collective identity in Europe. Routledge.

Kaser, Karl (2001) *Freundschaft und Feindschaft auf dem Balkan*. Wieser, Wien.

KFOS/OSFA (2019) *Kosovë - Shqipëri: Ndërveprimi, njohuritë, vlerat, besimet, bashkëpunimi dhe bashkimi*. Prishtinë. Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, Prishtinë, Tiranë.

Kenneth, Roberts, M. (2006). *Populism, Political Conflict, and Grass-Roots Organization in Latin America*. *Comparative Politics* 38(2) 127-148.

Koselleck, Reinhart (1988) *Vergangene Zukunft. Zur Semantik geschichtlicher Zeiten*. Suhrkamp, Frankfurt a/M.

Krasner, Stephen D. (2001) *Problematic Sovereignty. Contested Rules and Political Possibilities*. Columbia University Press.

Krasniqi, Gezim (2010) *Citizenship as a tool of state-building in Kosovo: status, rights, and identity in the new state*. CITSEE Working Paper Series 2010/10.

Krasniqi, Vjollca (2014) *Kosovo: Topography of the Construction of the Nation*. In: Pål KOLSTØ (ed.) *Strategies of Symbolic Nation-Building in South Eastern Europe*. Ashgate, 139–163.

Kurze, Arnaud (2016) *#WarCrimes #PostConflictJustice #Balkans: Youth, Performance Activism and the Politics of Memory*. *International Journal of Transitional Justice*, 10(3): 1–20.

Landau, Dana M. (2017) *The quest for legitimacy in independent Kosovo: the unfulfilled promise of diversity and minority rights*. *Nationalities Papers* 45 (3): 442-463.

Liah Greenfeld and Jonathan Eastwood, "National Identity," in Carles Boix and Susan Stokes (Eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Politics*, Oxford: Oxford University Press, 2007, pp. 256–273.

Llobera, Josep, R. (1999) Recent theories of Nationalism. Barcelona.  
Malcolm, Noel (2001) Kosova: një histori e shkurtër. Koha, Prishtinë.

Matveeva, Anna and Paes, Wolf-Christina (2003) The Kosovo Serbs: An ethnic minority between collaboration and defiance. Bonn International Center for Conversion, [http://www.bicc.de/publications/other/report\\_saferworld\\_II/report-kosovo\\_serbs.pdf](http://www.bicc.de/publications/other/report_saferworld_II/report-kosovo_serbs.pdf)

McCrone, David/Bechhofer, Frank (2015) Understanding national identity. Cambridge University Press, Cambridge.

McCrone, David/Kiely, Richard (2000) "Nationalism and Citizenship." Sociology, Vol. 34, No. 1. 19–34.

McDowell, Sara/Máire, Braniff (2014) Commemoration as Conflict: Space, Memory and Identity in Peace Processes. Palgrave Macmillan, Basingstoke.

Migdal Joel S. (2004) State Building and the Non- Nation- State. në: Journal of International Affairs, Vol. 58, no.1.

Migdal, Joel S. (2001) State in Society: Studying How States and Societies Transform and Constitute One Another. Cambridge University Press, Cambridge.

Migdal, Joel S. (ed.) (2004) Boundaries and Belonging: States and Societies in the Struggle to Shape Identities and Local Practices, Cambridge University Press.

Minogue, Kenneth R. (1970) Nationalismus. Nymphenburger Verlag, München.

Mudde, Cass/Kaltwasser, Cristobal, Rovira (2017) Populism: A Very Short Introduction. Oxford University: Press.

Mudde, Cass (2004) The Populist Zeitgeist: Government and Opposition. Ltd, London.

Müller, Jan- Werner (2019) Ç'ështëë populizmi? Pema, Prishtinë.

Müller, Jan- Werner (ed.) (2004). *Memory and Power in Post-War Europe: Studies in the Presence of the Past*. Cambridge University Press, Cambridge.

Münkler, Herfried (1999) Nation as Model of Political Order and the Growth of National Identity in Europe. *International Sociology*, 14 (3), 283-297.

Olick, Jeffrey K. (1999) "Collective Memory: The Two Cultures." *Sociological Theory*, 17 (3): 333-348.

Olick, Jeffrey K., Vered Vinitzky-Seroussi, and Daniel Levy (eds.) (2011) *The collective memory reader*. Oxford University Press, Oxford.

ÒNeill, William G. (2002) *Kosovo: An Unfinished Peace*. Boulder. Lynne Rienner Publishers.

Özkırmılı, Umut (2010) *Theories of Nationalism: A Critical Introduction*. 2nd Edition. Basingstoke: Palgrave.

Paige, Arthur (ed.) (2011) *Identities in transition: challenges for transitional justice in divided societies*. Cambridge University Press, Cambridge.

Paris, Roland (2002) International peacebuilding and the 'mission civilisatrice', in: *Review of International Studies* No. 28:

Petritsch, Wolfgang (et al.) (1999) *Kosovo- Kosova. Mythen, Daten, Fakten*. Wieser, Klagenfurt.

Pierson, Christopher (2009) *Shteti modern*, Biblioteka e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Historisë, Tiranë.

Poggi, Gianfranco (1990) *The State. Its Nature, Development and Prospects*. Polity Press, Cambridge.

Poggi, Gianfranco (2012) Formation and Form: Theories of State Formation. In K. Nash and A. Scott (eds.) The Willey-Blackwell Companion to Political Sociology. Oxford: Blackwell, pp. 95–106.

Poole, Ross (1999) Nation and Identity. Routledge, London.

Putnam, Robert D. (1993) Making Democracy Work. Tradition in Modern Italy. Princeton University Press, Princeton.

Rapper, Gilles de (1998) Crisis in Kosovo: Reactions in Albania and Macedonia at the Local Level. Ethnobarometer Programme, Working Paper No. 3.

Ramet, Sabrina P. (2013) "Memory and identity in the Yugoslav successor states" Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity, 41(6): 871-881.

Renan, Ernest (2018) Ç'është Kombi?, Fan Noli, Tiranë.

Reuter, Jens (2000) Zur Geschichte der UÇK. in: ders./ Clewing, Konrad (Hg.): Der Kosovo Konflikt. Ursachen, Verlauf, Perspektiven. Wieser, Klagenfurt.

Reuter, Jens/Clewing, Konrad (2000)(Hg.): Der Kosovo Konflikt. Ursachen, Verlauf, Perspektiven. Wieser, Klagenfurt.

Richmond, Oliver P. (2005) The Transformation of Peace. Palgrave Macmillian, Basingstock.

Roberts, Kenneth M. (2006) Populism, Political Conflict, and Grass-Roots Organization in Latin America. Comparative Politics, 38 (2): 127-148.

Rokkan, Stein (2000) Staat, Nation und Demokratie in Europa. Die Theorie Stein Rokkans aus seinen gesammelten Werken rekonstruiert und eingeleitet von Peter Flora. Suhrkamp, Frankfurt am Main.

Scherrer, Christian P. (1997) Ethno-Nationalismus im Zeitalter der Globalisierung. Ein Handbuch zu Ethnizität und Staat. Agenda Verlag, Münster.

Schmidt, Fabian (1999) Im Griff der großen Mächte. Das Kosovo in der wechselvollen Geschichte des Balkans. p. 82-100, in; Thomas Schmidt (Hg.) Krieg im Kosovo. Rowohlt, Hamburg.

Schneckener, Ulrich (2004) States at Risk. Fragile Staaten als Sicherheits- und Entwicklungsproblem. Diskussionspapier, (SWP) Berlin.

Schneider, Christian and Henrike Schneider (2011) Kosovo: Die Situation zweier Narrative. Zeitschrift für Balkanologie, 47(1): 107-127  
Schubert, Peter (2003) Albanische Identitätssuche im Spannungsfeld zwischen nationaler Eigenstaatlichkeit und europäischer Integration. Berlin

Segal, Robert, A (2017) Miti: Një hyrje e shkurtër. Cunues, Prishtinë.

Simonsen, Sven Gunnar (2004) Nationbuilding as Peacebuilding: Racing to Define the Kosovar. in: International Peacekeeping, Nr.2, Vol.11.

Skinner, Quentin (2009) A genealogy of the modern state. In Proceedings of the British Academy, Vol. 162, No. 325.

Smith, Anthony D. (1986) The Ethnic Origin of Nations, Oxford, Blackwell.

Smith, Anthony D. (1991) National Identity. Penguin Books, London.

Smith, Anthony D. (1995) Nation and Nationalism in Global Era. Oxford, Polity Press.

Smith, Anthony D. (2008) Kombet dhe nacionalizmi në erën globale. Dudaj, Tiranë

Smooha, Sammy (2002) Types of democracy and modes of conflict management in ethnically divided societies. *Nations and nationalism*, 8( 4): 423-431.

Spyros, Sofos A. (1996) Culture, Politics and Identity in Former Yugoslavia, in *Nation and Identity in Contemporary Europe* (eds. Jenkins, Brian and Spyros, Sofos A.), Routledge, London, 251-279.

Stahn, Carsten (2000) International Territorial Administration in the Former Yugoslavia. *Origins, Development and Challenges Ahead*, Heidelberg Journal of International Law, Stuttgart, 61/1.

Tilly, Charles. (1992) *Coercion, Capital and European States AD 990–1992*. Oxford: Blackwell.

Tilly, Charles. (2002) *War Making and State Making as Organized Crime*. In C. Besteman (ed.) *Violence: A Reader*. New York: New York University Press.

Thiesse, Anne-Marie (2004) *Krijimi i identiteteve kombëtare. Evropa e shekujve XVIII-XX*. Dukagjini, Pejë.

Thomson, Janice E. (1995) *State Sovereignty in International Relations. Bridging the Gap between Theory and Empirical Research*. in: *International Studies Quarterly*, Vol. 39, No. 2.

Van Gunsteren, Herman (1998) *Theory of Citizenship*. Westview Press, Boulder.

Volkan, Vamik D. (2004) *Chosen Trauma, the Political Ideology or Entitlement and Violence*. in: <http://www.vamikvolkan.com/Chosen-Trauma,-the-Political-Ideology-of-Entitlement-and-Violence.php>.

Walkenhorts, Heiko (1999) *Europäischer Integrationsprozeß und europäische Identität: Zur politikwissenschaftlichen Bedeutung eines sozialwissenschaftlichen Konzepts*. Nomos Verlag, Baden-Baden.

Weber, Max (2004) Studime sociologjike. Plejad, Tiranë.

Weber, Max (2006) Politika si profesion. Shkenca si profesion. Tre tipat e pastër të sundimit legjitim. Tiranë.

White House, The (2002) National Security Strategy of the United States of America.

Wimmer, Andreas (2013) Waves of war: nationalism, state formation, and ethnic exclusion in the modern world. Cambridge University Press.

Yannis, Alexandros (2001) Kosovo under International Administration: An Unfinished Conflict. Athens, ELIAMEP

Zartman, William (2020) State Formation and Failure, in The SAGE Handbook of Political Science (eds.) Berg-Schlosser, Dirk: Badie, Bertrand & Morlino, Leonardo. Sage, London. 974-989.

Zdravković-Zonta, Helena (2009) Narratives of Victims and Villains in Kosovo, Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity, 37(5), 665-692.

Zirojević, Olga. (2000) "Kosovo in the Collective Memory." In: The Road to War in Serbia: Trauma and Catharsis, (ed.) Nebojša Popov, 189–212. CEU Press, Budapest.





# Kombformimi dhe Shtetformimi

---

Bekim Baliqi



## Bekim Baliqi

Bekim BALIQI është profesor i rregullt në Departamentin e Shkencave Politike pranë Universitetit të Prishtinës. Ka studiuar shkenca politike në Universitetin e Vjenës ku më pas edhe ka doktoruar. Është autor i librave 'Politikat Publike dhe Qeverisja', 2021 (ri-botim) dhe botimi i parë 2017; bashkë-redaktor 'Perspectives of a Multiethnic Society in Kosovo', 2015; 'Analiza e Politikave Publike', 2011, 'State-Building durch Vereinten Nationen', 2009. Sikurse edhe kontribues në disa kapituj librash dhe punime shkencore në revista ndërkombëtare. Ka marrë pjesë në konferenca e simpoziume dhe projekte të shumta, brenda dhe jashtë vendit. Listën e plotë të publikimeve shkencore mund te gjeni në [orcid.org/0000-0001-9010-4601](https://orcid.org/0000-0001-9010-4601)



KONRAD  
ADENAUER  
STIFTUNG

Prishtinë, 2021

ISBN 978-9951-8664-3-9



9 789951 866439